



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë në
Bashkinë Gjirokastrë”

Tiranë, tetor 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1-4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	4-6
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4-6
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	4-6
II.	HYRJA	6-7
1.	Objektivat dhe qëllimi	7-7
2.	Identifikimi i çështjes.....	7-7
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7-8
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	8-8
5.	Kriteret e vlerësimit.....	8-8
5.	Standardet e auditimit.....	8-9
7.	Metodat e auditimit.....	9-9
8.	Dokumentimi i auditimit.....	9-9
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	13-105
	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	10-11
1.1	Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	11-23
2.1	Auditimi mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	25-32
2.6	Vlerësimi dhe mbledhjes së të ardhurave	32-41
3	Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike	42-52
4	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	53-129
4.1	Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve	129-138
5	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike	139-143
6	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	143-147
7	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore	147-149
8	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	149-163
IV	REKOMANDIME	164-167

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtron auditim financiar dhe perputhshmerie në Bashkinë Gjirokastrë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar.

Kontrolli I lartë I shtetit ka ushtruar auditim në Bashkinë Gjirokastrë sipas programit të auditimit nga data 11.03.2025 deri në datën 16.06.2025, për periudhën objekt auditimi financiar nga data 01.01.2024 deri në 31.12.2024 dhe të përputhshmërisë nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2024.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 16 akt-konstatime dhe 1 akt verifikime të cilat janë protokolluar në subjekt me 16.06.2025. Nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet protokolluar në KLSH me shkresat nr. 321/5-8 prot., datë 01.07.2025 të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditimi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Gjirokastrë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Gjirokastrë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve
- mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit, Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV).
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 23 gjetje dhe ka

dhënë 24 rekomandime, nga ku masa organizative 15 gjetje dhe 16 rekomandime, 5 gjetje dhe 5 rekomandime në masën shpërblim dëmi në vlerën 594,444 lekë, si dhe 3 në fushën e të ardhurave në vlerën 167,482,112 lekë.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

-Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave

- Mos nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitore në vlerën **161,996,949 lekë** nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë, si dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e debitoreve në mbyllje të vitit 2025;

-Të ardhura të munguara nga taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën **2,785,163 lekë**, në fund të vitit 2024;

-Bashkia Gjirokastrë ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar, por nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimor dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Gjithashtu nuk janë mbajtur akt-rakordime për vitet 2023-2024 me agjentët tatimorë si DRSHTRR, Degën e Doganës Gjirokastrë, ASHK Drejtoria Vendore Gjirokastrë dhe DRT Gjirokastrë.

▪ Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e asetëve

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Gjirokastrë dhe Njësit Administrative të kaluara me VKM-të përkatëse, Sektori i Lejeve, Licencave dhe Administrimit të Pronave Publike nuk ka bërë regjistrimin e tyre në ASHK, nuk janë inventarizuar, nuk disponohet informacion në lidhje me gjendje reale të këtyre pronave sa nga këto prona janë të zëna sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë, në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1.

Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Gjirokastrë rezulton se për 5 raste, vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar nga IMTV në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pika a

Nga të dhënat e siguruar nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me kontratat e koncesionit sipas regjistrimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës 2023-2024, në territorin e Bashkisë Gjirokastrë, ushtrojnë aktivitet 3 (tre) subjekte kariere, për shfrytëzimin e “Mineral” dhe 4 (katër) subjekte në fushën e energjistikës të cilat nuk paguajnë detyrime për aktivitetin që kryejnë si dhe nuk administrojnë dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj), në kundërshtim me Neni 17, të Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin kullor”, pikat 3, 7, 9,10,11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **594,444 lekë pa TVSh**

Titullari i Bashkisë Gjirokastrë të gjitha masat e menjëhershme duke i kërkuar ASHK-së Gjirokastrë caktimin e një personi ekspert të fushës, që merret me Menaxhimin e Aseteve, me qëllim ngritjen e grupit të përbashkët për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka Bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre me VKM.

Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave në Bashkinë Gjirokastrë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2024 në vlerën **161,996,949 lekë**.

Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK të marrë masa që në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të pajisur me liçensat përkatëse.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

A. OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Gjirokastrë për vitin ushtrimor 2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Gjirokastrë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **të modifikuar (kualifikuar)**¹, e shprehur kjo në bazën për *opinionin*.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA^{-të}). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Gjirokastrë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 është 13,388 mijë lekë.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë parregullsitë si më poshtë:

- Nga analiza e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", konstatohet se nuk është bërë përditësimi dhe rakordimi midis Drejtorisë së Financave dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP) pranë bashkisë për gjendjen debitore të pa kontabilizuar në vlerën 146,065,114 lekë

¹ "Opinion i modifikuar", jepet në raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore.

- Për pronat e transferuara me VKM, nga Bashkia Gjirokastrë, nuk është bërë regjistrimi në ASHK, nuk janë inventarizuar, nuk janë vlerësuar, nuk janë kontabilizuar dhe nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale të këtyre pronave, sa nga këto prona janë të zëna, sa janë funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Bashkia Gjirokastrë me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë, ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të **kualifikuar të përputhshmërisë**”.

Baza për dhënien e opinionit

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2024 të subjektit Bashkia Gjirokastrë, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42 . Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Bashkia Gjirokastrë dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e opinionit të kualifikuar.

Bashkia Gjirokastrë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

- Në 6 procedura nga 13 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 163,199,764 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST.

Në 5 (pesë) raste, rezultuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën 594,444 lekë pa TVSH.

-Në 1 (një) rast për investimin me objekt: “Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastrë” Bashkia Gjirokastrë, është lidhur kontrata për kryerjen e shërbimit të kolaudimit, rreth 15 (pesëmbëdhjetë) muaj me vonesë.

-Në dy raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, nuk është i plotë, pasi akt kontrollet sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve ligjore.

I. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 321/1, datë 10.03.2025, me ndryshime, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 11.03.2025 deri në datën 16.06.2025, në subjektin Bashkia Gjirokastrë u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1.H. I. – Përgjegjës Grupi

2.A. G. – Anëtar

3.I. S. – Anëtar

4.F. Ç. – Anëtar

5.B. B. -Anëtar

- 6.N. L. – Anëtar
- 7. A. B. – Anëtar
- 8. S. M. – Anëtar

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Gjirokastrë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)²;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Gjirokastrë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Gjirokastrë dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2024.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2023-31.12.2024.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.
7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Gjirokastrë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në

²Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Gjirokastrë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Gjirokastrë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- “VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve” i ndryshuar;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;

- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar.

- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Gjirokastër grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik";

- ISSAI 200 "Parimet themelore të auditimit financiar".

- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";

- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Gjirokastër me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale³. Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-J^a aplikon⁴.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri

³ ISSAI 1315

⁴ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësishë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Gjirokastër si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm.

Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të MFK-së në mënyrë të detajuar argumentohet si më poshtë:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimi për integritet dhe vlerat etike”

-Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar dhe miratuar Kodin e Etikës , por rregullat e etikës janë përfshirë në Rregulloren e Brendshme, në të cilat përcaktohen parimet që duhet të respektojnë çdo punonjës në punën e tij, si dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë. Institucion. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

-Në Rregulloren e Brendshme janë përcaktuar veprimet që parandalohen, të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes, ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës.

-Ankesat nga jashtë depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e marrëdhënieve me publikun), duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë dhe përgjigja kthehet nga drejtoritë përkatëse.

Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip, 1 herë në 6 muaj, ndërsa për punonjësit me Kod pune 1 herë në vit.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë saj. Theksojmë se rregullorja e brendshme duhet të ndryshojë me qëllim përfshirjen e detyrave të reja për gjithë punonjësit sipas strukturës së miratuar.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e raportimit të realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkryetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse, janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Është hartuar “Plani i veprimit për MFK-në në Bashkinë Gjirokastër”, për vitin 2024 me nr.1625 prot. , datë 29.02.2024,si dhe ka një raport ”Mbi zbatimin e masave të marra në planin e veprimit për MFK në Bashkinë Gjirokastër”, Memo me nr.4404 prot. datë 27.05.2024 e sekretares së GMS znj. A. K., dërguar Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër.

Ky plan nuk është zbatuar në kohë në të gjitha pikat e tij.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE.
 - Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.
- Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”
- Është hartuar “Rregullorja e Brendshme e bashkisë Gjirokastrë”, referuar Vendimit nr.65,datë 07.07.2021,”Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Gjirokastrë”, e ndryshuar me vendimin nr.16,datë 16.03.2023.
 - Referuar formatit të “Manualit për MFK”, përsa i përket pjesës për Rregulloren e Brendshme të Njesisë Publike, vihet re se përgjithësisht është hartuar bazuar në këtë manual dhe mbështetet në legjislacionin përkatës, duke përfshirë disa nga elementët thelbësore që një rregullore duhet të ketë.
- Konstatohet se pas shkrirjes së Drejtorisë së Kulturës, Trashëgimisë, Turizmit dhe Sporteve, janë krijuar :
- Agjencia për Aktivitete e Turizëm ,si dhe Agjencia e Trashëgimisë Kulturore, por nuk janë pasqyruar në Rregulloren e brendshme detyrat konkrete të punonjësve të këtyre agjencive.
- Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.
 - Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e PBA-së, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të takimeve me grupet e interesit, si dhe për dëgjesat me publikun.
 - Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.
 - Është hartuar “Plani i veprimit për menaxhimin financiar “ për periudhën e auditimit të vitit 2024 për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilin përfshihen aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.
 - Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Organi grama e Bashkisë Gjirokastrë është e ndërtuar në mënyrë të tillë që nën/Kryetarët, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Kabinetit, Drejtori i Auditit të Brendshëm dhe Administratorët e NJA varen direkt nga Kryetari, ku edhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë.
- Për vitin 2023-2024 me Urdhër të Kryetarit nr. 945, datë 07.12.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2023” që ka funksionuar deri në në periudhën Janar-Tetor 2024 me 604 punonjës të miratuar dhe strukturë: Kabineti dhe Drejtoritë përkatëse ndarë sipas sektorëve nga të cilët : 95 Nëpunës Civil dhe 509 punonjës që trajtohen me Kod Pune.
- Në periudhën 30 Tetor – 31 Dhjetor 2024 me Urdhër nr.730,datë 27.09.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2024”,rezultojne 66 Nëpunës Civil dhe 557 punonjës që trajtohen me Kod Pune, gjithsej 623 punonjës.
- Hyrjet e punonjësve për vitin 2024 janë 69, nga të cilët: 18 janë pozicione të Shërbimit Civil e 51 janë me Kod Pune.
- Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, si dhe janë përcaktuar objektivat për secilin drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Po kështu edhe në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, kurse objektivat për secilin punonjës janë të pasqyruara në vlerësimet e punës.
 - Bashkia Gjirokastrë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore (gjirokastrë.gov.al) .

-Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit. Për çdo punonjës të rekrutuar është krijuar dosja personale, e cila përmban të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: certifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

-Për bashkinë, nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organi gramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. Me Vendim të KB nr. 113, datë 14.12.2023, është miratuar nga Këshilli Bashkiak "Buxheti për vitin 2024" dhe "Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026". NA për vitin 2024 ka nxjerrë Urdhërin nr.370, datë 16.05.2024 "Për një ndryshim në urdhrin nr.299 datë 15.05.2020,Mbi ngritjen e GMS në Bashkinë Gjirokastër "

Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale” Në Rregulloren e Brendshme janë parashikuar “funksionet/detyrat që delegohen” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin i institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi ka patur Urdhëresa për delegime detyrash.

Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Nga verifikimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si:

-Nuk është mbledhur për të hartuar dhe miratuar “Planin Strategjik 5 vjeçar”, veprim në kundërshtim me ligjin nr.10296,datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 8,pika 8,germa”b”,neni 24,pika 2.

-Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar

-Janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6 “Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva”

Bashkia Gjirokastër në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si edhe me vizionin dhe misionin e njësisë të përcaktuara në “Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Gjirokastër”. Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjesat me publikun.

-Bashkia Gjirokastrë ka hartuar dhe miratuar “Regjistrin e Riskut në Bashkinë Gjirokastrë”, është hartuar sipas formatit që përcaktohet në “Manualin e MFK” dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë, më shkresën nr.12237 prot. datë 27.12.2023. Në përgjithësi është i plotësuar për të gjitha kategoritë që përmban një Regjistër Risku. Në këtë Regjistër janë përshkruar disa nga risqet kryesore, duke krijuar një pamje analitike të situatave, duke përcaktuar edhe nivelin e secilit prej risqeve, para dhe pas kontrollit. Gjithashtu janë përcaktuar nevojat për kontrollin e mëtejshme, veprimet për të zgjidhur mangësitë, duke identifikuar në të njëjtën kohë edhe zotëruesit e riskut. Në lidhje me parimin 7 “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave” Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësive publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësive publike. Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës”.

Me Urdhër të Titullarit për përcaktimin e kordinatorit të MFK dhe koordinatorit të Riskut datë 16.05.2024 me urdhrin nr.370,detyrë e deleguar znj. E. L.

Duke u përcaktuar kordinatori i riskut dhe grupi i menaxhimit të riskut si pasojë e veprimtarisë së tij, krijohen kushte për të identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut Në lidhje me parimin 8 “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

-Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9 “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

-Bashkia Gjirokastrë në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj nuk ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi ose riorganizimi i këtij institucioni, nga ndryshimet në menaxhim, duke mos marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

III. Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10 “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”

-Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, per arkivat, kodit të procedurave administrative etj).

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

-Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Nëpunësi Zbatues/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA).

-Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave,

komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Detyrat dhe përgjegjësit e NJHDT dhe KVO janë parashikuar edhe në kapitullin V të Rregullores së Brendshme.

-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh.

-Ka delegim të NA te zv/kryetari me urdhrin nr.981 datë 17.12.2024 "Mbi delegimin e përgjegjësisë të NA pranë Bashkisë Gjirokastër".

-Në Rregulloren e Brendshme "Specialist i Protokoll-Arkivit" përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrove dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Në lidhje me parimin 11 "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë"

-Bashkia Gjirokastër nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike.

-Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikthimin e të dhënave. Nga AB ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.08.2018 "Për hartimin e PF"). Nga auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti "Informimi dhe komunikimi"

Në lidhje me parimin 13 "Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor" Drejtuesit në Bashkinë Gjirokastër kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

-Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe dërgohen në MFE. Ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

-

Në lidhje me parimin 14 "Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor".

-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Në lidhje me parimin 15 "Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm" ka faqen e saj zyrtare.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në "Marrëdhëniet me mediat", "Afishimi i akteve juridike", "Praktika shkresore".

Në lidhje me parimin 12 "Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave"

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë.

-Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim. “Marrëdhëniet me të tretët” “Marrëdhëniet me Publikun”, “ Zyra e shërbimit me një ndalesë”.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit herë pas here, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar.

Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike zyrtare. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Bashkisë Gjirokastër janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si edhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

-Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

-Nga Bashkia Gjirokastër kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Gjirokastër ka një faqe zyrtare Eeb në të cilën paraqiten informacione për publikun (gjirokastër.gov.al).

V. Komponenti “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16 “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

-Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore lidhur me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

-Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave.

-Për vitin 2024 me shkresën nr.prot.2006, datë 28.02.2025, të cilat janë dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “Deklarata për cilësinë e e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë Bashkia Gjirokastër dhe Raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i performancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.
2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit në pyetësorin e vetëvlerësimit. Veprimtaria e sektorit të Auditit të Brendshëm në investigimin e drejtorive të Aparatit të Bashkisë dhe njësive vartëse.
3. Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.

4. Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës është edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo realizohet nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

- Për periudhën objekt auditimi Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit në papajtueshmëri për vitin 2024.

-Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të KBFP-së për vitin 2024.

-Në Bashkinë Gjirokaster aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

- Një nga drejtimet e monitorimit lidhet me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Për vitin 2024 janë audituar nga Auditi i Brendshëm:

Drejtoria e Emergjencave Civile,

Drejtoria e Zhvillimit Bujqësisë, Pyjeve & Kullotave,

Drejtoria e Financës,

Drejtoria e Kulturës, Turizmit dhe Sporteve,

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit,

Drejtoria e Arsimit,

Drejtoria e të Ardhurave, Taksave, Pronave dhe Licencave.

Në lidhje me parimin 17 “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

-Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

-Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

-Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar

dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Një problematikë tjetër e evidentuar është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.

Është një plan vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit por nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se: “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.”

Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në këto kushte, evidentohet se Bashkia Gjirokastrë nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit”

-Bashkia Gjirokastrë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT-së. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkrese dhe elektronike. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT-së për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Komponenti “Informimi dhe komunikimi”

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Komponenti “Monitorimi”

-Në Bashkinë Gjirokastrë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por është hartuar “Plani i veprimtimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”.

-Në Bashkinë Gjirokastrë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Njësia e Auditit të Brendshëm ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Bashkia Gjirokastrë nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

-Nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës.

1.2 Auditimi i Brendshëm

Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit si dhe kapacitetet

audituese të sektorit të auditimi, ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- 1.Karta e Auditimit të Njesisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Gjirokastrë;
- 2.Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
- 3.Programimi i auditimeve të brendshme për vitet 2023-2024;
- 4.Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm;
- 5.Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;

Auditimi u fokusua kryesisht në këto çështje:

-Organizimi dhe funksionimi i Sektorit të Auditit të Brendshëm/Komitetit të Auditimit, niveli profesional i audituesve, çertifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme, bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, niveli i raportimit në këtë drejtori,

-Realizimi i treguesve të planifikuar nga DAB,

-Sigurimi i cilësisë së auditimit, me qëllim vlerësimin nëse veprimtaria e auditit të brendshëm është në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e auditimit, konkretisht ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm”, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkisë Gjirokastrë, rezultoi se:

Organizimi dhe Funksionimi: Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektorin publik” Bashkia Gjirokastrë ka ngritur NJAB.

Për vitin 2024 NJAB ka funksionuar me 1(një) Përgjegjës i sektorit të Auditimit dhe me 2(dy) auditues sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me vendim nr. 945, datë 07.12.2022, “Për miratimin e strukture organizative të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2023”, strukturë e cila është funksionale edhe për vitin 2024 nga Janari deri në Tetor. Me Urdhrin nr.730 datë 27.09.2024” Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2024”është bërë miratimi i kësaj strukture nga Tetori deri në fund të vitit 2024.

Konkluzion: Për vitin 2024 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1(një) Përgjegjës të Sektorit të Auditimit dhe 2 (dy) auditues,

Pra, struktura e miratuar është në mbështetje të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3 e cila përcakton se: “Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3(3) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Në strukturën e Njesisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.”

Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Gjirokastrë ,mbi bazën e të cilës funksionojnë të gjitha strukturat e Bashkisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes të punonjësit të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se, Përgjegjësi Sektorit të Auditimit të Brendshëm është i pa çertifikuar dhe nuk ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnime e vijueshme për kualifikimin profesional, po kështu edhe 2 audituesit. Kjo vjen në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenet 11, “Punësimi i Auditit të Brendshëm” neni 19 “Çertifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Gjirokastrë.

Nga auditimi rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se: “Komiteti i Auditimit të

Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë.

• Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Gjirokastrë, e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr. 5128, datë 13.06.2024.

□ Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm.

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kodin e Etikës për Audituesit e Brendshëm” në Bashkinë Gjirokastrë

Planet Strategjike dhe Vjetore:

Në mbështetje të “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Për vitin 2024 me shkresën nr.9947, datë 18.10.2023 është miratuar plani strategjik për vitet 2024 - 2026 dhe referuar shkresës me nr.2965 prot. datë 16.04.2024 “Për një ndryshim në planin e Auditimit të brendshëm në Bashkinë Gjirokastrë për vitin 2024” dërguar në DPHKBF, plani vjetor i auditimeve për vitin 2024, ku synohen të realizohen 7 auditime.

Raportimi vjetor për vitin 2024 është dërguar zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.2871 prot, datë 12.04.2024 në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Konstatim: NjAB në hartimin e këtyre planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuar, dhe ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve.

Realizimi i Planit Vjetor:

Për vitin 2024 janë parashikuar gjithsej 7 auditime në Bashki, ku sipas llojit janë të përputhshmërisë, të kombinuar dhe të zbatimit rekomandimeve të vitit 2023.

Për vitin 2024 në planin vjetor të miratuar me shkresën Nr.2965 prot, datë 16.04.2024, për ndryshimin e planit vjetor, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Njësia e auditimit të brendshëm ka planifikuar 7 auditime gjithsej. Realizimi e auditimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				Zb.Rek
				Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	
1	Viti 2024	7	7	6	1			1

Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Tabela 3

Nr	Subjektet e Audituar	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre							Statusi i Angazhimit		
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit	Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
			A. të përputhshmërisë	A. të performancë	A. financiare	A. të informacionit	A. të kombinuara				
1	Drejtorinë Arsimore	1	1						1		
2	Drejtoria e të Ardhurave Pronave Licencave	1	1						1		
3	Drejtoria e Finances dhe Buxhetit	1			1				1		

4	Drejtoria e Zhvill.Bujq.Pyje.Ujit. e Kullot.	1	1						1	
5	Drejtoria e Emërgjencave Civile,Performa.	1	1						1	
6	IMT	1	1						1	
7	Drejtoria Turizmit,Trashëgimi.e Kultures	1	1						1	

Burimi: Bashkia Gjirokastrë

□ Gjetje-Rekomandimet

Për vitin 2024, Nga auditimet janë evidentuar 26 rekomandime, nga të cilat 9 rekomandime janë rekomandime të karakterit organizativ , 17 rekomandime të tjera, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
4	Viti 2024	26	13	10	3				
TOTALI		26	13	10	3				

Burimi: Bashkia Gjirokastrë

Ndjekja e zbatimi i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të A.B. NJAB u ka dërguar Aktverifikime për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2024 me shkresa zyrtare të protokolluara tek zyra e Protokoll-Arkivit, po ashtu u janë dërguar edhe Raportet Finale njëjësive të audituara për informim e zbatim mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhës është çështja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore.

Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 5

Nr	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2024	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT				
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimit e sistemeve	Rekomandime të kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera
1.	Drejtoria Arsimore	10	10	10	5	5	0	0	2	0	8
2	Drejtoria e të Ardhurave Pronave,Licencave	3	3	3	0	3	0	0	1	0	2
3	Drejtoria e Finances dhe Buxhetit	4	4	4	0	4	0	0	2	0	2
4	Drejtoria e Zhvill.Bujq.Pyje.Ujit. e Kullot.	4	4	4	3	1	0	0	1	0	3
5	Drejtoria e Emërgjencave Civile,Performanc	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	IMT	1	1	1	0	0	0	0	1	0	0
7	Drejtoria Turizmit,Trashëgimi.e Kultures	4	4	4	2	0	0	0	2	0	2

Burimi: Bashkia Gjirokastrë.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga 26 masa të rekomanduara, janë pranuar 26 rekomandime, nga këto 13 rekomandime janë zbatuar, 10 rekomandime janë proces zbatimi, ndërsa 3 rekomandime janë të pa zbatuara. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka marrë në shqyrtim dhe ka mbikëqyrur procesin e monitorimit e ndjekjes së rekomandimeve të dhëna nga struktura e auditimit të brendshëm. Grupi i auditimit nuk ka analizuar arsyet e mosrealizimit të rekomandimeve të mëparshme. Referuar Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.13.3 përcaktohet se: Një njësi e mirë menaxhuar vendos procedura për t'u siguruar se çdo rekomandim i bërë nga njësia e AB, zbatohet ashtu siç duhet. Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me menaxhimin cakton një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe informojë për progresin që është bërë për zbatimin e tyre. Kjo do të ndihmojë që të sigurohet se përmirësimi i kontroleve të brendshme është përgjegjësi e menaxhimit të njësisë publike dhe jo rol i Njësisë së Auditimit të Brendshëm”.

□ Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i detajuar i dosjeve të auditimeve të kryera në subjektet:

Për vitin 2024 dosjet:

1. Drejtoria e Arsimit
2. Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore e Sporteve
3. Drejtoria e Zhvillimit të Bujqesisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit

Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:

- a- Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit;
- b- Letrat e punës në fazën e verifikimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Raportit dhe Raportit Përfundimtar nga audituesit;
- c- Besueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standartet e auditimit.

Rezultoi se:

-Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016.

-Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”.

-Hartimi i Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare në përgjithësi është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit.

-Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 është hartuar, miratuar dhe dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MFE me shkresën nr. 2029 prot, datë 28.02.2024.

-Në 2 dosje të auditimit mungon “Memo për Titullarin”

-Mungojnë observacionet

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;

-Audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në mënyrë të vijueshme për vitin 2024, në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit, si edhe nuk kanë kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut; -Për vitin 2024, konstatohet se është realizuar plani i auditimeve.

2.. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1. Programimi i PBA 2024-2026 dhe programimi i buxhetit vjetor;

2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të ardhurave.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;(faturat e palikujduara të shoqërohen me listë, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, raporti i tyre me shpenzimet e vitit sipas raportimit në në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e lokimit të granteve të FZSHS dhe Ministrive të linjës etj.

2.5.Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSHH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

➤ **Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin e PBA dhe programimit të buxhetit vjetor.**

● **Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2024-2026**

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2024-2026 u konstatua se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është **ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS)** për PBA 2024-2026 me Urdhrin nr. 299 datë 15.05.2020.

- Është përgatitur dhe **miratuar kalendari i PBA** 2024-2026 dhe buxhetin vjetor 2024 me VKB nr. 97, datë 16.12.2022 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkesën nr.prot. 1238/1, datë 29.12.2022, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33/1.

- Janë miratuar për PBA 2024-2026 me VKB nr. 18, datë 28.02.2023 “Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2024-2026 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 227/1 prot., datë 10.03.2023.

- Janë miratuar në Këshillin Bashkiak **tavanet përgatitore** për PBA 2024-2026 me VKB nr.28, datë 31.03.2023 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 329/1 prot., datë 06.04.2023 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 34/6.

- Pas miratimit të tavanëve përgatitore **për përgatitjen e PBA** 2024-2026 është hartuar Udhëzimi i Kryetarit të Bashkisë nr. 281, datë 14.04.2023.

- PBA 2024-2026, është dërguar në MF me shkresën me nr. 5209 prot., datë 01.06.2023. Nga Ministria e Financave janë dërguar rekomandimet me shkresën nr.prot.11099, datë 19.6.2023.

Me VKB nr. 62, datë 31.07.2023 është miratuar dokumenti “Për miratimin e dokumentit të parë PBA 2024-2026” dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 699/1 prot., datë 11.08.2023.

Me shkresën nr.8608 prot., datë 13.09.2023 është dërguar në Ministrinë e Financave vendimi nr. 62, datë 31.07.2023 që ka miratuar dokumentin “Për miratimin e dokumentit të parë PBA 2024-2026”. Dokumenti nuk ka patur ndryshime nga versioni i parë.

PBA 2024-2026 është përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar shoqëruar me relacion shpjegues, i cili përmban: rolin dhe qëllimin e PBA-së, vështrim të përgjithshëm të njësisë dhe orientimin afatgjatë të saj, të ardhurat dhe shpenzimet, planin e shpenzimeve 2024-2026, sipas programeve buxhetore, detyrimet e prapambetura, treguesit financiarë dhe rreziqet financiare e fiskale.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetit vjetor **janë kryer konsultime** me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”.

- **Buxheti vjetor 2024 dhe PBA 2024-2026** është miratuar me VKB nr. 113, datë 14.12.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1053/1 datë 26.12.2023.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2024-2026 dhe buxhetit vjetor, rezulton se **janë hartuar mbi bazën e kërkesave** shkresore nga njësitë administrative, nga njësitë vartëse dhe nga drejtorët e drejtorive të bashkisë Gjirokastrë në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, nga kërkesat e sektorëve të ndryshëm, që mbulojnë këto programe si dhe nga kërkesat e mbledhura në dëgjesat publike.

- Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investimet dhe të ardhurat. Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2024-2026 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2024		Viti 2025		Viti 2026	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	437,672	54 %	442,050	57 %	446,619	55 %

2	Sigurime (601)	69,415	9 %	70,108	9 %	70,660	9 %
3	Shpenzime operative (602)	156,326	19 %	120,486	16 %	142,918	18 %
4	Shpenzime (603)	1,200	0 %	1,212	0 %	1,225	0 %
5	Shpenzime (604)	20,550	3 %	21,766	3 %	21,784	3 %
6	Shpenzime (606)	2,300	0 %	2,318	0 %	2,336	0 %
7	Shpenzime (609)	8,091	1 %	8,148	1 %	8,204	1 %
8	Shpenzime për investime (230-231)	113,721	14 %	112,631	14 %	111,228	14 %
	TOTALI	809,275	100 %	778,719	100 %	804,974	100 %

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se, janë respektuar kërkesat e në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 25.02.2022 "Për një ndryshim të udhëzimit nr. 23, datë 30.7.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të NJQV, të udhëzimit plotësues nr. 2, datë 08.07.2022 "Për përgatitjen e PBA 2023-2025" dhe të Udhëzimit plotësues të MF nr. 21, datë 07.07.2023 "Për përgatitjen e PBA 2024-2026".

• Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2024

Buxheti për vitin 2024 është miratuar me VKB nr. 113, datë 14.12.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 12234 prot., datë 26.12.2023 plani fillestar miratuar për vitin 2024 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2024	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	301,911	
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	239,264	
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	268,100	
4	Të ardhura të tjera		
1	Shpenzime për paga (600)		437,672
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		69,415
3	Shpenzime operative		155,326
4	Subvencione (603)		1,200
5	Transferta (604+606)		23,850
6	Fondi rezervë+Fondi I kontigjencës (609)		8,092
7	Shpenzimet kapitale (230+231)		113,720
	Total	809,275	809,275

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe MFK, përpunuar nga grupi i auditimit

Me VKB nr. 20, datë 29.03.2024 është miratuar "Për një shtesë në VKB nr. 113, datë 14.12.2023 "Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024" nga shpërndarja e të ardhurave të trashëguara nga viti 2023", i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 2681 prot., datë 05.04.2024, të detajuara si më poshtë:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2024	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara nga transferta e pakushtëzuar	162,879	
2	Të ardhura të trashëguara nga transferta e pakushtëzuar sektoriale	10,250	
3	Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike për emergjencat civile		
4	Të ardhura të trashëg të ardhurat nga taksat e tarifat vendore + Institucio e varësisë	61,196	
5	Sponsorizime		
	Shpenzimet		
1	Shpenzime për paga (600)		500
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		90
3	Shpenzime operative		33,271
4	Transferta (604+606)		1,000
5	Shpenzimet kapitale (230+231)		199,464
	Total	234,325	234,325

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit

Buxheti fillestar i vitit 2024 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, ku të ardhurat dhe shpenzimet të miratuara janë në shumën 809,275 mijë lekë dhe trashëgimet e fondeve në vlerën 234,325 mijë lekë.

➤ 2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shshpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë alokuar fondet nga transfertat e pakushtezuara, fondet nga transfertat e kushtëzuara, sektoriale, specifike etj, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

▪ **Për vitin 2024** kanë ndodhur 7 ndryshime me VKB, nga të cilat 3 shtesa në buxhet e Bashkisë nga buxheti i shtetit. Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga Sektori i Buxhetit dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Gjirokastër. Plani përfundimtar i shpenzimeve dhe të ardhurave **për vitin 2024** paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Burimet e financimit	Buxheti fillestar 2024	Ndryshimet gjatë vitit 2024		Buxheti perfundi mtar	Emërtimi i shpenzimeve	Buxheti fillestar 2024	Ndryshimet gjatë vitit 2024		Buxheti përfundimtar
		Pakesim	Shtesa				Pakesim	Shtesa	
Të ardhurat e trashëguara			61,196	61,196	Art. 600 Paga	437,672	2,489	36,313	471,496
Transferta e pakushtëzuar	301,911		173,233	475,144	Art. 601 Sig. shoq.e shëndetësore	69,415		5,915	75,330
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	239,264		24,008	263,272	Art.602 Shpenzime operative	155,326	9,720	50,001	195,607
Të ardhura nga tatim taksat e bashkisë	268,100			268,100	Art.603 Subvencione	1,200		300	1,500
Transfertë e kushtëzuar			288,806	288,806	Art. 604 Transf korrente të brendsh	21,550		11,752	33,302
					Art 605Transferimet korrente jashte			1,124	1,124
					Art. 606 Transf të buxhet familj,indivi	2,300		206,073	208,373
					Art. 230-231 Investime	113,720	20,718	271,690	364,693
					Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	8,092	4,000		4,092
Total	809,275	0	547,243	1,356,518		0	809,275	36,927	584,168
									1,355,516

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit

➤ 2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

• **Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Gjirokastër, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Gjirokastër, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Gjirokastër, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

▪ Realizimi i buxhetit për vitin 2024 për shpenzimet në mënyrë të përmbledhur për aparatit e bashkisë dhe institucionet e varësisë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/ lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2024	Plani përfundimtar 2024	Plani i celur 2024	Realizimi i shpenzimeve 2024	% e realizimit/ planit vjetor
Shpenzime për paga (600)	437,672	471,496	473,561	419,033	90%
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	69,415	75,330	71,044	69,597	92%
Shpenzime operative (602)	155,326	195,607	190,919	157,409	80%
Subvencione (603)	1,200	1,500	1,457	1,139	76%
Transferta tek organizatat (604)	21,550	33,302	32,749	31,895	93%
Art 605Transferimet korrente jashte		1,124	1,124	1,124	100%
Transferta tek individët (606)	2,300	208,373	207,686	202,313	97%
Fondi rezervë+e kontigjencës (609)	8,092	4,092	4,092		0

Shpenzime per Oponenca teknike (230)	7,590	14,435	1,600	130	0.9%
Shpenzime per Investime (231)	106,131	350,258	303,916	180,361	51%
a. Nga te ardhurat e transf e pakushtez	113,721	295,938	235,161	122,659	41%
b. Nga Ministrite linjes		68,755	68,755	57,832	84%
Total	113,721	1,355,507	1,288,148	1,063,002	49%
a.Nga te ardhurat e transf e pakushtez	809,275	1,067,712	1,000,342	794,604	74%
b.Nga Ministrite linjes		287,806	287,806	268,398	93%
Total Bashki	809,275	1,355,518	1,288,148	1,063,002	78%

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2024 rezulton se, fondet buxhetore janë realizuar 1,063,002 mijë lekë nga 1,356,518 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 78%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi i fondeve në nivel jo të kënaqshëm në zërat, llog.602 “Shpenzime operative” në masën 80%, llog.603 “Shpenzime për subvencione” në masën 76%, të cilat tregojnë për planifikime me rezervë dhe jo sipas nevojave, si dhe mos kryerje në kohë të procedurave për realizimin e shpenzimeve. Në nivel të ulët janë realizuar fondet në llog.230 “Shpenzimet për investime oponencë teknike” në masën 0.09% dhe llog.231 “Shpenzimet për investime” në masën 51%, ku ndikim më të madh ka patur realizimi në masë të ulët i investimeve me financim nga buxheti i bashkisë të cilat janë realizuar në masën 41%. Realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie referuar akt-rakordimit me thesarin, sipas programeve dhe llogarive të shpenzimeve paraqitet në aneks.

➤ Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2024 janë planifikuar fonde për investime (llog.230-231) në shumën **364,692,384 lekë** (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura + transferte e kushtëzuar) dhe janë realizuar në vlerën **180,491,870.25 lekë, ose në masën 49%**.

- **Fondet për investime nga të ardhurat e Bashkisë.**

Për vitin 2024 janë planifikuar në vlerën 295,938 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 122,659 mijë lekë ose realizuar në masën 41%. Janë planifikuar fonde për financimin e 35 projekteve të investimit, nga të cilat 5 projekte janë financuar pjesërisht, 13 projekte nuk janë realizuar dhe 17 projekte janë financuar plotësisht sipas planit të vitit.

- **Fondet për investime të financuara nga Ministrinë e linjës.**

Për vitin 2024 janë planifikuar në vlerën 68,755 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 57,832 mijë lekë ose në masën 84% për 5 projekte.

Konkluzion: Realizimi në nivel të ulët i fondeve për investime ka ardhur nga mosfinalizimi i projekteve të planifikuara ose janë planifikuar më shumë se vlera e kontratave e lidhura, nga mos realizimi i një pjesë e projekteve të programuara, ndërsa për një pjesë të projekteve të investimeve janë kryer procedurat e prokurimit dhe janë lidhur kontratat me vonesë, duke u financuar pjesërisht ose 0 lekë.

-Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe kontigjencës si dhe fondeve të emergjencave civile

a.Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.

Për vitin 2024 fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës është në total në shumën 8,092 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr. 113 datë 14.12.2023 "Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024" nga shpërndarja e të trashëguarës 2023.", i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 2681, datë 05.04.2024.

b. Fondet e emergjencës.

Në bazë të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 65, nga Ministria e Mbrojtjes (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile) Bashkia Gjirokastrë ka përfutur fonde. Bazuar në VKM nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” dhe me VKB përkatëse është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira, duke i detajuar ato, sipas zërave të shpenzimeve dhe më pas është kryer prokurimi i tyre, sipas të cilave janë kryer shpenzimet.

Për vitin 2024 me VKM nr.260, datë 27.04.2023 “Për miratimin e projekteve fituese të financuara nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore”, Bashkisë Gjirokastër i është akorduar *fondi në vlerën 48,281,143 lekë për realizimin e veprës “Masa inxhinerike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfakës, pranë rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavijë, loti 2”* shkresën nr. 3135, datë 29.03.2023, të ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, (AKMC), “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile” me VKB nr. 95, datë 21.11.2023, shkresës nr 2661, datë 04.04.2024 nga Ministria e Financave, me VKB nr 51, datë 31.07.2024 është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Emërtimi I shpenzimeve	Shuma e planifikuar	Përdorimi	Mbetja
1	Shpenzime për marrjen e masave parandaluese lehtësuese emergjencat civile	5,983,819	4,468,404	1,515,415
2	Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore (91707AB)	1,000,000	0	1,000,000
	Total	6,983,819	4,468,404	2,515,415

Me VKM nr.260, datë 27.04.2023 “Për miratimin e projekteve fituese të financuara nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore”, Bashkisë Gjirokastër i është akorduar *fondi në vlerën 48,281,143 lekë për realizimin e veprës “Masa inxhinerike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfakës, pranë rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavijë, loti 2”*, ku në mënyrë të detajuar këto fonde dhe përdorimi i tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme

Në

lekë

Emergjencat Civile	Fondi I Akorduar fillestar	Fondi I Akorduar I ndryshuar	Fond I realizuar	Teprica
<i>“Masa inxhinerike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e cfakës, pranë rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavijë, loti 2”</i>	48,281,143	34,541,506	34,541,506	0
Total	48,281,143	34,541,506	34,541,506	0

- Raportet e monitorimit.

Për vitin 2024 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" pikat 10, 12, 28, 29, 48.

Për vitin 2024 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:

“Raport monitorimi janar-prill 2024” me shkresën nr. 4695 prot., datë 31.05.2024

“Raport monitorimi janar-gusht 2024” me shkresën nr. 8523 prot., datë 30.09.2024

“Raport monitorimi janar-dhjetor 2024 me shkresën nr. 2041 prot., datë 28.02.2025.

Nga auditimi i raporteve të monitorimit rezulton se në to janë pasqyruar saktë treguesit e realizimit të buxhetit referuar dhe akt akordimit me degën e thesarit. Po kështu këto të dhëna janë pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të saktë në raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të bashkisë.

• **Burimet e financimit të buxhetit vjetor**

Realizimi i buxhetit për vitin 2024 sipas burimit të financimit paraqitet në aneks.

Realizimi i buxhetit për vitin 2024 sipas burimit të financimit paraqitet në aneks:

Në 000/lekë

Artikulli buxhetor	Plan përfundimtar 2024	Fakt 2024	% e realizimit
Shpenzime për paga (600)	471,496	419,033	89%
Transferta e pakushtëzuar	164,695	154,904	
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	207,998	192,295	
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	92,107	65,575	
Transferta e kushtëzuar	6,696	6,260	

Shp për sig shoqërore/shëndetësore (601)	75,330	69,597	92%
Transferta e pakushtëzuar	25,217	23,673	
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	28,735	27,700	
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	20,230	17,179	
Transferta e kushtëzuar	1,148	1,045	
Shpenzime operative dhe shërbime (602)	195,607	157,409	80%
Transferta e pakushtëzuar	101,405	76,883	
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	18,505	17,451	
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	73,419	62,848	
Sponsorizime			
Transferta e kushtëzuar	2,278	227	
Subvencione (603)	1,500	1,139	76%
Transferta e pakushtëzuar	1,200	882	
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	300	257	
Transferta tek organizatat (604)	33,302	31,895	96%
Transferta e pakushtëzuar	6,000	5,998	
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	20,050	19,497	
Transferta e kushtëzuar	7,252	6,400	
Transferime korrente jashte (605)	1,124	1,124	
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	1,124	1,124	
Transferta tek individët (606)	208,374	202,313	97%
Transferta specifike			
Transferta e pakushtëzuar	3,316	3,301	
Transferta e pakushtëzuar sektoriale			
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	3,380	2,378	
Sponsorizime			
Transferta e kushtëzuar	201,677	196,634	
Fondi rezervë + kontigjencës (609)	4,092	0	0%
Transferta e pakushtëzuar	4,092		
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore			
Hartim projektesh dhe oponenca teknike (230)	14,435	130	1%
Transferta e pakushtëzuar	1,600	130	
Transferta e pakushtëzuar sektoriale			
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	12,835	0	
Te ardhura			
Shpenzime për investime (231)	350,258	180,361	51%
Transferta e pakushtëzuar	175,574	63,034	
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	78		
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	105,851	59,495	
Sponsorizime			
Transferta e kushtëzuar	68,755	57,832	
Total	1,355,517	1,063,002	78%

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit

Duke u nisur nga burimi i financimit për vitin 2024 shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 228,353 mijë lekë ose në masën 21 %, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale në shumën 566,251 mijë lekë ose në masën 54%, transferta e kushtëzuar në shumën 268,398 mijë lekë ose në masën 25%.

➤ **2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve etj.**

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:

Në 000/lekë

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog 602+606	Llog. 230+231
Viti 2024	2,354,462	2,354,462		962,962	1,391,500

• ***Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikujduara***

Me fondet e vitit buxhetor 2024, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas fondeve të ardhura nga ministritë e linjës.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, deri në fund të periudhës 31.12.2024 dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportin vjetor të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2023	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2024 - 31.12.2024	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2024	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2024
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Bashkia	219,273	1,391,500	1,610,773	219,273	1,391,500
b. Investime nga Ministrinë e linjës			0		0
INVESTIME :			0		0
Mallra dhe shërbime					0
Vendime gjyqësore	962,962		962,962		962,962
Totali :	1,182,235	1,391,500	2,573,735	219,273	2,354,462

Gjatë vitit 2024 janë krijuar 6,925,432.4 lekë detyrime, por njëkohësisht është likuiduar vlera prej 5,753,205.4 lekë, dhe vlera e detyrimit të mbetur të palikuiduar në fund të vitit 2024 është 2,354,462 lekë e ndarë:

- Detyrime te ministrive të linjës..... 1,391,500 lekë
- Vendime gjyqësore.....962,962 lekë

Në lekë

Emertimi	Emri I Furnitorit	Nr. Fature	Date Fature	Gjendje 31.12.2023	Likuiduar gjatë vitit 2024	Shtesa gjatë vitit 2024	Gjendje 31.12.2024
Vendim Gjyqësor nr. 123, dt 09.03.2010	A. M.			435,352			435,352
Vendim Gjyqësor nr. 316, dt 03.06.2021	F. H.			527,610			527,610
Mikqyrje punimesh "Ujesjellsi Lazarat"	A. Shpk	07/2023	06.03.2023	219,273	219,273		
Mobilimi i kinemase multifunksio Try Gjirokaster	B. N.	05/2024	05.02.2024			1,391,500	1,391,500
Kolaudim ujesjellsi Lazarat	D. Shpk	01/2024	15.01.2024		427,074	427,074	0
Mbikq "Riveshje asfaltike ne rrugen Ibrahim Sino"	G. Shpk	88/2023	11.11.2023		79,391.2	79,391.2	0
Permisimi I kushteve te banimit per komunitete e varfera dhe te pafavorizuara	T. sh.p.k	5/2024	17.04.2024		5,027,467.2	5,027,467.2	0
Totali				1,182,235	5,753,205.4	6,925,432.4	2,354,462

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar shkresës nr. 1468 prot, datë 26.02.2024 "Raport vjetor i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare për periudhën janar-dhjetor 2023, Bashkia Gjirokastër" të dërguar në MF dhe sipas publikimit në faqen e saj, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2023 paraqiten në shumën 1,182,235 lekë. Ndërsa në fund të vitit 2024 detyrimet e prapambetura të raportuara me shkresën nr. 1971 prot, datë 28.02.2025 dhe të publikuara në faqen e MF paraqiten në shumën 2,354,462 lekë, sipas pasqyrës së mëposhtme:

Në lekë

N.R	Emertimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzi me vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëvesh financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëvesh financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	2,354,235		0.30%
Llog ekon	Emertimi			
4864100	Vendime Gjyqësore	962,962		
4864200	Det.Prap. Shërbime	0		
4864201	D.P.Energji Elektirke	0		
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	0		
4864400	Det.Prap. Investime	0		
4864500	Det.Prap.Rimbursim t.v.sh.	0		
4864600	Mallra	1,391,500		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	0		
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal	0		

4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	0		
4864901	Paga	0		
4864902	Shpronosime	0		
4864903	Transferime te individët	0		
4864904	Transferime te Subjektet	0		
III	Totali (I+II)	2,354,462	794,604,086	0,30%

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit

Vështirësia financiare.

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (të akumuluar) në fund të vitit 2024 paraqiten në vlerën 2,354,462 lekë dhe pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 0.3 % kundrejt fondeve faktike. Kjo situatë tregon se Bashkia Gjirokastër konsiderohet në situatë normale e gjendjes financiare, pasi nuk e ka kaluar pragun 15% në fund të vitit ushtrimor. Gjithashtu raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore faktike për shpenzime është nën nivelin prej 25%, kështu duke mos u konsideruar institucion në vështirësi financiare sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimit e MF nr. 35, datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 33.

➤ 2.5 Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2024 në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër janë alokuar fonde nga Ministritë e linjës për 4 projekte investimi, ku 3 nga të cilat janë projekte në vazhdim dhe 1 projekt është me kontratë të lidhur në vitin 2024. Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Objekti i kontratës	Burimi t financimit (Bashkia/Grand e/M.Linjë/FZH SH	Fond Planifikuar për vitin 2024	Kontrata me subjektin		Subjekti i kontraktuar	Likuidimi		Mbetja 2025
				Nr. /datë lidh kontratës	Vlerë kontrate		Viti 2023 e para tij	Viti 2024	
1	Ujesjellsi Lazarat	Ministri e linjës	427,075		268,062,887.00	B.	247,428,310		427,075.00
2	Mbikqyrje ujsjellsi Lazarat	Ministri e linjës	631,238.00	22.06.2020	3,082,873.00	A.	2,001,635.70	631,237.71	0.29
3	Kolaudim Ujesjellsi Laszatar	Ministri e Linjës	427,074	08.04.2022	427,074.32	D. shpk		427,074.00	0.32
4	Rikonstruksion dhe permisimi i eficences energjitike shk. M.Gjollësia	Ministri e linjës bashkëfinancim me Bashkinë	19,106,209	19.11.2024	17,375,781.78	N. SHPK		3,437,334.00	15,668,875.00
5	Totali		20,591,596		18,434,094			4,495,645	16,095,950

Nga auditimi i dokumentacionit financiar dhe mbështetës të marra nga Drejtoria e Financës për vitin 2024 në lidhje me investimet publike u konstatua se:

Bashkia për këto investime ka marrë angazhime buxhetore disa mujore, të cilat janë regjistruar kundrejt planit vjetor në sistemin Informatik financiar të Qeverisë nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastër.

Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Gjirokastër. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent. Kontrata është regjistruar e plotë me qëllim pagesën e saj në afate mujore, pra nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në degën e thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Konkluzion: Nga auditimi rezulton se, detyrimet e papaguara në fund të vitit 2024 paraqiten në shumën 2,354,462 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime për investime në vlerën 1,391,500 lekë dhe detyrime për shpenzime për vendimeve gjyqësore në vlerën 962,962 lekë. Referuar totalit të shpenzimeve për vitin 2024 dhe vlerës së faturave të palikujduara, Bashkia Gjirokastër klasifikohet në situatë pa vështirësi financiare. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, nenet 5/c, 40/h, me Udhëzimin e MFE nr. 09, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të e

buxhetit” i ndryshuar, pikat 48/i, 58,130, me Udhëzimin e MF nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore” shtojca 4 germa (c), me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

(Trajtuar më hollësisht në akt konstatimin nr.3, datë 30.04.2025)

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale e ndryshimet e tyre;
- PBA dhe program vjetor si dhe monitorimet dhe raporti i konsoliduar financiar në lidhje me planifikimin dhe të ardhurat
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifave vendore;
- Dokumentacioni i Drejtorisë të Taksave në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifave vendore;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara, akt-rakordimet me Thesarin;

➤ Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Gjirokastrë struktura organizative për vitin 2024 është miratuar me urdhrat e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, nr. 730, datë 27.09.2024 dhe nr. 85, datë 12.12.2024. drejtoria është e organizuar me 3 sektorë dhe ka funksionuar me 27 punonjës.

	Viti 2024	
	Struktura	Fakt
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik,Bujqesise ,Taksave dhe Performances	7	7
Drejtor Drejtorie	1	1
Sektori Zhvillimit Ekonomik,Bujqesise ,Taksave	3	3
Përgjegjës Sektori	1	1
Specialistë	2	2
Sektori i Performances	3	3
Përgjegjës Sektori	1	1
Specialistë	2	2
Angjensia e Tatim Taksave	20	20
K/Inspektor	1	1
Inspektor për kontrollin në terren dhe ndjekjen e debitorve në qytet	10	10
Inspektor Qytet	6	6
Inspektor Nj.Admin	4	4
Sektori i menaxhimit të ndërmarrjeve dhe tregjeve publike	9	9
Evidencier	3	3
Roje	4	4
Sanitare	2	2
Punonjës gjithsej	27	27

Burimi: Bashkia Gjirokastrë, përpunuar nga grupi i auditimit

➤ Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Administrimi i taksave vendore bëhet me Excel, ku janë të pasqyruara regjistrat e biznesit të madh dhe të vogël me bazën e të dhënave përkatëse, me ngarkesat për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pagesat dhe gjendjet debitorë, si dhe bazën e të dhënave për secilin taksapagues, me njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik, pronaret e pasurive të paluajshme

dhe abonentët familjarë. Sipas të dhënave të Drejtorisë së të ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (DAPPLL), gjendja dhe statusi i subjekteve tatimpagues në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Gjirokastrer paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Viti	Gjendja Nëfillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Pezullimipërko hshëmiaktivitetit/Pasiv	Mbyllur Aktiviteti	Gjendjanë fund të vitit total
BiznesiVogël	2024	1057	166	25	53	1145
BiznesiMadh	2024	235	11	6	5	235
Institucione	2024	38	0		1	38
Total		1330	177	31	58	1418

Burimi: DAPPLL, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sa më sipër rezultoi se në fund të vitit 2024 janë aktiv 1418 subjekte të biznesit. Gjatë vitit 2024 janë mbyllur 58 subjekte. Në progresiv rezultojnë 31 subjekte të cilat janë me status pushim i përkohshëm i aktivitetit apo pasiv për vitin 2024.

• Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2024, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Gjirokastrer është miratuar me VKB nr.104, datë 04.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2024”.

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024 është kryer nga drejtoritë përkatëse sipas përgjegjësiwe përkatëse për përllogaritjen e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2023 miratuar me VKB nr.104, datë 04.12.2023 “Për miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Gjirokastrer dhe PBA 2025-2027. Plani dhe realizimi sipas llojeve të të ardhurave referuar akt-rakordimit me Thesarin dhe raportit të konsoliduar për veprimtarinë financiare për zbatimin e buxhetit të Bashkisë Gjirokastrer për vitin 2024 paraqiten në tabelën në Aneks.

Në 000/lekë

Nr	LLOJI I TË ARDHURËS	Plan 2023	Fakt 2023	Plan 2024	Fakt 2024	Fakt %
A	TE ARDHURA NGA TAKSAT-TATIMET	80,925	82,446	95,808	93,433	98%
1	Taksë mbi Ndërtesën	39,405	32,570	40,637	34,196	84%
	a) Biznesi i vogël	9,228		10,006	7,655	77%
	b) Biznesi i madh	8,183		7,947	6,499	82%
	c) Familjarët	19,938		19,938	17,195	86%
	d) Debitorët	2,056		2,746	2,847	104%
2	Taksa e Truallit	1,137	1,117	1,383	1,460	106%
3	Taksë Vendore mbi Bizn. Vogël			-		
4	Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin*	176	239	150	314	209%
5	Tat. Shitja e Pas.së Paluajtsh.	724	477	750	946	126%
6	Taksa Vjetore për Qarkullimin e Mjeteve të Përdorura	21,239	23,116	21,223	27,463	129%
7	Taksë mbi Tokën Bujqësore	7,020	4,617	7,207	5,041	70%
	a. Rezident	3,617		3,713	3,899	105%
	b. Jo rezident	3,403		3,494	1,142	33%
8	Taksë Fjetje në Hotel	1,224	3,555	8,458	5,434	64%
9	Taksë Ndikimi në Infrastrukturë	4,000	4,464	7,000	4,857	69%
10	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	6,000	12,291	9,000	13,722	152%
B	TË ARDHURA NGA TARIFAT	138,070	138,467	148,516	133,627	90%
1	Tarifa e Pastrimit	51,267	47,986	52,532	46,012	88%
	a) Biznesi i vogël			12,270	8,258	67%
	b) Biznesi i madh			14,326	11,266	79%
	c) Familjarët			19,002	20,053	106%
	d) Debitorët			4,654	4,545	98%
	e) Entet			2,280	1,890	83%
2	Tarifa e Reklamës	5,562	4,799	5,492	4,129	75%
3	Tarifa e Ndrichimit Rrugor	29,947	28,377	31,034	30,471	98%
	a) Biznesi i vogël			7,913	5,337	67%
	b) Biznesi i madh			4,060	3,177	78%
	c) Familjarët			14,849	18,052	122%
	d) Debitorët			3,192	3,125	98%
	e) Entet			1,020	780	76%
4	Tarifa e Infrastrukturës Arsim, Sport, Kulture	13,803	11,679	14,734	11,036	75%
	a) Biznesi i vogël			1,957	1,320	67%
	b) Biznesi i madh			1,097	831	76%
	c) Familjarët			10,220	7,272	71%
	d) Debitorët			1,460	1,613	110%
5	Tarifë Gjelbërimi	6,999	12,021	7,120	10,860	153%
	a) Biznesi i vogël			1,971	1,305	66%

	b) Biznesi i madh			1,917	1,506	79%
	c) Familjarët			2,872	7,799	272%
	d) Entet			360	250	69%
6	Tarifë Parkimi	6,032	4,637	5,468	5,005	92%
	a) Biznesi i vogël			413	544	132%
	b) Biznesi i madh			155	325	210%
	c) rezervuar			1,400	1,899	136%
	d) parkimi nëntokësor			3,500	2,237	64%
7	Tarifë Regjistrimi	80	52	50	67	134%
8	Tarifë e Shërbimit Veterinar		35	-		
9	Tarifë Zënie Hapësire Publike	425	1,245	365	2,386	655%
10	Tarifë Zënie Hapësire Publike në Zonën Muzeale	400		900		
11	Leje Transporti	600	275	384	178	46%
12	Çertifikatë Transporti	227	128	138	341	247%
13	Leje Taksi	280	136	280	58	21%
14	Leje Shfrytëzim Karburanti	2,000	650	6,450	3,350	52%
15	Vendim Leje Ndërtimi	150	160	250	200	80%
16	Tarifë për Studim e Projektim			-		
17	Vendim Shesh Ndërtimi	100	25	150	85	57%
18	Kërkesë Leje Ndërtimi	200	270	300	120	40%
19	Vërtetime Akt-Kolaudime			-		
20	Çertifikatë Përdorimi	50	45	100	15	15%
21	Tarifë nga Përpunim i Mbetjeve Urbane			-		
22	Vërtetime	300	180	300	106	35%
23	Deklarata-Përkrahja Sociale			-		
24	Tarifë Lidhje Kontrate	360	452	510	570	112%
25	Të ardhura të tjera	300	121	300	114	38%
26	Njoftim Fillim Punimesh	980	990	1,120	796	71%
27	Qira Trualli	500	1,969	2,188	814	37%
28	Qira Objekti	123	545	63	171	271%
29	Qira Tregu Agro-Ushqimor	2,292	1,603	2,295	2,434	106%
30	Qira Tregu industrial	4,752	5,268	4,680	4,020	86%
31	Qira Toke Bujqësore	757	545	929	391	42%
32	Tarifë për Mirëmbajtjen Varrezave	1,040	1,006	1,040	1,089	105%
33	Projekti Transizmik			-		
34	5% Garanci Defektsh			-		
35	Gjoha	700	2,392	1,500	1,019	68%
36	Shitja e Produkteve Bujqësore dhe Pyjore	5,228	5,260	5,228	5,668	108%
37	Sponsorizime		3,106	-		
38	Tarifë për Shfrytëzimin e Lëndës Drusore		20	-		
39	Ujë për Vaditje	116	182	116	204	176%
40	Tarifë Shërbim Varrimi	2,500	2,308	2,500	1,918	77%
C	Të ARDHURA NGA INSTITUCIONET NË VARËSI	11,482	20,773	23,776	23,186	98%
1	Drejtoria e Arsimit	8,076	8,262	8,076	8,099	100%
2	Drejtoria e Artit & Kulturës			500		0%
2	Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë & Sporteve	3,050	12,328	15,000	14,714	98%
3	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri	356	183	200	373	187%
	TOTALI	230,477	241,686	268,100	250,246	93%

Burimi: Situacioni i rakordimit të thesarit nga DF dhe DAPPLL

Për vitin 2024 referuar të dhënave dhe dokumentacionit të DAPPLL, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkia Gjirokastrë janë realizuar në shumën 250,246 mijë lekë nga 268,100 mijë lekë të parashikuara, ose në masën 93%, (17,854 mijë lekë më pak). Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin, kështu :

a. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim të ulët të planit si:

- **Taksa mbi tokën bujqësore** është realizuar në vlerën 5,041 mijë lekë nga 7,207 mijë lekë e planifikuar ose në masën 70%.
- **Taksë fjetje në hotel** është realizuar në vlerën 5,434 mijë lekë nga 8,458 mijëlekë e planifikuar ose në masën 64%.
- **Tarifa e reklamës** është realizuar 4,129 mijë lekë nga 5,492 mijë lekë e planifikuar ose në masën 75%,
- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja** është realizuar 4,857 mijë lekë nga 7,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 69%,
- **Leje transporti** është realizuar 178 mijë lekë nga 384 mijë lekë e planifikuar ose në masën 46%,
- **Leje taksi** është realizuar 58 mijë lekë nga 280 mijë lekë e planifikuar ose në masën 21%.

- *Leje shfrytëzim karburanti* është realizuar 3,350 mijë lekë nga 6,450 mijë lekë e planifikuar ose në masën 52%.
- *Vërtetime* janë realizuar në vlerën 106 mijë lekë nga 300 mijë të planifikuara, ose në masën 35%
- *Vendim shesh ndërtimi* janë realizuar në masën 57%, *kërkesë leje ndërtimi* janë realizuar në masën 40%, *certifikatë përdorimi* në masën 15%
- *Qira trualli* janë realizuar në vlerën 814 mijë lekë nga 2188 mijë lekë, ose në masën 37%
- *Qira toke bujqësore* është realizuar 391 mijë lekë nga 929 mijë lekë e planifikuar ose në masën 42%.
- *Gjoba* është realizuar 1,019 mijë lekë nga 1,500 mijë lekë e planifikuar ose në masën 68%.

b. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim mbi planin si:

- *“Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin”* është realizuar 314 mijë lekë nga 150 mijë lekë e planifikuar ose në masën 209%.
- *Tatim nga shitja e pasurive të paluajtshme* janë realizuar 946 mijë lekë nga 750 mijë lekë e planifikuar ose në masën 126%.
- *Certifikate transporti* është realizuar 341 mijë lekë nga 138 mijë lekë e planifikuar ose në masën 247%.
- *Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura* janë realizuar 27,463 mijë lekë nga 21,223 mijë lekë e planifikuar ose në masën 129%.
- *Tarifë zënie hapësire publike* është realizuar 2,386 mijë lekë nga 2,386 mijë lekë e planifikuar ose në masën 655%.
- *Tatimi mbi të ardhurat personale* është realizuar 13,722 mijë lekë nga 9,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 152%.
- *Tarifë gjelbërimi* është realizuar 10,860 mijë lekë nga 7,120 mijë lekë e planifikuar ose në masën 153%.
- *Tarifë e qirasë objekteve* janë realizuar 171 mijë lekë nga 63 mijë lekë e planifikuar ose në masën 271%.
- *Tarifa nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri* janë realizuar 373 mijë lekë nga 200 mijë lekë e planifikuar ose në masën 187%.
- *Tarifë regjistrimi* është realizuar 67 mijë lekë nga 50 mijë lekë e planifikuar ose në masën 134%.
- *Tarifë për ujë për vaditje* është realizuar 67 mijë lekë nga 50 mijë lekë e planifikuar ose në masën 176%.

Konkluzion: Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet më shumë mbi planin, fakt që tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është mbi baza reale dhe realizimi i viteve të mëparshme nuk është marrë në konsideratë në planifikim. Gjithashtu për një pjesë të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, **neni 5, germa (a)** në të cilën përcaktohet se: “Në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme.” **neni 6** në të cilën përcaktohet: “Njësia vendore të vendosë rregulla që sigurojnë disiplinë fiskale, politika të qëndrueshme dhe transparente për menaxhimin e fondeve publike, përshirë rregulla për parashikimin realist të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore.”
- Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, **neni 51, neni 9** “Të drejtat dhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore”, **pika 1.3.** në të cilën përcaktohet se: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, ku sipas **nënpikës (ç)** duhet të mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

- Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.
- Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për biznesin

Në Bashkinë Gjirokaster subjektet tregtarë ngarkohen me detyrime vendore për taksën e regjistrimit, mbi truallin, pasuri, pastrim, ndriçim, tarifën e gjelbërimit, etj.,

Për vitin 2024 gjendja e debitorëve të biznesit të madh dhe të vogël sipas llojit të taksave paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Debia Progressive e Bizneseve deri ne 31.12.2024 .

Në lekë

	Nr	Debia progresive 01.01.2024	Shtesa	Pakesime	Debia progresive 31.12.2024
Qytet					
B.V	688	47,208,975	10,685,129	13,523,097	42,066,554
B.M	55	17,008,454	2,955,247	6,191,746	13,771,956
TOTALI	743	64,217,429	13,640,376	19,714,843	55,838,510
Nj. Adm.					
B.V	90	2,418,789	445,648	97,964	2,766,473
B.M	12	3,110,755	467,000	389,605	3,188,150
Totali	102	5,529,544	912,648	487,569	5,954,623
TOTALI	845	69,746,973	14,553,024	20,202,412	61,793,132

Burimi: *DZHEBTP, përpunuar nga grupi i auditimit*

Në bazë të përpunimit të të dhënave të dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP) në Bashkinë Gjirokastrë, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifave vendore nga biznesi, ku në **fund të vitit 2023 vlera debitorëve është 69,746,973 lekë**, vlerë e cila është zvogëluar **në fund të vitit 2024** në shumën progresive prej **61,793,132 lekë** e përbërë nga:

- 67 subjekte “Biznesi i Madh” në vlerën 16,960,106 lekë.
- 778 subjekte “Biznesi i Vogël” në vlerën 44,833,026 lekë.

Dinamika e Borxhit:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se struktura e borxhit për subjektet e biznesit të madh, biznesit të vogël dhe pronarë të bizneseve, sipas kohës së krijimit të tij paraqitet si më poshtë:

Mosha e Borxhit ne fund te vitit 2024	Vlera/lekë	Nr. Subjekte
2-3 vit	12,053,108	108
3-5 vjet	9,520,397	79
Mbi 5 vjet	4,304,115	21
Totali	25,877,620	208

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se vlerën më të lartë të borxhit e zënë debitorët e të krijuar mbi 2-3 vjet në vlerën 12,053,108 lekë e totalit dhe debitorët e krijuar mbi 3-5 vjet në vlerën 9,520,397 lekë e totalit.

- Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për familjarët.

Në Bashkinë Gjirokastrë familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, taksën e truallit, tarifën e pastrimit, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike, tarifën e sport-kulturës etj.

- Për mbledhjen e taksave dhe tarifave nga familjarët Bashkia Gjirokastrë ka nënshkruar me Agjentin Tatimor Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë (SHRUKGJ) akt marrëveshjet: nr.290, datë 13.01.2024 për Njësitë Administrative, Qytet, nr. 291, datë 13.01.2024 mbi arkëtimin e tarifave dhe taksave për 6 Njësitë Administrative fshat si: Cepo, Antigone, Lazarat, Lunxheri, Odrie , Picar.

Për vitin 2024 të ardhurat e realizuara nga agjenti tatimor (SHRUKGJ) janë në shumën 71,456 mijë lekë, ndërsa për vitin 2023 të ardhurat e realizuara janë në shumën 61,285 mijë lekë. Pra kemi një rritje të të ardhurave në vlerën 10,171 mijë lekë. Në fund të vitit 2023 janë 1174 debitorë familjarë në vlerën 91,715,152 lekë. Debitorët familjarë në datë 31.12.2024 janë në vlerën 106,085,480 lekë, e cila përbëhet nga:

- Njësitë Administrative qytet me 2959 debitorë në vlerë progresive prej **72,807,540** lekë.

b.6 Njësitë Administrative fshat me 3134 debitorë në vlerë e krijuar gjatë vitit 2024 prej **13,075,528** lekë, e cila ka të përfshirë:

- Debinë e taksës së tokës të krijuar në vitin 2024 në vlerën 4,619,816 lekë dhe
- Debinë për Njësitë Administrative për familjarët sipas rakordimit me agjentin tatimor SHRUK, Gjirokastër në 31.12.2024 është në vlerën 8,455,712 lekë

Për mbledhjen e këtyre detyrimeve nuk është bërë punë e mjaftueshme, duke mos marrë masa shtrënguese për taksapaguesit debitorë familjarë. Detyrimet e familjeve për taksat dhe tarifat vendore sipas njësive janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

në lekë

NR	Njësitë Administrative	Taksa mbi tokën bujqësore		Taksë ndërtese		Tarifë pastrimi		Tarifë ndriçimi		Tarifë për varrezave mirëmbajtjen publike		Tarif kulturë, sport		Taksë trualli		TOTALI
		Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	
1	Cepo	861	1,572,567	794	277900	794	476400	794	476400	794	397000	794	476400	439	36876	3,713,543
2	Antigone	131	291,811	392	137200	392	235200	392	235200	392	196000	392	235200	113	9492	1,340,103
3	Lunxhëri	612	1,216,729	559	195650	559	335400	559	335400	559	279500	559	335400	327	27468	2,725,547
4	Lazarat	661	581,840	807	282450	807	484200	807	484200	807	403500	807	484200	575	48300	2,768,690
5	Odrje	231	336,097	272	95200	272	163200	272	163200	272	136000	272	163200	168	14112	1,071,009
6	Picar	480	620,772	310	108500	310	186000	310	186000	310	155000	310	186000	171	14364	1,456,636
	TOTAL	2976	4,619,816	3134	1,096,900	3134	1,880,400	3134	1,880,400	3134	1,567,000	3134	1,880,400	1793	150,612	13,075,528

Burimi: DAPPLL, përpunuar nga grupi i auditimit.

- Menaxhimi borxhit nga taksat e tarifat vendore. Auditimi i rasteve në lidhje me zbatimin e masave shtrënguese për arkëtimin e borxhit ndaj subjekteve debitorë.

Konkluzion: Debitorët për taksa dhe tarifa vendore gjithsej në vlerë progresive në fund të vitit 2023 janë **180,824,397 lekë**, vlerë e cila është zvogëluar në fund të vitit 2024 në shumën progresive prej **161,996,949 lekë** e përbërë nga:

- 845 subjekte debitorë biznesi i madh dhe i vogël në vlerën 61,793,132 lekë.
- 11794 debitorë familjarë për taksa dhe tarifa në vlerën 81,263,252 lekë
- 3472 debitorë për taksën e tokës në vlerën 18,940,565 lekë

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë ka sjellë tardhura të munguara për Bashkinë Gjirokastër në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, nenet 6 dhe 9 pika 1.3.

Gjithashtu vlera e debitorëve e krijuar gjatë vitit 2024 nuk është përfshirë në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm në mbyllje PF të vitit 2024, pasi vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore të evidentuar në këtë llogari është në vlerën 15,931,835 lekë, e cila i përket viteve para 2023. Nga DAPPLL nuk është dërguar asnjë informacion me shkresë drejtorisë së Financës për debitorët e rezultuar nga kontabilizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me me UMF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në UMFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kap. III, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve” paragrafi “Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve” faqe 28-30.

Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijjnë duke u përshkallëzuar si:

- 1.Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
- 2.Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
- 3.Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
- 4.Sekuestrimi i pasurisë.

Konkluzion: Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Gjirokastër për vjeljen e detyrimeve janë mjaftuar vetëm me nxjerrjen e njoftim-vlerësim detyrimin dhe nuk është aplikuar asnjë masë tjetër shtërnguese, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB nr. 104, datë 04.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2024”.

• **Analiza e disa zërave kryesore të detyrimeve fiskale (taksa/ tarifa vendore):**

▪ **Tarifë për zënie hapësire publike** që ka kontribuar me 2,9 % të totalit të të ardhurave. Realizimi i tarifës për zënie të hapësirës publike është 2,386 mijë lekë nga 1,265 mijë lekë të planifikuara, pra në masën 188%.

Referuar paketës fiskale të e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Gjirokastrë miratuar me VKB nr.104, datë 04.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë e Gjirokastrë, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin ushtrimor”, për zënie të hapësirave publike.

Me VKB nr. 39, datë 31.05.2022 “Rregullat e përdorimit të hapësirës publike në zonën e pazarit karakteristik të Bashkisë Gjirokastrë (për Zonën Muzeale të Pazarit)”, e cila ka përcaktuar tarifa për hapësirën publike të diferencuara nga paketa fiskale për këtë zonë.

Te ardhurat e shrytezimit të hapësirave publike për vitin 2024 në shumën 1,473,934 lekë nga dhënia në shfrytëzim i sipërfaqes prej 1397 m2 hapësirë publike, e cila është përlllogaritur sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 13 Faturimi i të ardhurave për hapësirat publike tavolina jashtë lokalit.etj/lekë

Muajt	metra (katror)	Total	Total shuma
Janar	146	52,800	52,800
Shkurt	-	-	-
Mars	190	34,200	34,200
Prill	38	45,600	45,600
Maj	413.6	405,480	405,480
Qershori	434.02	861,784	861,784
Korrik	41	49,824	49,824
Gusht	-	-	-
Shtator	36.7	6,606	6,606
Tetor	-	-	-
Nentor	-	-	-
Dhjetor	98	17,640	17,640
TOTAL	1397.32	1,473,934	1,473,934

-Vlera prej 1,473,934 lekë janë arkëtimet nga kontrata e zënies së hapësirës publike nga bizneset. Ndërsa vlera prej 912,000 lekë nga shfrytëzimi i hapësirës publike nga tregtarët e tregut frutaperime.

▪ **Planifikimi dhe arkëtimi i taksës së tokës bujqësore.**

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2024 taksa e tokës është realizuar në shumën 5,041 mijë lekë nga 7,207 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 70%. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore sipas paketës është Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.

Planifikimi i taksës së tokës në shumën 24,680,535 lekë, është përlllogaritur mbi bazën e sipërfaqes së ndarë prej 5412 ha sipas NjA-ve dhe kategorive shumëzuar për tarifën e përcaktuar sipas kategorive në paketën fiskale, e cila pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

Kategoria e tokës	Totali Sip ne ha	Sip/ha NjA Lazarat	Sip/ha NjA Antigone	Sip/ha NjA. Cepo	Sip/ha NjA. Odrie	Sip/ha NjA. Picar	Sip/ha NjA. Lunxheri	Lekë ha/vit Sipas VKB	Pritshmëri a vjetore Lekë
Kategoria I	0	0	0	0	0	0	0	2,800	0
Kategoria II	225	70	45	65	45	0	0	2,100	472,500
Kategoria III	890	180	110	245	65	170	120	1,400	1,246,000
Kategoria IV	1310	240	245	250	155	205	215	1,350	1,768,500
Kategoria V	1090	70	75	235	120	195	395	1,250	1,362,500
Kategoria VI	1109	60	114	190	100	115	530	1,200	1,330,800
Kategoria VII-X	788	75	91	106	74	36	406	1,100	866,800
Totali	5412	695	680	1091	559	721	1666		7,047,100

Ndjekja e procedurave për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.

Në fund të vitit 2023 debitorë për taksën e tokës bujqësore janë 6922 familje fermere në vlerë progresive prej 19,362,272 lekë. Gjatë vitit 2024 janë krijuar 2976 debitorë në vlerën 4,619,816 lekë. Ndërsa në fund të vitit 2024 për taksën e tokës janë debitorë 3482 familje fermere në vlerën

progresive prej **18,940,565 lekë**. Debitorët në mënyrë të detajuar sipas njësive administrative paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Njësiti Administrative	01.01.2024	Pakesuar 2024	Shtuar 2024	Numri I familjeve debitoreve	Debia 31.12.2024
PICAR	4,031,207	740,108	620,772	490	3,911,871
ODRIE	1,916,209	268,590	336,097	263	1,983,716
ANTIGONE	878,356	643,371	291,811	203	526,796
CEPO	6,702,168	1,293,371	1,572,567	881	6,981,364
LAZARAT	2,278,590	442,426	581,840	705	2,418,004
LUNXHERI	3,555,742	1,653,657	1,216,729	940	3,118,814
TOTALI	19,362,272	5,041,523	4,619,816	3,482	18,940,565

Burimi: DAPPLL, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga Sektori i Mbledhjes dhe Kontrollit të të Ardhurave për Njësiti Administrative nuk është kryer punë e mjaftueshme për përditësimin e të dhënave si dhe për rritjen e arkëtimeve dhe uljen e borxhit për taksën e tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 6, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3. në të cilën përcaktohet se: “Njësiti e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës nënpika ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

▪ Taksa e fjetjes në hotel

Taksa e fjetjes në hotel, e cila zë 1 % të të ardhurave. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Gjirokastrë sipas parashikimeve të paketës fiskale të vitit 2024 miratuar me VKB nr. 104, datë 04.12.2023, pika 1.3 në të cilën përcaktohet se: “Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel. Referuar paketës fiskale për hotelet me 4-5 yje niveli i taksës për fjetjen në hotel është 175 lekë për natë fjetje ndërsa për hotelet e tjera dhe bujtinat dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin është 70 lekë për natë fjetje.

Numri i hoteleve dhe bujtinave që operojnë në Bashkinë Gjirokastrë është 75 hotele të përberë nga 507 dhoma dhe me 943 shtretër.

Taksimi i hoteleve është bërë në bazë të deklaratimit të regjistrave të hotelit, gjë që në të shumtën e rasteve nuk është reale, duke sjellë evazion fiskal. Ndërsa për shtëpitë që përdoren si bujtina nuk ka të dhëna.

Për vitin 2024 taksa për fjetje në hotel është planifikuar në vlerën 8,458 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 5,434 mijë lekë, ose në masën 64%, ndërsa në vitin 2023 është planifikuar 1,224 mijë lekë dhe është realizuar në masën 290% ose në vlerë 3,555 mijë lekë. Nga viti 2024 ne krahasim me vitin 2023 kemi një rritje në vlerë 1,879 lekë.

• Menaxhimi i të ardhurave nga gjobat për pagesa të vonuar (kamatëvonesat)

Debitorët që rezultojnë të tillë në fillim të çdo viti ushtrimor dhe plotësojnë deri në fund të vitit ushtrimor afatin për 365 ditë të të qenit debitor duhet të paguajnë gjobë për pagesë në masën 21,9% të vlerës së detyrimit.

Konkluzion: Gjatë vitit 2024 Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave nuk ka aplikuar gjobë për pagesa të vonuara për detyrimet e vitit 2023 për takspaguesit e biznesit, për pasojë nuk janë bërë as faturime dhe as arkëtime për kamatëvonesën në kundërshtim me Ligjit nr 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe me VKB nr.104, datë 04.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Gjirokastrës, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin ushtrimor”

Ndërsa ditvonesat e mospagesës së detyrimit nga BM dhe BV për vitin 2024 ngarkohen në faturën e vitit 2025.

▪ Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Gjirokaster dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Gjirokaster me të cilin mbahen akt-rakordimet mujore. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë: në 000/lekë

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	Vlera realizuar Viti 2023	Vlera realizuar Viti 2024
Drejtoria Rajonale Tatimore	Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin	239	314
Drejtori e Përgjith e Shërbim të Transport Rrugor, Drejtoria Rajonale Gjirokaster	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	23,116	27,463
SH.R.U.K.GJ	Taksa & Tarifa Vendore Familjare	61,285	71,456
Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokaster	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	477	946
	Totali	85,117	100,179

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokaster (SH.R.U.K.GJ) me të cilët Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave ka mbajtur aktrakordimet mujore për arkëtimet nga mbledhja e taksave dhe tarifave të abonentëve familjarë si qytet dhe fshat. Ndërsa me agjentët si Drejtoria Rajonale të Tatimeve, Drejtori e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria Rajonale dhe Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore nuk mbahen rakordime për arkëtimet e të ardhurave.

▪ Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve për vitin 2024 ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Gjirokastër dhe në Njësitë Administrative 17 subjekte, të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, të cilat paraqiten në Aneks.

Konkluzion: Referuar dosjeve të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë gjirokastër për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij konstatohet se, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 4 subjekte të pajisura me autorizim me afat me 5 vjet për lejim ushtrim aktiviteti, për të cilat kanë kryer pagesa pjesore 3 subjekte dhe 1 subjekt nuk ka shlyer tarifën në vlerë të plotë, duke rezultuar me **detyrime të pashlyera në vlerë totale 2,700,000 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, nenet 4,15 dhe 20/2” dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3, pika 15.1.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. H. P. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave publike, Lejeve dhe Licencave, z. B. L. me detyrë përgjegjës i sektorit të kontabilizimit dhe shërbimit ndaj taksapaguesve (për periudhën 01.01.2024-13.04.2024), z. K. K. me detyrë përgjegjës i sektorit të kontabilizimit dhe shërbimit ndaj taksapaguesve (për periudhën 21.04.2024 e 31.12.2024), zj. F. T. me detyrë përgjegjëse në sektorin për kontrollin në terren dhe ndjekjen e debitorëve në qytet (për periudhën 13.09.2023-31.10.2024).

▪ Mbi menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Gjirokastër në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT janë dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ASHK, Drejtoria Gjirokastër. Referuar listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimit të tyre me pagesat e kryera nga personat që kanë patur detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se:

- **Në fund të vitit 2023** për TNI nga legalizimet kanë mbetur detyrime pa paguar në vlerën 1,903,345 lekë për 85 debitorë.

- **Gjatë vitit 2024** janë legalizuar gjithsej 40 objekte me vlerë totale të detyrimit për t'u paguar 1,264,395.86 lekë. Kanë paguar detyrimet 21 persona në vlerën 382,578.53 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2024 gjithsej 103 persona me vlerë progresive 2,785,163.15 lekë. Në mënyrë të detajuar debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë paraqiten në Aneks.

Në fund të vitit 2024 vlera e detyrimeve nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi **2,785,163.15 lekë**, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gjirokastrër. Drejtoria e Urbanistikës nuk ka marrë të gjithë masat e nevojshme për arkëtimin e (TNI) nga legalizimet, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, i ndryshuar me Ligjin nr. 95/2018, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c", me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" pika 5, me VKB nr.104, datë 04.12.2023 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Gjirokastrës, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin ushtrimor"

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: zj. B. D.me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Urbanistikës.

3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2024 të shoqëruar me formatet 1-9.

2.Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.

3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2024, libri i aktiveve.

4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2024.

6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit në mbyllje të vitit buxhetor 2024.

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet "excel"si: për vendimet gjyqësore, për investimet,per ditaret,shpenzimet te ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

• *Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:*

Për vitin 2024 nga njësia shpenzuese "Aparati i Bashkisë Gjirokastrër" për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Gjirokastrër si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

• *Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.*

Bashkia Gjirokastrër për vitin 2024 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë shpenzuese Bashkia Gjirokastrër pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

• *Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare*

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Gjirokastrër për vitin ushtrimor 2024 me shkresë përcjellëse nr. 2775 prot.datë 25.03.2025

konfirmuar nga dega e thesarit Gjirokastër. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Gjirokastër dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

• ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel” dhe alpha-ëeb.
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, permban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar

veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2024 deri më datën 31.12.2024.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike; **Totali i Aktivit** për vitin 2023 është në vlerën **3,385,842,347 lekë** dhe për vitin 2024 është **3,553,943,288 lekë**, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari paraqitet në aneksin nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën **271,123,837 lekë** dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën **373,222,662 lekë**, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte”.

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 271,123,837 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 357,836,162 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, dhe me rubrikën analoge “Tepricën e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr.3 “Pasqyrë e flukseve monetare viti 2024” në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Në mënyrë të detajuar “Tepricën e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr.3 “Pasqyrë e flukseve monetare viti 2024” paraqitet në aneksin nr. 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 110,456,412 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 135,139,447 lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej 24,683,035 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 37,019,871 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 në vlerën 61,389,252 lekë, me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 24,369,381 lekë, e cila përfaqëson pakësim të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2024 e analizuar

Nr.	Subjekti	Gjendje me 01.01.2024		Levizjet 2024		Gjendja Kontabel 31.12.2024
		DEBI	KREDI	DEBI	KREDI	
1	Materiale	37,019,871		122,536,230	98,166,849	61,389,252
	Totali	37,019,871				

Burimi: Drejtoria e financës

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 73,436,541 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 në vlerën 73,750,195 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 313,654 lekë, e cila përfaqëson rritje të inventarit të imët për vitin 2024, e analizuar sipas hyrjeve të magazinës;

Nr.	Subjekti	Gjendje me 01.01.2024		Levizjet 2024		Gjendja Kontabel 31.12.2024
		DEBI	KREDI	DEBI	KREDI	
1	Inventari i imet	73,436,541		313,654		73,750,195
	Totali					

Burimi: Drejtoria e financës

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 90,017,766 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2024 në vlerën 103,927,201 lekë, ku kemi rritje duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i detyrimeve për pagat e rritura të muajit dhjetor, sigurime dhe tatimin mbi pagën po për muajin dhjetor, kontabilizimi i gjobave të vendosura për ndërtim paleje nga IMT.

- **Gjendje e llogarisë 423,429 “Personeli, paradhenie, deficite, gjoba”** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 0 lekë, gjendje e cila përfaqëson detyrimet e punonjësve të lindura ndër vite, të trashëguara nga ish-komunat nëpërmjet pasqyrave financiare të pashoqëruara me dokumentacion justifikues dhe për të cilat Bashkia ka paraqitur dosjen pranë Këshillit Bashkiak për shqyrtim.

- **Gjendje e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme”** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 135,000 lekë, gjendje e cila përfaqëson pullat e taksës së gjendjes civile.

- **Gjendje e llogarisë 465 “Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë”** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 207,000 lekë, gjendje e cila përfaqëson pullat e taksës së gjendjes civile në arkë.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 45,884,227 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 50,998,526 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 ka pësuar një rritje prej 5,114,299 lekë, në të cilën ka ndikuar kontabilizimi i debitorëve nga gjobat e IMT-së në vlerën 5,114,299 lekë. vlerësimi i debitorëve debitorëve të taksave. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve të tatim taksave, për të cilat nuk është bërë përditësimi dhe rakordimi midis Drejtorisë së Financave dhe Drejtorisë së Tatim Taksave pranë bashkisë, dhe nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërimit, në kundërshtim me Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93.

-**Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta”** (debitorë) më 31.12.2024 paraqitet në vlerën 52,586,675 lekë. Nga analiza e llogarisë **4342** “Operacione me shtetin, të drejta” për vitin 2024, në mënyrë të përmbledhur është e analizuar si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2024 e llog 4342
1	Paga Personeli llogaria 42	33,977,278
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	2,344,476
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	10,162,221
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	1,405,238

5	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere 464	342,000
6	Kreditore të ndryshëm llogaria. 467	4,355,462
	Shuma	52,586,675

Nga analiza e llogarisë 4342 nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta”** dhe vlerës të pasqyruara në **6 (tetë) llogarive pasive**, pra në vitin 2024 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
 - U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 5 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose tekN.t më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në **aktiv të bilancit** paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I “Investime”). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,437,386,574 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 2,457,549,974 lekë.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2023 në shumën prej 20,520,894 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 17,553,595 lekë, ku diferenca në rritje prej 130,394 i përket “Oponenca teknike “Sistemim asfaltim

rruga Taroninë Zhulat Loti2” duke i zbritur amortizimin e akumuluar.Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar sipas aneksit nr. 5 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2024 në shumën totale prej **2,439,996,379** lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **3,709,193,328** lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 32,668,475 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën totale prej 33,306,703 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën totale 32,668,475 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 33,306,703lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuara sipas vlerës kontabël si vijon:

Nr	Përshkrimi	Viti	Njësia e matjes	Çmimi	Gjendja Kontabël	
					Sasia	Vlera
1.	Pasuria 20129; ZK 8541 v-2016	2016	m2	4,865	178	865,970
2.	Pasuria 2/100 ZK 8541 v-2016	2016	m2	4,865	40	194,600
3.	Pasuria 35/164 ZK 8541 v-2016	2016	m2	4,865	462	2,247,630
4.	Pasuria 35/161 ZK 8541 v-2016	2016	m2	4,865	293	1,425,445
5.	Pasuria 5/52 Cfakë-2015	2015	lek	2,077,355	1	2,077,355
6.	Pasuria 17/80 Gërhot T-2015	2015	lek	1,654,100	1	1,654,100
7.	Pasuria 5/2 Cakë-2015	2015		929,215	1	929,215
8.	Truall sipërfaqe Viti 2019	2019	m2	4,865	894	4,349,310
9.	Sip.truall.Nr.pas 25/59 zgjer i varrez	2023	m2	4,865	3,890	18,924,850
10.	Sip,truall,Nr/pas 195/4.Z.K8541	2024	m2	7,597.955	84	638,228
	SHUMA					33,306,703

Burimi: Drejtoria e financës

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” për vlerën kontabël historike **0 lekë**. Kjo llogari, periudhës objekt auditimi vitin 2024, nuk ka pasur shtesa ose pakësime.

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 825,846,004 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 870,569,042.4 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,153,529,757 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,244,072,219 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 90,542,462 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti në vitin 2024 paraqiten në menyre kontabël si vijon:

Në menyre të përmbledhur inventari kontabel i llogarise 212 "Ndertesa " me 31.12.2024

Objekti	212			
	Gjendje 31.12.2023	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendje 31.12.2024
	1,153,529,757			
Riparim i rifiniturave të brendshme dhe hidroizolim i tarracës Cicërima		1,555,888		
Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara		13,716,295		
Rikonstruksioni i teatrit “Zihni Sako”		1,822,366		
Rikonstruksioni i Pallatit të Sportit		71,301,233		
Shtepiza druri		959,880		

Bustet e heroinave		1,186,800		
Totali	1,153,529,757	90,542,462	0	1,244,072,218

Burimi: Drejtoria e financës

Shtesa me pagese janë në vlerën 90,542,462 leke dhe lëvizjet brenda sistemit janë në shumën 0 lekë nga këto të fundit janë të evidentuara shtesat nga shpërndarja studim projektive të viteve të kaluara.

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,435,947,903lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,413,593,629.3lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlerën historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,033,185,491lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 2,085,230,882lekë. Gjatë vitit 2024 janë bërë shtesat në vlerën 52,045,391leke, ku janë kryer investime në rrugë, rrjete elektrike, sinjalistikë etj. Amortizimi për vitin 2024 është llogaritur 74,399,665leke. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2023 në vitin 2024 paraqiten si vijon:

Inventari kontabel i llogarise 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” me 31.12.2024

Llogaria ekonomike	213			
	Gjendje 31.12.2023	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendje 31.12.2024
	2,033,185,491			
Mbikqyrje e objektit: Riveshje asfaltike në rrugën "Ibrahim Sino"		79,391		
Mbikqyrje e objektit: Rikonstruksion rruge dhe muri mbajtës në kodrën e Shtufit		27,849		
Masa inxhinerike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfakës , pranë rr. Nacionale Gjirokastër-Kakavijë , loti 2		35,778,952		
Modernizimi i ndriçimit rrugor publik në Njësitë Administrative		15,479,999		
Sinjalistika		679,200		
Totali	2,033,185,491	52,045,391	0	2,085,230,882

Burimi: Drejtoria e financës

- Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 18,732,056 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 19,815,478.5 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 91,013,315 lekë e cila është e analizuar sipas vlerës kontabël dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 98,701,897 lekë. Gjatë vitit 2024 janë bërë shtesat me pagesë në vlerën 7,688,582 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerën neto paraqite në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 47,452,293 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 51,851,278.4 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 96,485,913lekë, vlera e amortizimit të akumuluar është 44,634,635 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2023 deri në fund të vitit 2024 paraqitet në aneksin nr. 6 pika 3 bashkëlidhur raporti i auditimit.

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 56,218,949lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 50,860,247 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën kontabël 151,395,714 lekë. Ndërsa vlera e amortizimit e përlllogaritur është në shumën 100,535,467lekë.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2024 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

- Në lekë

JESIA PUBLIK		Bashkia Gjirokastr 2115001	Pasqyre Aneksa Statistike									
		GJENDJA DHE NDRYSHIMET E AKTIVEVE AFATGJATA(VLERA NETO)	Formati nr.7/B									
			VITI 2024									
			NE / LEKE									
Nr. f/jesh	Nr. Reference Llogarije	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	L.AAGJ/O MATERIALE	40,518,286	19,997,392	20,520,894	130,394	3,097,693	0	0	40,648,680	23,095,085	17,553,595
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	0
3	202	Studime dhe kerkerime	40,518,286	19,997,392	20,520,894	130,394	3,097,693			40,648,680	23,095,085	17,553,595
4	203	Koncesione, patentat, licenca e tjera ngjashme			0					0	0	0
5	21-28	IL.AAGJ/ MATERIALE	4,020,652,063	1,126,928,625	2,893,723,438	165,399,023	142,268,324	0	0	3,709,193,328	1,269,196,949	2,439,996,379
6	210	Toka,troje, Terene	32,668,475	0	32,668,475	638,228				33,306,703	0	33,306,703.0
7	211	Pyje,Kullota Plantacione	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.0
8	212	Ndertime e Konstruksione	1,153,529,757	327,683,753	825,846,004	90,542,462	45,819,423			1,244,072,219	373,503,176	870,569,042.4
9	213	Rruqe,troje,vepra ujqore	2,033,185,491	597,237,588	1,435,947,903	52,045,391	74,399,665			2,085,230,882	671,637,253	1,413,593,629.3
10	214	Instalime teknike,makineri,pajisje,vegla pune	91,013,315	72,281,259	18,732,056	7,688,582	6,605,160			98,701,897	78,886,419	19,815,478.5
11	215	Mjete transporti	89,357,913	41,905,620	47,452,293	7,128,000	2,729,015			96,485,913	44,634,635	51,851,278.4
12	216	Rezerva shtetore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.0
13	217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.0
14	218	Inventar ekonomik	144,039,354	87,820,405	56,218,949	7,356,360	12,715,062			151,395,714	100,535,467	50,860,247.2
15	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.0
16	28	Caktime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.0
17	231	Aktive te Qend.te trupezuara ne proces	476,857,758		476,857,758							0.0
18		TOTAL I (I + II)	4,061,170,349	1,146,926,017	2,914,244,332	165,529,417	145,366,017	0	0	3,749,842,008	1,292,292,034	2,457,549,974

Testi substancial i amortizimit

Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”pika 36 Përllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje te periudhes ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Për aktivet e llogarive: 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 218 “Inventar Ekonomik”, në të cilat përfshihen paisjet kompjuterike llogaritja e amortizimit është bërë në grup dhe jo aktiv për aktiv dhe nuk mund të verifikoheshin se si janë grupuar dhe llogaritur amortizimi për paisjet kompjuterike.

Vlerat e akumuluar të amortizimit sipas llogarive dhe veprimeve në kontabilitet paraqiten në tabelën e mësipërme:

Gjendja e ***llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”*** paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në vlerën 476,857,758 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 484,104,004 lekë kjo llogari është e analizuar sipas aneksit nr. 7 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe 6 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 0 lekë dhe më 31.12.2024 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 126,817,137 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 146,884,959 lekë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- ***Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”*** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 0 lekë.

- ***Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”*** paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën 33,977,278 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2025.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën kontabël 2,344,476 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2024 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2025.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën 10,162,221 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2024 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2025.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2024 është në vlerën kontabël 1,405,238 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2024 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2025.

- **Gjendja e llogarisë 464 “Detyrime për tu paguar për blerje e letrave me vlerë”** në fund të vitit 2024 është në vlerën kontabël 342,000 lekë, sipas detyrimit të muajit dhjetor 2024 të taksës së pullës që t’i paguhet DRTGJ në janar të vitit 2025.

-**Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 46,172,227 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 51,340,526 lekë, e cila rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit, ku në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 50,998,526 lekë me një diferencë në vlerë 342,000 lekë i përket llogarisë 464 në në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 36,799,371 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 42,957,758 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Gjirokastër në mënyrë analitike paraqitet në aneksin nr. 8 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në pasqyrat financiare të vitit 2024 vlera e llogarisë 466 është në vlerën 42,905,230 lekë ndërsa në analizë është vlera 42,957,758lekë , diferenca prej 52,528 i përket taksës së pullës.

- **Gjendja e llogarisë 467“Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,053,135lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 4,355,462lekë. Për këtë gjendje të llog 467 është sipas rakordimit me degën e Thesarit Gjirokastër në mënyrë analitike, e cila paraqitet si vijon;

Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”

Nr	Emri i kreditorit	Dokumenti/Data e krijimit	Vlera e kredise ne 31 dhjetor 2023	Shtesat gjate periudhes	Shlyerjet gjatë periudhes	Vlera e kredise mbyllëse 31 dhjetor 2024	Numri i llogarise ku eshte klasifikuar Debitori
			1	2	3	4=1+2-3	5
1	Paradheniet e kopshteve dhe cerdheve	sipas lëvizjeve të rregjistruara në kontabilitet (korispodenca me DA)	1,870,900	610,000	479,900	2,001,000	467
2	A. M.	Sipas vendimeve të rregjistruara në kontabilitet	435,352			435,352	467
3	F. A.	Sipas vendimeve të rregjistruara në kontabilitet	527,610			527,610	467
4	Mobilimi i Kinemase multifunkionale try Gjirokastra	Sipas faturës të rregjistruar në kontabilitet	0	1,391,500	-	1,391,500	467
5	Mbikqyrje punimesh Ujesjellsi Lazarat	Sipas faturës të rregjistruar në kontabilitet	219,273		219,273	-	467
6	Permisimi i kushteve te banimit per komunitete e varfera	Sipas faturës të rregjistruar në kontabilitet	0	5,027,467	5,027,467	0	467
7	Kolaudim Ujesjellsi Lazarat	Sipas faturës të rregjistruar në kontabilitet	0	427,074	427,074	-	467
	Totali		3,053,135	7,456,041	6,153,714	4,355,462	

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të paqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2024 paraqitet në aneksin nr.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën 1,413,734,993lekë, Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën 1,074,113,550lekë, diferenca prej 339,621,443 lekë duke përjashtuar ndryshimin e gjendjes së inventarit dhe taksën e pullës, vlera rakordon me akt-rakordimit me Degën e Thesarin Gjirokastrë.

B- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Gjirokastrë).

Tabela e punonjësve për Bashkinë Gjirokastrë

Nr	Emërtimi	Viti 2023				Viti 2024			
		Plan 2023		Fakt 01.01.2023		01.01-		01.01-	
		31.12.2023	31.12.2023	31.12.2023	31.12.2023	31.12.2024	31.12.2024	31.12.2024	31.12.2024
		P	F	P	F	P	F	P	F
1	AA115 Aparati dhe menaxhimi i Bashkisë	106	106	97.295.042	87.573.486	116	106	111,201,329	94,537,350
2	Drejtoria e Shërbimeve Sociale AB115	15	14	11,816,720	11,227,409	22	21	13,263,978	12,343,278
3	Drejtoria e Artit dhe kultures trashëgimise AC115	52	52	41,248,932	36,016,757	54	54	42,836,873	34,828,513
4	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi , shërbimi I kontrollit te territorit	51	51	50,927,218	48,435,465	52	52	55,102,654	52,305,374
5	Drejtoria e Shërbimeve Komunitare, Utilitare AE115	188	183	124,554,084	114,583,892	189	184	132,014,505	118,395,896
6	Drejtoria e Arsimit AF115	182	182	151,841,189	141,789,222	181	181	165,814,969	151,993,764
7	Drejtoria e zhvillimit te buqesise AG115	20	20	18,209,000	15,938,940	21	21	18,748,000	16,920,873
8	Gjendja Civie	6	6	6,243,000	6,207,824	6	6	7,844,000	7,305,296
9	QKB	1	0	55,640	55,640	0	0	0	0

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Për vitin 2024 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 107, datë 14.12.2023 "Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2024", me VKB nr.113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024” miratuar në total numri 641 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 625 punonjës, nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 425, datë 26.06.2024, nr. 419, datë 26.06.2024, nr.503, datë 01.08.2024, nr. 421, datë 26.06.2024, struktura e Bashkisë Gjirokastrë është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara. Urdhër i Kryetarit nr. 835, datë 30.10.2024 ”Për miratimin e strukturës analitike të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2024”, Urdhër i Kryetarit Nr.874, datë 11.11.2024 “ Për një ndryshim në urdhërin 730, datë 27.09.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bshkisë Gjirokastrë”

Sipas listë pagesave të muajve Janar-Dhjetor 2024 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës A. K. nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës A. K. dhe nga Kryetari Bashkisë; F. G..

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Drejtori i Burimeve Njerëzore Nie Shalari dhe nga Kryetari Bashkisë F. G..

B. 2 - Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2024

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Qershor-Gusht 2024, Nëntor-Dhjetor 2024, dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga, Drejtorja e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës", i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Gjirokastrë, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH".

-Referuar kërkesave të VKM nr. 425, datë 26.06.2024, nr. 419, datë 26.06.2024, nr.503, datë 01.08.2024, nr. 421, datë 26.06.2024, struktura e Bashkisë Gjirokastrë, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve Qershor-Gusht 2024, Nëntor-Dhjetor 2024, konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës A. K. nga Specialistet e pagave.

Paraqitja në formë tabelle e burimit të Financimit.000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. Kushtëzuar	Transferte specifike
Viti 2024	471,496	419,033	89%	178,577	82,754	7,305	219,995

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë 000/lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2024		
		Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	449,044	419,033	93%
2	F. Sig. Shoq	75,330	69,597	92%
3	F. Veçantë	22,452	2,489	11%

Veprimet nëpërmjet magazinës

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhet në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhet sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara.

- Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë

kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.

Bashkia Gjirokastër për vitin 2024 nuk ka hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë pasi në periudhën e auditimit Konstatohet se Bashkia Gjirokastër është njësi shpenzuese e vetme.

4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

-Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njëzia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me VKB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, Bashkia Gjirokastër referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **76** procedura prokurimi me fond limit **324,356,553 lekë pa TVSh**, me vlerë kontrate **255,737,832 lekë pa TVSh**, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **68,618,721 lekë pa TVSh**, ose **21 %**. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2023 – 31.12.2023	Nr.	VI. Fond Limit pa TVSh	VI. Kontrate pa TVSh dhe me TVSh	
GJITHESEJ	46	311,196,413	245,177,332	294,212,798
-Të hapura	13	233,917,940	179,189,520	215,027,424
-Shërbim konsulence	0			
-Negocim pa shpallje	0			
-E hapur e thjeshtuar	23	77,278,473	65,987,811	79,185,374
Sipas objekteve				
-Objekte në fushën e punëve publike		209,564,628	153,300,492	183,960,590
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje		101,631,785	91,876,840	110,252,208

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **146** OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar **50** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej 7 procedura ose 19.4 % e procedurave të zhvilluara në total për periudhën objekt auditimi.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjedhi për auditim:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatuan mangësi në procedurat si më poshtë vijon:

Prokurimet me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2023-31.12.2023

1. Tenderi me objekt: *“Rikonstrukcion i pallatit të sportit Gjirokastër”*, me vlerë kontrate 59,308,815 pa TVSh;

2. Tenderi me objekt: “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, me vlerë kontrate 11,012,845 lekë pa TVSh.
3. Tenderi me objekt: “Konstruktion i tregut lokal Rom Gjirokastër, Roma on Market”, me vlerë kontrate 15,396,409 lekë pa TVSh.
4. Tenderi me objekt: “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfaqës pranë rrugës nacionale Gjirokastër Kakavie Loti 2”, me vlerë kontrate 28,784,588 lekë pa TVSh.
5. Tenderi me objekt: “Rehabilitim i segmenteve të ndryshme rrugore”. me vlerë kontrate 36,309,280 pa t.v.sh;
6. Tenderi me objekt: “Modernizimi i ndriçimit rrugor publik në njësitë administrative faza e parë”, me vlerë kontrate 15,288,000 pa t.v.sh;
7. Tenderi me objekt: “Karburant” Loti I Naftë benzenë dhe Loti II Lëndë djegëse për Kaldajën” me vlerë kontrate 30,808,468 pa t.v.sh;
8. Tenderi me objekt: Rikonstruktion dhe përmirësimi i efikasitetit energjetic në shpalljen “Muhamet Gjollësia” me vlerë kontrate 14,479,818 pa t.v.sh;

1. Tenderi me objekt: “Rikonstruktion i pallatit të sportit Gjirokastër”, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruktion i pallatit të sportit Gjirokastër”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF- 58495-02-08-2023 Urdhri nr. 44 prot., datë 19.01.2023	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Shkresa nr. 13758 prot., datë 14.12.2022 nga Studio 4KPPF	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 44, datë 19.01.2023 1. A. L.-Juriste 2. L. S.-Ekonomiste 3. A. P.-Ing. Ndërtimi	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 86 prot., datë 08.02.2023 1. A. I.- Kryetar 2. K. N.-Anëtar 3. A. R.-Anëtar
5. Fondi Limit pa TVSh 84,200,874 lekë	6. Oferta fituese, vlera fituese pa TVSh: Operatori Fitues: BOE “L.” & “E.” Shpk me vlerë 59,308,815 lekë.	7. Diferenca me fondin limit: 24,892,058 lekë pa TVSh	
8. Data e hapjes së tenderit: Data 01.03.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit.	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 14 OE b) S’kualifikuar 6 B/OE c) Kualifikuar 8 B/OE	
11. Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka	
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Nr. 4235 prot., datë 03.05.2023	15. Vlera e kontratës me TVSh 71,170,578 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës: 30,635,059 lekë	
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë: 4 Muajt	19. Zgjatja e kontratës me - ditë	

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Preventivi

Burimi i financimit:

Fonde të vena në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Projekti teknik i zbatimit, preventivi dhe i gjithë dokumentacioni teknik i projektit, është hartuar nga Studio 4 KPPF ShPK me Ing. N. G. me licencën N...../4, dhe i është bërë dhuratë Bashkisë Gjirokastër, nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. 10250 prot., datë 23.09.2022, të lidhur ndërmjet palëve. Në vijim nga titullari i Bashkisë Gjirokastër është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara dhe dokumentacionit shoqëruar. Komisioni i përbërë nga z. A. P., z. F. M. dhe z. N. S. ka mbajtur procesverbalin nr. 13714 prot., datë 14.12.2022 për verifikimin e dokumentacionit të mësipërm.

Me shkresën nr. 192 prot., datë 10.01.2023, është dërguar z. N. N., (Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë, person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë) dokumentacioni tekniko - ekonomik për

fillimin e procedurës së prokurimit, për objektin “Rikonstrukcion i pallatit të sportit Gjirokastrë” Bashkia Gjirokastrë, ku përfshihet PV për hartimin e dokumentacionit teknik, preventivi, grafiku i punimeve, analizat e çmimeve, etj.

Fondi limit është përlogaritur në vlerën 84,200,874 lekë pa TVSh. Kodet për zërat e punëve janë marrë referuar VKM-së nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Nga grupi i auditimit u testuan disa prej zërave të preventivit me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së çmimeve për njësi në preventiv me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, si dhe përputhshmërinë e tyre me projektin e zbatimit. Nga verifikimi u konstatua se çmimet për njësi përputhen me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit.

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 08.02.2023, nga NJP i ndryshuar.

Pika 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e VKM-së nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P - 1 A** Punime gërmimi në tokë;
- **N.P – 3 A** Ndërtime civile dhe industriale
- **N.P-11 A** Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S – 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve;
- **N.S - 2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S - 4 B** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- **N.S – 8 A** Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri
- **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

-AK kërkon disa lloje licencash që duhet të disponojë OE që do të kryejë punimet e ndërtimit, ku një ndër këto është licenca e llojit NP-11 A “Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë”, e cila përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore dhe NS-8 A “Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri” e cila përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur.

- Sipas preventivit të punimeve nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë këto kategori licence, pra nuk është argumentuar kërkesa për këto lloj licence.

Pika 2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Ing. Ndërtimi 1 (një)
- Ing. Hidroteknik 1 (një)
- Ing. Elektrik 1 (një)
- Ing. Elektronik 1 (një)

Secili prej pjesëtarëve të drejtuesve teknik të mësipërm duhet të jetë në listëpagesat e muajit Tetor 2022- Dhjetor 2022 si dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë.

Për secilin prej tyre duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diploma

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

-Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjësit e mësipërm. Pra pse duhet të jenë 3 muaj në listëpagesë dhe si ndikon kjo në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale. Gjykojmë se kërkesat për kapacitetet teknike dhe profesionale, lidhur me disponimin e inxhinierëve, ezarohen duke kërkuar disponimin e tyre gjatë pjesëmarrjes në procedurë, përfshirjen e tyre si drejtues teknik. Gjithashtu sqarojmë se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 5 vite/3 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3/5 vite)⁵. Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 1 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuar me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 3 muajsh që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë, duke ndikuar negativisht në konkurrencën në treg. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

Pika 2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Tetor 2022- Dhjetor 2022

- Teknik ndërtimi 1
- Elektricitist 6
- Hidraulik 4
- Suvaxhi 11
- Pllakashtrues 3
- Bojaxhi 6
- Hidroizolues 2
- Hekurkthyes 2
- Karpentier 2

Punonjësit e mësipërm të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose ekuivalente me to të akredituara nga legjislacioni në fuqi si dhe të paraqitet kontratë pune e vlefshme.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur (3 muaj) që punonjësit duhet të figurojnë në listë-pagesat e OE.

-Veç sa më sipër është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, përjashtuar ata me formimin profesional Elektricitist (Hidraulik, Hidroizolues, Teknik ndërtimi, suvaxhi, hekurkthyes, pllakashtrues, bojaxhi etj) të kërkohet dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi kërkesa e

⁵ Shkronja “a” pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për punonjësit e tjerë të cilët nuk do të kryejnë punime elektrike.

Pika 2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 65 persona** të cilët duhet të jenë pjesë e listëpagesave të muajit Tetor 2022 - Dhjetor 2022.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehësuar me origjinalin.

Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 45 punonjës (4 inxhinier dhe 41 staf teknik), pra ngelen edhe 20 punonjës për të cilët nuk argumentohet numri si dhe nuk përcaktohet profesioni, ç'ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin”.

Pika 2.3.9. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) Punonjës i pajisur me Certifikatë trajnimi për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” i dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj
- -1 (një) punonjës të paisur me certifikatë “Për punime në lartësi”. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune dhe certifikatën përkatëse ose dëshmi nga institucione të akredituara.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehësuar me origjinalin

-Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM-në nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

Pika 2.3.11. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjete/pajisje teknike:	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12-18 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5-7 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
3	Elektrosaldatrici	2 copë	Në pronësi ose me qira
4	Moto gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qira
5	Depozitë uji (kapaciteti minimal 2000 litra)	2 copë	Në pronësi ose me qira
6	Betonier kantieri	2 copë	Në pronësi ose me qira
7	Eskavator me goma 0.5 m3	1 copë	Në pronësi ose me qira
	Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve:		
1	Kokore	60 copë	Në pronësi ose me qira
2	Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi	5 copë	Në pronësi ose me qira
3	Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila	3 copë	Në pronësi ose me qira
4	Komplet i ndihmës së shpejtë	2 copë	Në pronësi ose me qira

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme),

taksën vjetore dhe për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehësuar me origjinalin.

-Referuar procesverbalit të argumentimit të kërkesës për mjetet e mësipërme, konstatohet se kjo kërkesë nuk është shoqëruar me analizë teknike, duke bërë përlogaritjet referuar peshës së materialeve, rrugë në ditë, afatin konkret për transportin e secilit material, pra kur duhet të jenë në kantier materialet, për të arritur në përfundimin se duhet një mjet i një llojit të caktuar, me kapacitet mbajtës specifik.

-Në këtë kriter nuk është kërkuar certifikata për transport mallrash për llogari të vetë apo për të tretë në rast marrje mjeti me qira e cila është detyrim ligjor në zbatim të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse” dhe Kapitulli III.2, “Transporti i mallrave për vetë”, neni 45, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë”.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. A. L., znj. L. S. dhe z. A. P..

Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhër nr. 1298 prot., me nr. 86 datë 08.02.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Gjirokastrë, (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 3980 prot., datë 19.04.2021), është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. A. I. (Kryetar), znj. A. R. dhe z. K. N., (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s’ka, datë 05.04.2023 për hapjen e tenderit dhe për vlerësimin e ofertave. Nëpërmjet kërkesës në SPE, nr. 3400 prot., datë 05.04.2023, KVO i është drejtuar BOE “L.” ShPK dhe “E.” ShPK për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 3649 prot., datë 13.04.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 14 OE/BOE, përkatësisht:

1. BOE “L. (E.) & E.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 59,308,815 lekë pa TVSh.
2. OE “N” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 63,268,659 lekë pa TVSh.
3. BOE “A. & A.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 82,442,060 lekë pa TVSh.
4. OE “B. & R.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 72,061,433 lekë pa TVSh.
5. BOE “N. & G. & B.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 68,900,050 lekë pa TVSh.
6. OE “P.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 71,926,903 lekë pa TVSh.
7. BOE “R. & L.” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 67,064,485 lekë pa TVSh.
8. BOE “Z. & K.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 66,730,849 lekë pa TVSh.
9. BOE “A. & U.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 69,083,612 lekë pa TVSh.

10. BOE "E. & C." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 70,812,400 lekë pa TVSh.
 11. BOE "C. & D." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 62,673,383 lekë pa TVSh.
 12. BOE "I. & X." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 60,246,764 lekë pa TVSh.
 13. OE "K." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 63,316,460 lekë pa TVSh.
 14. BOE "E. & D. & B." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 0 lekë pa TVSh.

-Nga BOE/ OE të mësipërm, janë s'kualifikuar 6 OE/BOE, si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar																														
1	BOE "L." (E.) & "E." ShPK	59,308,815 lekë	Kualifikuar																														
2	OE "N" ShPK	63,268,659 lekë	Kualifikuar																														
3	BOE "A." & "A." ShPK	82,442,060 lekë	Kualifikuar																														
4	BOE "B." & "R." ShPK	72,061,433 lekë	Kualifikuar																														
5	BOE "N." & "G." & B. ShPK	68,900,050 lekë	Kualifikuar																														
6	12.OE "P." ShPK	71,926,903 lekë	Kualifikuar																														
7	BOE "R." & "L." ShPK	67,064,485 lekë	Kualifikuar																														
8	BOE "Z." & "K." ShPK	66,730,849 lekë	Kualifikuar																														
9	BOE "A." & "U." ShPK	69,083,612 lekë	<p>S'kualifikuar: Nuk plotësoni kriterin e përcaktuar në DST: 2.13 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi impiantet si më poshtë vijon: a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte b. 1 (një) Impiant prodhimi Betoni Për impiantin e prodhimit të inerteve/ betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/ betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit, Pasi mungon kontrata e qirasë e vetëdeklaruar në shtojcën 8</p>																														
10	BOE "E." & "C." ShPK	70,812,400 lekë	<p>S'kualifikuar Marrëveshja e bashkëpunimit për këtë BOE është e firmosur vetëm nga njëri OE E. ShPK. OE E. ShPK nuk ka deklaruar OE pjesëmarrës për BOE në Vetëdeklarimin shtojca 8</p>																														
11	BOE "C." & "D." ShPK	62,673,383 lekë	<p>S'kualifikuar: Oferta ekonomike është e pa saktë, keni ndryshuar zërat dhe volumet e preventivit si më poshtë: Si është:</p> <table border="1"> <tr> <td>18</td> <td>Analizë</td> <td>F.V Grilë shiu Ø 100 mm</td> <td>copë</td> <td>16</td> </tr> <tr> <td>18</td> <td>Analizë</td> <td>F.V Grilë shiu Ø 150 mm</td> <td>copë</td> <td>1</td> </tr> </table> <p>Si duhet:</p> <table border="1"> <tr> <td>18</td> <td>Analizë</td> <td>F.V Grilë shiu Ø 100 mm</td> <td>copë</td> <td>1.00</td> </tr> <tr> <td>18</td> <td>Analizë</td> <td>F.V Grilë shiu Ø 150 mm</td> <td>copë</td> <td>2.00</td> </tr> </table> <p>Si është:</p> <table border="1"> <tr> <td>13</td> <td>Analizë</td> <td>F.V Tub flex pa termoizolim Ø15</td> <td>copë</td> <td>1.00</td> </tr> </table> <p>Si duhet:</p> <table border="1"> <tr> <td>13</td> <td>Analizë</td> <td>F.V Ventilator aksial</td> <td>copë</td> <td>1.00</td> </tr> </table>	18	Analizë	F.V Grilë shiu Ø 100 mm	copë	16	18	Analizë	F.V Grilë shiu Ø 150 mm	copë	1	18	Analizë	F.V Grilë shiu Ø 100 mm	copë	1.00	18	Analizë	F.V Grilë shiu Ø 150 mm	copë	2.00	13	Analizë	F.V Tub flex pa termoizolim Ø15	copë	1.00	13	Analizë	F.V Ventilator aksial	copë	1.00
18	Analizë	F.V Grilë shiu Ø 100 mm	copë	16																													
18	Analizë	F.V Grilë shiu Ø 150 mm	copë	1																													
18	Analizë	F.V Grilë shiu Ø 100 mm	copë	1.00																													
18	Analizë	F.V Grilë shiu Ø 150 mm	copë	2.00																													
13	Analizë	F.V Tub flex pa termoizolim Ø15	copë	1.00																													
13	Analizë	F.V Ventilator aksial	copë	1.00																													
12	BOE "I." & "X." ShPK	60,246,764 lekë	<p>S'kualifikuar: Nuk plotësoni kriterin e përcaktuar në DST: 2.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga ana e Administratorit të shoqërisë Drejtuesin teknik të punimeve në kantier ose Përgjegjës të teknik të kantierit i cili duhet të jetë resident dhe me kohë të plotë në kantier dhe jo i angazhuar në kontrata të tjera i cili duhet të jetë diplomuar në inxhinieri ndërtimi.</p>																														
13	OE "K." ShPK	63,316,460 lekë	<p>S'kualifikuar: Nuk plotësoni kriterin e përcaktuar në DST: 2.13 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi impiantet si më poshtë vijon: a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte b. 1 (një) Impiant prodhimi Betoni Për impiantin e prodhimit të inerteve/ betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/ betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit, Pasi mungon kontrata e furnizimit e vetëdeklaruar në shtojcën 8.</p>																														
14	BOE "N." & "D." & "B." ShPK	0 (zero)	<p>S'kualifikuar: Preventivi i ofruar nuk i plotëson kërkesat sipas kriterëve të dokumenteve të tenderit, pasi ka ndryshime thelbësore në përmbajtje.</p>																														

Nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës me nr. 4033 prot., datë 26.04.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues BOE “L.” ShPK dhe “E.” ShPK, me ofertën ekonomike me vlerë 59,308,815 lekë pa TVSh, me diferencë nga fondi limit në vlerën 24,892,058 lekë/29.5% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht⁶, nga BOE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nga BOE “L.” & “E.” ShPK nuk është plotësuar kërkesa e vendosur në pikën 2.3.5 të DST, konkretisht:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

-Ing. Ndërtimi 1 (një)

-Ing. Hidroteknik 1 (një)

-Ing. Elektrik 1 (një)

-Ing. Elektronik 1 (një)

Secili prej pjesëtarëve të drejtuesve teknik të mësipërm duhet të jetë në listëpagesat e muajit Tetor 2022- Dhjetor 2022 si dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë.

Për secilin prej tyre duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme

- Diploma

-OE “L.” ShPK nuk ka dorëzuar kontratë pune dhe diplomë për ing. elektronik ndërsa OE “E.” ShPK ka dorëzuar kontratën e punës për z. M. N., i cili nuk disponon diplomë për ing. Elektronik siç është kërkuar në DST por ka paraqitur diplomë për ing. T. N..

-Janë kërkuar 11 punonjës me profesion suvaxhi, por nga OE “E.” ShPK janë deklaruar dhe dorëzuar dokumentacion për 4 punonjës, ndërsa OE “L.” ShPK ka deklaruar 2 punonjës me profesion suvaxhi, 1 prej të cilëve z. M. I. është me profesion hekurkthyes dhe nuk ka paraqitur dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik.

Konkluzion.

OE “BOE “L.” dhe “E.” ShPK, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. A. L., Kryetar, z. K. N. dhe znj. A. R., Anëtar.

2. Tenderi me objekt: “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara Loti 2”, me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara Loti 2”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF- 81088-09-25-2023 Urdhri nr. 693 prot., datë 19.09.2023	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit: Drejtoria e Urbanistikës.	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 693, datë 19.09.23 1. A. L.-Juriste 2. L. S.-Ekonomiste 3. A. P.-Ing. Ndërtimi	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 696 prot., datë 25.09.2023 1. A. I. Kryetar 2. M. S.- Anëtar 3. K. N.- Anëtar

⁶ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E Hapur”		
5. Fondi Limit pa TVSh 15,147,007 lekë	6. Oferta fituese, vlera fituese pa TVSh: Operatori Fitues: “T.” ShPK me vlerë 11,012,845 lekë	7. Diferenca me fondin limit 4,134,162 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data 16.10.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit.	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 7 OE b) S’kualifikuar 3 B/OE, c) Kualifikuar 4 B/OE
11. Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 11820 prot., datë 12.12.2023	15. Vlera e kontratës me TVSh 13,215,414 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës: 0 lekë
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë: 12 muaj	19. Zgjatja e kontratës me - ditë

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Preventivi

Projekti teknik i zbatimit, preventivi dhe i gjithë dokumentacioni teknik i projektit i objektit është hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës me Ing. A. P., Ing. F. M., Ark. F. Ç., Ark. E. L. dhe Ark. E. X..

Fondi limit është përlogaritur në vlerën 15,147,007 lekë pa TVSh. Kodet për zërat e punëve janë marrë referuar VKM-së nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i ndryshuar, dhe në zbatim të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të ndërtimit” ëshërë miratuar preventivi nga sistemi i integruar “SIM” pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Fondi i veçantë i parashikuar në preventiv është parashikuar në preventiv, në zbatim të aneksit VI, të VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Për sa trajtuar më sipër preventivi është hartuar nga Ing. A. P., Ing. F. M., Ark. F. Ç., dhe Ark. E. X., konfirmuar nga z. F. G. Kryetar i Bashkisë Gjirokastër.

Sa më sipër, nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, rezulton se disa Inxhinier pjesë e grupit të punës për hartimin e projekt të zbatimit, **nuk janë pajisur me licencën e projektimit**. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, sipas të cilit “Objektet e përkufizuara në nenin 3 ë këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të **pajisur me licencën përkatëse**. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit”. Përsa më sipër, **ngarkohet me përgjegjësi Titullar i Autoriteti Kontraktor Bashkia Gjirokastër F. G.**

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, **nuk** rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një **oponencë teknike**, në lidhje me procedurën e sipërcituar, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik.

Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezulton të jetë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998”, sipas të cilit: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga

institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik”.

Në kuptim të ligjit nr. **107/2014** “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, referuar nenit **52**, germa “**gj**”, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponente teknike, përbën kundërvajtje administrative.

Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponente teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. **8402**, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, **ngarkohen me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. F. G.**

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka., datë 25.09.2023, nga NJP, i ndryshuar.

Pika 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Qershor 2023- Gusht 2023

- Elektricitist 3
- Hidraulik 3
- Suvaxhi 2
- Shofer 2 (në rast të marrjes së mjetit me qira shoferi mund të ketë një kontratë individuale pune përgjatë gjithë ekzekutimit të kontratës)
- Hidroizolues 2
- Pllakashtrues 2

Punonjësit e mësipërm të jenë të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose ekuivalente me to të akredituara nga legjislacioni në fuqi si dhe të paraqitet kontratë pune e vlefshme.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur (3 muaj) që punonjësit duhet të figurojnë në listë-pagesat e OE.

-Veç sa më sipër është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, përjashtuar ata me formimin profesional Elektricitist (Hidraulik, Hidroizolues, pllakashtrues, etj.) të kërkohej dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për punonjësit e tjerë të cilët nuk do të kryejnë punime elektrike.

-Në preventivin e punimeve ka punime për lyerje me bojë por në asnjë rast nuk është kërkuar edhe punonjës me profesion bojaxhi për të realizur kontratën, si dhe punonjës me profesion për punime duralumini.

Pika 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 18 persona** të cilët duhet të jenë pjesë e listëpagesave të muajit Qershor 2023-Gusht 2023,

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

-Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 15 punonjës (1 inxhinier dhe 14 staf teknik), pra ngelen edhe 3 punonjës për të cilët nuk përcaktohet profesioni, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohej “Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin”.

Pika 2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme

Nr	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës min 2-5 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksën vjetore dhe për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qira të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

-Në këtë kriter nuk është kërkuar certifikata për transport mallrash për llogari të vetë apo për të tretë në rast marrje mjeti me qira e cila është detyrim ligjor në zbatim të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse” dhe Kapitulli III.2, “Transporti i mallrave për vete”, neni 45, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë”.

Pika 2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht:

a) Certifikatë ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë/ **ekuivalente dhe e vlefshme**

b) Certifikatë ISO 14001:2015 Sistemet e menaxhimit të ambientit/**ekuivalente dhe e vlefshme**

c) Certifikatë ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)/ **ekuivalente dhe e vlefshme**

• Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

-Kërkesa për këtë certifikatë nuk argumentohet nga AK. Sqarojmë se **ISO 14001:2015** specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. Në rastin në fjalë projekti si fillim i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij. Gjithashtu menaxhimi mjedisor (përsëmbull mbrojtja e mjedisit nga zhurmat e mjeteve të cilat do të punojnë në segmentin rrugor) që duhet të sigurojë subjekti gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, është detyrim ligjor⁷ që duhet të respektohet nga subjekti nëpërmjet marrjes së masave paraprake, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet disponimit të certifikatës së sipërpërmendur. Pra që të përcaktosh kritere të tilla duhet një bazë ligjore, si dhe të jepen arsye/argumentim konkrete për përcaktimin/nevojën e tyre, që në këtë rast nuk është dhënë, si dhe duhet të jenë

⁷ Neni 4 në Ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar.

përputhje me zërat e punimeve që do të realizojë OE.⁸ Për më tepër referuar procesverbalit të mbajtur nga NJP, për vendosjen e kërkesës për certifikatat ISO, pasqyrohet argumenti se janë vendosur për cilësinë e mallit. Për këtë argument, sqarojmë se referuar përcaktimit të bërë në shkronjën “c” të pikës 1 dhe shkronjën “dh” në pikën 9 në Kreun III të Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, cilësia e mallit vërtetohet nëpërmjet dokumenteve (certifikatë analizat e mallit) që dorëzohen gjatë zbatimit të punimeve, ku plotësohet dosja e kantierit dhe kontrollohen nga përgjegjësi/drejtuuesi teknik i kantierit.

Konkluzion.

-Sa më sipër, konstatohet se kriteret e veçanta të kualifikimit nuk janë në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 4, shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 6 të nenit 39, pikën 2 në nenin 78 në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. A. L., znj. L. S. dhe z. A. P..

Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 696, me nr. 9082 prot., datë 25.09.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm z. N. N. (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë Gjyrokastër me nr. 219 datë 19.04.2021) është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. A. I. (Kryetar), znj. M. S. dhe z. K. N., (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s’ka, datë 16.11.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 11064 prot., datë 16.11.2023 për vlerësimin e ofertave. Nëpërmjet kërkesës në SPE, nr. 11088 prot., datë 17.11.2023, KVO i është drejtuar OE “T.” ShPK për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 11232 prot., datë 21.11.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 7 OE, përkatësisht:

- 1.OE “T.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,012,845 lekë pa TVSh.
- 2.OE “A.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,169,881 lekë pa TVSh.
- 3.OE “A.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 12,688,157 lekë pa TVSh.
- 4.OE “A.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 13,357,043 lekë pa TVSh.
- 5.OE “N.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 12,116,231 lekë pa TVSh.
- 6.OE “M. & R.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 12,884,195 lekë pa TVSh.
- 7.OE “I.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 14,166,545 lekë pa TVSh.

-Nga BOE/ OE të mësipërm, janë s’kualifikuar 3 OE/BOE, si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	OE “T.” ShPK	11,012,845 lekë	Kualifikuar
2	OE “A.” ShPK	11,169,881 lekë	Kualifikuar
3	OE “A.” ShPK	12,688,157 lekë	Kualifikuar
4	OE “A.” ShPK	13,357,043 lekë	Kualifikuar
5	OE “N.” ShPK	12,116,231 lekë	<p>S’kualifikuar: OE mbështetet në kapacitetet teknike të subjektit “G. sh.p.k” kjo në kundërshtim me pikën e DST-së 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera: Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.</p> <p style="text-align: center;">Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p> <p>Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:</p>
6	OE “M.” & “R.” ShPK	12,884,195 lekë	<p>S’kualifikuar: OE ka ndryshuar preventivin e punimeve duke hequr zërin 12 Dritare d/alumin dyfish xham ëc e re me nr. analize (2.375/a) njësia m2 /0.6</p>
7	OE “I.” ShPK	14,166,545 lekë	<p>S’kualifikuar: OE ka ndryshuar preventivin e punimeve në zërin 1 të kapitullit 02 duke ndryshuar përshkrimin dhe sasinë si me poshtë:</p>

⁸ Pika 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe njoftimin nr.3341/1 datë 20.03.2018 të APP për AK.

			Duhet 02.T. H. NR/ AN/EMËRTIMI I PUNIMEVE NJËSIA 1/an/ instalime elektrike komplet dalje fuqie/ copë/9 Ofertuar 02.T. H. 1/an/ f.v elektrike ëv e re dalje fuqie / copë/ 4/5.000/20.000
--	--	--	---

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më nr. 11423 prot., datë 30.11.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE "T." ShPK, me ofertën ekonomike me vlerë 11,012,845 lekë pa TVSh, me diferencë nga fondi limit në vlerën 4,134,162 lekë/27% më pak.

-S'kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht⁹, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nga OE "T." ShPK nuk është plotësuar kërkesa e vendosur në pikën 2.3.4 të DST, konkretisht: Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Qershor 2023- Gusht 2023

- Elektricitist 3
- Hidraulik 3
- Suvaxhi 2
- Shofer 2 (në rast të marrjes së mjetit me qira shoferi mund të ketë një kontratë individuale pune përgjatë gjithë ekzekutimit të kontratës)
- Hidroizolues 2
- Pllakashtrues 2

-OE "T." ShPK ka deklaruar në shtojcën 8 dhe dorëzuar 2 punonjës me profesion elektrikist ndërkohë në DST janë kërkuar 3 punonjës me profesion elektrikist.

- Janë kërkuar 2 punonjës me profesion suvaxhi dhe 2 punonjës me profesion pllakashtrues, ndërkohë OE T. ka deklaruar të njëjtin punonjës z. M. L. edhe si pllakashtrues edhe si suvaxhi.

-Nga OE shpallur fitues nuk është dorëzuar vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të maturuara për energjinë elektrike të maturuara për muajin tetor 2023, duke qënë se data e dorëzimit të ofertave është 21.11.2023.

Konkluzion.

OE OE "T." ShPK, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. A.L., Kryetar, znj. M. S. dhe z. K. N., Anëtar.

3. Tenderi me objekt: "Konstruksion i tregut lokal Rom Gjirokastër "Roma on Market"", me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Konstruksion i tregut lokal Rom Gjirokastër "Roma on Market"".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-77080-08-09-2023 Urdhri nr. 489, nr. 6907 prot., datë 20.07.2023	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit G.	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 489, datë 20.07.23 1. A. L.-Juriste 2. L. S.-Ekonomiste 3. A. P.-Ing. Ndërtimi	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 590, nr. 7632 prot., datë 09.08.2023. 1. A. l.- Kryetar 2. F. M.-Anëtar

⁹ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e Thjeshtuar”			3. M. S.- Anëtar
5. Fondi Limit pa TVSh 18,831,196 lekë	6. Oferta fituese, vlera fituese pa TVSh: Operatori Fitues: “F.” ShPK me vlerë 15,396,409 lekë	7. Diferenca me fondin limit 3,434,787 lekë pa TVSh	
8. Data e hapjes së tenderit: Data 30.08.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit.	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 10 OE b) S’kualifikuar 6 B/OE, c) Kualifikuar 4 B/OE	
11. Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka	
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Nr. 10752 prot., datë 10.11.2023	15. Vlera e kontratës me TVSH 18,475,691 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës: 0 lekë	
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë: 7 muaj	19. Zgjatja e kontratës me - ditë	

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Preventivi

Burimi i financimit:

Fonde të vena në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Relacioni teknik është hartuar nga “G.” Studio ShPK me Ing. V. Ç. me licencën N...../6.

Projekti teknik i zbatimit, preventivi, grafik punimesh, Projekti Arkitektonik dhe projekti konstruktiv, është hartuar nga MVM Architecture me Ing. L. K. me licencën N .../1, dhe i është bërë dhuratë Bashkisë Gjirokastër, nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. 5066 prot., datë 23.05.2022, të lidhur ndërmjet palëve. Në vijim nga titullari i Bashkisë Gjirokastër është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të dokumentacionit shoqërues. Komisioni i përbërë nga znj. J. M., z. A. P. dhe z. N. S. ka mbajtur procesverbalin nr. 7333 prot., datë 30.06.2022 për verifikimin e dokumentacionit të mësipërm.

Me shkresën nr. 6877 prot., datë 19.07.2023, është dërguar nga znj. J. M., (Zv/Kryetare e Bashkisë Gjirokastër, person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë) dokumentacioni tekniko - ekonomik për fillimin e procedurës së prokurimit, për objektin “Konstruktion i tregut lokal romë Gjirokastër “Roma on Market””, Bashkia Gjirokastër, ku përfshihet PV për hartimin e dokumentacionit teknik, preventivi, grafiku i punimeve, analizat e çmimeve, etj.

Fondi limit është përlllogaritur në vlerën 18,831,196 lekë pa TVSh. Kodet për zërat e punëve janë marrë referuar VKM-së nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Nga grupi i auditimit u testuan disa prej zërave të preventivit me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së çmimeve për njësi në preventiv me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, si dhe përputhshmërinë e tyre me projektin e zbatimit. Nga verifikimi u konstatua se çmimet për njësi përputhen me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit.

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 09.08.2023, nga NJP, i ndryshuar.

Pika 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Maj 2023 – Korrik 2023

- Elektracist 2
- Hidraulik 2
- Saldator 2
- Shofer 2 (në rast të marrjes së mjetit me qira shoferi mund të ketë një kontratë individuale pune përgjatë gjithë ekzekutimit të kontratës)
- Montator 2
- Betonist 2

Punonjësit e mësipërm të jenë të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose ekuivalente me to të akredituara nga legjislacioni në fuqi si dhe të paraqitet kontratë pune e vlefshme.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur (3 muaj) që punonjësit duhet të figurojnë në listë-pagesat e OE.

-Veç sa më sipër është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, përjashtuar ata me formimin profesional Elektracist (Hidraulik, Betonist, saldator, etj.) të kërkohej deshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për punonjësit e tjerë të cilët nuk do të kryejnë punime elektrike.

Pika 2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 24 persona** të cilët duhet të jenë pjesë e listëpagesave të muajit Maj 2023-Korrik 2023,

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

-Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 19 punonjës (1 inxhinier dhe 18 staf teknik), pra ngelen edhe 3 punonjës për të cilët nuk përcaktohet profesioni, ç'ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohej "*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*".

Pika 2.3.9. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) Punonjës i pajisur me Certifikatë trajnimi për "*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*" i dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj
- 1 (një) Punonjës i pajisur me certifikatë "*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*", e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

-Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 "*Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë*", i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM-në nr.312, datë 05.05.2010 "*Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier*", i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

Pika 2.3.10. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme

Nr.	Mjete/pajisje teknike:	Sasia/ cope	Gjendja
1	Moto gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qira
2	Depozitë uji (kapaciteti minimal 2000 litra)	2 copë	Në pronësi ose me qira

3	Betoniere kantieri 0.5m3	2 copë	Në pronësi ose me qira
4	Eskavator me goma 0.5 m3	1 copë	Në pronësi ose me qira
5	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	2	Në pronësi ose me qira
6	Kamioncinë me kapacitet mbajtës 1-1.5 ton	1	Në pronësi ose me qira
7	Fikese zjarri	15	Në pronësi ose me qira
8	Kamion me vinc kapaciteti ngrites 5 ton	1	Në pronësi ose me qira
9	Kutí ndihmës së shpejtë	15	Në pronësi ose me qira
10	Matrapik	1	Në pronësi ose me qira
11	Kithese metali	1	Në pronësi ose me qira
12	Elektrosaldatriçe	3	Në pronësi ose me qira
13	Sharre disk	2	Në pronësi ose me qira
14	Gure freksibel	2	Në pronësi ose me qira
Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të puntorëve:			
1	Kokore	25 copë	Në pronësi ose me qira
2	Fikese zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila	3 copë	Në pronësi ose me qira
3	Komplet i ndihmës së shpejtë	2 copë	Në pronësi ose me qira

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksën vjetore dhe për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qira të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

-Në këtë kriter nuk është kërkuar certifikata për transport mallrash për llogari të vetë apo për të tretë në rast marrje mjeti me qira e cila është detyrim ligjor në zbatim të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse” dhe Kapitulli III.2, “Transporti i mallrave për vetë”, neni 45, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë”.

Pika 2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht:

Certifikatë ISO 9001:2015 (Sistemet e menaxhimit të cilësisë)/ **ekuivalente dhe e vlefshme**

Certifikatë ISO 14001:2015 (Sistemet e menaxhimit të ambientit)/**ekuivalente dhe e vlefshme**

Certifikatë ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)/ **ekuivalente dhe e vlefshme**

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

-Kërkesa për këtë certifikatë nuk argumentohet nga AK. Sqarojmë se **ISO 14001:2015** specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të

përmirësuar performancën e saj mjedisore. Në rastin në fjalë projekti si fillim i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij. Gjithashtu menaxhimi mjedisor (përshëmbull mbrojtja e mjedisit nga zhurmat e mjeteve të cilat do të punojnë në segmentin rrugor) që duhet të sigurojë subjekti gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, është detyrim ligjor¹⁰ që duhet të respektohet nga subjekti nëpërmjet marrjes së masave paraprake, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet disponimit të certifikatës së sipërpërmendur. Pra që të përcaktosh kritere të tilla duhet një bazë ligjore, si dhe të jepen arsye/argumentim konkretë për përcaktimin/nevojën e tyre, që në këtë rast nuk është dhënë, si dhe duhet të jenë përputhje me zërat e punimeve që do të realizojë OE.¹¹ Për më tepër referuar procesverbalit të mbajtur nga NJP, për vendosjen e kërkesës për certifikatat ISO, pasqyrohet argumenti se janë vendosur për cilësinë e mallit. Për këtë argument, sqarohet se referuar përcaktimit të bërë në shkronjën “c” të pikës 1 dhe shkronjën “dh” në pikën 9 në Kreun III të Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, cilësia e mallit vërtetohet nëpërmjet dokumenteve (certifikatë analizat e mallit) që dorëzohen gjatë zbatimit të punimeve, ku plotësohet dosja e kantierit dhe kontrollohen nga përgjegjësi/drejtuesi teknik i kantierit.

Konkluzion.

-Sa më sipër, konstatohet se kriteret e veçanta të kualifikimit nuk janë në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 4, shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 6 të nenit 39, pikën 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. A. L., znj. L. S. dhe z. A. P..

Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 590, me nr. 7632 prot., datë 09.08.2023, të Sekretarit të Përgjithshëm z. N. N., (person i autorizuar me urdhrin nr. 219 datë 19.04.2021, i Kryetarit të Bashkisë) është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. A. I. (Kryetar), znj. M. S. dhe z. F. M., (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 16.10.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 9871 prot., datë 16.10.2023 për vlerësimin e ofertave. Nëpërmjet kërkesës në SPE, nr. 9888 prot., datë 17.10.2023, KVO i është drejtuar OE “F.” ShPK për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 10195 prot., datë 26.10.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 10 OE, përkatësisht:

- 1.OE “F.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 15,396,409 lekë pa TVSh.
- 2.OE “A.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 16,580,477 lekë pa TVSh.
- 3.BOE “S N.” & “S.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 16,630,638 lekë pa TVSh.
- 4.OE “S.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 17,467,687 lekë pa TVSh.
- 5.OE “E.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 14,571,951 lekë pa TVSh.
- 6.OE “J.” & “S.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 15,707,387 lekë pa TVSh.
- 7.OE “T.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 16,168,553 lekë pa TVSh.
- 8.BOE “K.” & “M.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 16,464,615 lekë pa TVSh.
- 9.OE “I.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 17,850,369 lekë pa TVSh.
- 10.OE “T & X.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 0 lekë.

-Nga BOE/ OE të mësipërm, janë s’kualifikuar 3 OE/BOE, si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	OE “F.” ShPK	15,396,409 lekë	Kualifikuar
2	OE “A.” ShPK	16,580,477 lekë	Kualifikuar
3	BOE “N.” ShPK & “S.” ShPK	16,630,638 lekë	Kualifikuar
4	OE “S.” ShPK	17,467,687 lekë	Kualifikuar
5	OE “E.” ShPK	14,571,951 lekë	S’kualifikuar:

¹⁰ Neni 4 në Ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar.

¹¹ Pika 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe njoftimin nr.3341/1 datë 20.03.2018 të APP për AK.

			<p>Nuk plotësoni pikën 2.3 të DST si më poshtë: 2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme, Për punët e ngjashme të realizuara si BOE krahas dokumenteve të mësipërme duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit ku përcaktohet ndarja e zërave të punimeve ndërmjet paleve, ndërsa për punët e ngjashme të realizuara si nënkontraktor duhet të paraqitet edhe kontrata e nënkontraktimit ku përcaktohen zërat e punimeve dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit. Pasi mungon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Kontratë sipërmarrjeje, 2.Certifikatë e marrjes në dorëzim e përkohshme ose përfundimtare 3.Akt kolaudimi është i paplotë, pasi mungon pjesa thelbësore përshkrim firme vule për Sipërmarrësin, Kolaudatorin. 4.Miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit si nënkontraktor 5.Situacionin përfundimtar mungon firma dhe vula e mbikëqyrësit dhe investitorit. 6.Fatuta tatimore me nr. serial 71419598 është e palexueshme
6	BOE "J." ShPK & "S." ShPK	15,707,387 lekë	<p>S'kualifikuar:</p> <p>Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk i plotësonte të gjithë kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Në këtë BOE operatori ekonomik "Spektri sh.p.k" mbështetet në kapacitetet teknike të subjektit "Vëllezërit Dervishi sh.p.k" kjo në kundërshtim me pikën e DST-së 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera: Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p> <p>Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:</p> <p>Gjithashtu mungon -Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.</p>
7	OE "T." ShPK	16,168,553 lekë	<p>S'kualifikuar:</p> <p>Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk i plotësonte të gjithë kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.</p> <p>Nuk plotësoni pikën 2.3 të DST si më poshtë: 2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme,</p> <p>Kontrata nr. 2029/12 prot., datë 30.08.2021 nuk është e ngjashme me objektin e prokuruar nga AK dhe është e paplotë, pasi mungon Fatura tatimore për situacionin përfundimtar.</p> <p>b) Kontrata nr. 2244 prot., datë 03.03.2022 nuk përmbush vlerën punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet gjithashtu mungon Fatura tatimore për situacionin përfundimtar.</p> <p>c) Kontrata nr.5 prot., datë 11.04.2023 nuk përmbush vlerën punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet gjithashtu mungon Fatura tatimore për situacionin përfundimtar.</p>
8	BOE "K." ShPK & "M." ShPK	16,464,615 lekë	<p>S'kualifikuar:</p> <p>Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk i plotësonte të gjithë kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Mungon ndarja e punimeve të preventivit. OE M. nuk ka kategorinë NS 12 A Impiant teknologjik, termike dhe të kondicionimit. Nuk plotëson kriterin 2.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente pasi mungon:</p> <p>ISO 14001:2015 Sistemet e menaxhimit të ambientit/ekuivalente dhe e vlefshme</p> <p>OHSAS 18001:2015, mbi "Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë", ekuivalente dhe e vlefshme</p> <p>Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).</p> <p>Në vetëdeklarimin sipas shtojcës 8 nuk deklaroni punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Maj 2023 – Korrik 2023</p>

			Elektracist 2 Hidraulike 2
9	OE "I." ShPK	17,850,369 lekë	S'kualifikuar: Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk i plotësonte të gjithë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Preventivi i ofruar ka gabim në përlogaritjen totale me të madh se 2 % e vlerës së ofertës ekonomike sipas pikës 3 të nenit nr. 82 të VKM-së 285/2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Vlera e ofertës ekonomike 17,850,368 * 20% = 21,420,442 lekë Vlera totale me TVSH nga OE është 18,788,868 lekë Diferenca 2,631,573 lekë, vlerë kjo më e madhe se 2% i ofertës (357,007 lekë)
10	OE "T & X." ShPK	0	S'kualifikuar: Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk i plotësonte të gjithë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Mungon i gjithë dokumentacioni i kërkuar në DST nga AK. OE "T&XH" SHPK s'kualifikohet

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 10512 prot., datë 06.11.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE "T." ShPK, me ofertën ekonomike me vlerë 11,012,845 lekë pa TVSh, me diferencë nga fondi limit në vlerën 4,134,162 lekë/27% më pak.

-S'kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht¹², nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nuk plotësohet pika 2.3.6, pasi në DST janë kërkuar që OE duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Maj 2023 – Korrik 2023

- Elektracist 2
- Hidraulik 2
- Saldator 2
- Montator 4
- Betonist 4

Punonjësit e mësipërm të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose ekuivalente me to të akredituara nga legjislacioni në fuqi si dhe të paraqitet kontratë pune e vlefshme.

-Punonjësit e deklaruar në shtojcën 8 nuk kanë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, sipas kriterëve të kërkuara në DST.

¹² Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

-Sa i përket mjeteve të transportit/ndërtimit, të deklaruar në shtojcën 8, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, konstatohet se OE nuk plotëson pikën 2.3.10 për:

-Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 1-1.5 ton, me targë AA...YX, ndërkohë ky mjet është me kapacitet mbajtës 740 kg, pra nuk është në kapacitetin e kërkuar.

-Kamioni, me targë AA...TK, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr. Rep: 544, Nr. Kol: 194, subjekti "F." ShPK me subjektin A. M., por për këtë subjekt nuk administrohet leja e qarkullimit.

-Nga OE shpallur fitues nuk është dorëzuar vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të maturuara për energjinë elektrike të maturuara për muajin shtator 2023, duke qënë se data e dorëzimit të ofertave është 20.10.2023.

Konkluzion.

OE "F." ShPK, nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. A. L., Kryetar, znj. M. S. dhe z. K. N., Anëtar.

4. Procedura e prokurimit me objekt "Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfaqës pranë rrugës nacionale Gjirokastër Kakavie Loti 2" me të dhënat si më poshtë:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfaqës pranë rrugës nacionale Gjirokastër Kakavie Loti 2".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF- 78218-08-24-2023 Urdhri nr. 509, nr. 6967 prot., datë 21.07.2023	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit S. ShPK	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 509, datë 21.07.2023 1. A. L.-Juriste 2. L. S.-Ekonomiste 3. A. P.-Ing. Ndërtimi	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 622, nr. 8091 prot., datë 29.08.2023. 1. A. L.- Kryetar 2. F. M.- Anëtar 3. M. S.- Anëtar
1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"			
5. Fondi Limit pa TVSh 40,234,286 lekë	6. Oferta fituese, vlera fituese pa TVSh: Operatori Fitues: "L." ShPK me vlerë 28,784,588 lekë.		7. Diferenca me fondin limit 11,449,698 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data 19.09.2023 (shtyrë afati) 26.09.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit.		10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 10 OE b) S'kualifikuar 7 B/OE, c) Kualifikuar 3 B/OE
11. Ankimime AK-s'ka/ka; ka APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka		13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Nr. 11950 prot., datë 15.12.2023	15. Vlera e kontratës me TVSh 28,784,588 lekë		16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës: 0 lekë
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë: 5 muaj		19. Zgjatja e kontratës me - ditë

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Preventivi

Burimi i financimit:

Fonde të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Projekti teknik i zbatimit, preventivi dhe i gjithë dokumentacioni teknik i projektit, është hartuar nga S. ShPK, me Ing. Y. G. me licencën N...../9.

Projekti i mësipërm është realizuar me procedurë prokurimi dhe është lidhur kontrata me nr. 6926 prot., datë 17.10.2018 ndërmjet Bashkisë Gjirokastër përfaqësuar nga z. V. M. zv/Kryetar i Bashkisë (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë) dhe BOE “S.” dhe “A. dhe “T. & E.” përfaqësuar nga z. Y. G..

Me shkresën nr. 7169 prot., datë 25.07.2023, është dërguar nga Sektori i projekteve dokumentacioni teknik për fillimin e procedurës së prokurimit, për objektin “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfaqës pranë rrugës nacionale Gjirokastër Kakavie Loti 2” Bashkia Gjirokastër, ku përfshihet PV për hartimin e dokumentacionit teknik, preventivi, grafiku i punimeve, analizat e çmimeve, etj.

Fondi limit është përlogaritur në vlerën 40,234,286 lekë pa TVSh. Kodet për zërat e punëve janë marrë referuar VKM-së nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Nga grupi i auditimit u testuan disa prej zërave të preventivit me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së çmimeve për njësi në preventiv me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, si dhe përputhshmërinë e tyre me projektin e zbatimit. Nga verifikimi u konstatua se çmimet për njësi përputhen me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit.

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 08.02.2023, nga NJP i ndryshuar.

Pika 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e VKM-së nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

N.P – 1	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P – 2	A	Ndërtime civile dhe industriale.
N.P – 4	A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
N.P – 5	A	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
N.P – 12	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit:

N.S – 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve.
N.S – 9	A	Punime strukturore speciale.
N.S – 18	A	Punime topogjeodezike.
N.S.- 20	A	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

- Në procesverbal nuk argumentohet dhe të pasqyrohet lloji i punimeve që do të kryhet me llojin e licencës dhe kategorinë e saj të kërkuar. Në veçanti nuk argumentohet kërkesa për licencën N.P– 4 A, N.S–1 A, dhe NS-18 A, pra cilat janë zërat e punimeve në preventiv që kërkojnë disponimin e llojit të licencave të mësipërme, dhe sa është vlera e tyre në preventiv që kërkohet kategoria A. Kjo analizë mungon në procesverbalin e përcaktimit të kriterëve teknike.

Pika 2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a) Ing. Ndërtimi	1 (një)
b) Ing. Mjedis	1 (një)
c) Ing. Hidroteknik	1 (një)
d) Ing. Gjeodet	1 (një)

e) Ing. Gjeolog

1 (një)

Secili prej pjesëtarëve të drejtuesve teknik të mësipërm duhet të jetë në listëpagesat e muajit Maj 2023- Korrik 2023 si dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë.

Për secilin prej tyre duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diploma

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, konstatohet se:

Sipas preventivit të punimeve nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë inxhinier mjedisi. Gjithashtu çdo projekt i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij. Zbatimi i masave të përcaktuara në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

-Është kërkuar inxhinier gjeodet, ndërkohë është kërkuar edhe inxhinier gjeolog, të cilët praktikisht kryejnë të njëjtat detyra¹³. Për më tepër që në preventiv nuk ka punime të natyrës që kërkojnë praninë e inxhinierit gjeodet. Gjithashtu kërkesa për inxhinierin gjeolog është e paargumentuar, pasi projektimi i punimeve ka përfunduar (faza ku kërkohet inxhinieri gjeolog për të studiuar morfologjinë e tokës, studim i cili është bërë në specifikimet teknike të projektit të mësipërm) dhe në këtë rast jemi në fazën e zbatimit të punimeve.

Pika 2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Maj 2023- Korrik 2023

- Teknik topograf ose markshajder 2
- Teknik ndërtimi 2
- Murator 3
- Hekurkthyes 2
- Hidroizolues 1
- Karpentier 4
- Suvatues 1

Punonjësit e mësipërm të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose ekuivalente me to të akredituara nga legjislacioni në fuqi si dhe të paraqitet kontratë pune e vlefshme.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur (3 muaj) që punonjësit duhet të figurojnë në listë-pagesat e OE.

-Veç sa më sipër është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, të kërkohet dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit.

Pika 2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoresh prej **minimalisht 40 persona** të cilët duhet të jenë pjesë e listëpagesave të muajit Maj 2023- Korrik 2023.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

¹³ VKM nr.514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” (LKP), të rishikuar, kodi i profesionit 2114.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

-Nërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 29 punonjës (5 inxhinier dhe 24 staf teknik), pra ngelen edhe 11 punonjës për të cilët nuk argumentohet numri si dhe nuk përcaktohet profesioni, ç'ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin”.

Pika 2.3.9. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) Punonjës i pajisur me Certifikatë trajnimi për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” i dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin

-Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM-në nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

Pika 2.3.10. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 15 ton	Copë	3	Në pronësi ose me qira
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Kamionçinë vetëshkarkuese 2-5 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
5	Eskavator me goma	Copë	2	Në pronësi ose me qira
6	Kamion me vinç me kapacitet ngritës 3.5 t me gjatësi krahu min 10 m	Copë	2	Në pronësi ose me qira
7	Mínieskavator	Copë	1	Në pronësi ose me qira
8	Fadroma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
9	Rimorkiator	Copë	1	Në pronësi ose me qira ose kontratë bashkëpunimi
10	Autobetoniere	Copë	3	Në pronësi ose me qira
11	Autopompë betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qira
12	Pompë suvatimi	Copë	2	Në pronësi ose me qira
13	Betoniere kaniteri	Copë	2	Në pronësi ose me qira
14	Sondë shpimi me aksin Ø80	Copë	2	Në pronësi ose me qira
15	Sistem drenazhimi i lëvizshëm	copë	1	Në pronësi ose me qira
16	Gjenerator	Copë	1	Në pronësi ose me qira
17	GPS	copë	1	Në pronësi ose me qira
18	Kokore	copë	30	Në pronësi ose me qira
19	Fikëse zjarri	copë	15	Në pronësi ose me qira
20	Kuti ndihmë e shpejtë	copë	15	Në pronësi ose me qira

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksën vjetore dhe për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i

këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qira të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

-Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk argumentohet numri i mjeteve dhe makinerive, por është bërë vetëm argumentimi i domosdoshmërisë (*pra nevojitet kamioni vetëshkarkues pasi kemi materiale ndërtimi për t'u transportuar, apo eskavator pasi kemi punime gërmimi*) së llojit të mjeteve në përputhje me zërat e preventivit. Gjithashtu nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të mjeteve të nevojshëm për zbatimin e projektit. Pra nuk është bërë një përcaktim konkret dhe me analizë teknike, cilat do të jenë materialet që do të transportohen me kamionin vetëshkarkues, sa është pesha totale e materialeve, sa peshë mund të transportojë kamioni në një rrugë, sa rrugë në ditë mund të bëjë, dhe në bazë të kësaj përcaktohet sa pesha mund të transportojë kamioni në një ditë pune (8 orë) dhe me pas në 880 orë pune gjithsej (5 muaj), për të arritur në përcaktimin e numrit të kamionave.

-Nuk argumentohet teknikisht kërkesa për sondë shpimi në përputhje me llojin e punimeve, si dhe numri i kërkuar për sondë shpimi, në përputhje me volumin dhe grafikun e punimeve.

-Në këtë kriter nuk është kërkuar certifikata për transport mallrash për llogari të vetë apo për të tretë në rast marrje mjeti me qira e cila është detyrim ligjor në zbatim të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, "*Për transportet rrugore*", i ndryshuar, Kapitulli III "*Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë*", neni 41, ku përcaktohet që: "*Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse*" dhe Kapitulli III.2, "*Transporti i mallrave për vete*", neni 45, ku përcaktohet që: "*Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë*".

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. A. L., znj. L. S. dhe z. A. P..

Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 622, me nr. 8091 prot., datë 29.08.2023, të Sekretarit të Përgjithshëm z. N. N., (person i autorizuar me urdhrin nr. 219 datë 19.04.2021, i Kryetarit të Bashkisë) është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. A. I. (Kryetar), znj. M. S. dhe z. F. M., (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 06.11.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 10581 prot., datë 06.11.2023 për vlerësimin e ofertave. Nëpërmjet kërkesës në SPE, nr. 10642 prot., datë 07.11.2023, KVO i është drejtuar OE "L." ShPK për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 11060 prot., datë 16.11.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 10 OE/BOE, përkatësisht:

- 1.OE "C." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 32,939,908 lekë pa TVSh.
- 2.OE "L." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 31,551,369 lekë pa TVSh.
- 3.OE "L." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 28,784,588 lekë pa TVSh.
- 4.OE "B." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 36,934,554 lekë pa TVSh.

5. BOE "D. ShPK & A." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 36,067,671 lekë pa TVSh.
 6. OE "E." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 32,262,881 lekë pa TVSh.
 7. BOE "E." & I." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 25,951,100 lekë pa TVSh.
 8. OE "L." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 29,581,132 lekë pa TVSh.
 9. BOE "L." & "B." & "B." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 37,515,240 lekë pa TVSh.
 10. OE "S." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 31,310,765 lekë pa TVSh.

-Nga BOE/ OE të mësipërm, janë s'kualifikuar 7 OE/BOE, si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	OE C. ShPK	32,939,908 lekë	Kualifikuar
2	OE L. ShPK	31,551,369 lekë	Kualifikuar
3	OE L. ShPK	28,784,588 lekë	Kualifikuar
4	OE B. ShPK	36,934,554 lekë	S'kualifikuar Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk i plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. I Mungon i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga AK në DST
5	BOE D. & A. ShPK	36,067,671 lekë	S'kualifikuar Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk i plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Operatori ekonomik mbështetet në kapacitetet teknike të subjektit "Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro company" kjo në kundërshtim me pikën e DST-së 2.16. Mbështetja në kapacitete e subjekteve të tjera: Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera. Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:
6	OE E. ShPK	32,262,881 lekë	S'kualifikuar Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk i plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Operatori ekonomik mbështetet në kapacitetet teknike të subjektit "Rrugë sinjalistikë mirëmbajtje dhe hidro company" kjo në kundërshtim me pikën e DST-së 2.16. Mbështetja në kapacitete e subjekteve të tjera: Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera. Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja: Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:
7	BOE E. & I. ShPK	25,951,100 lekë	S'kualifikuar Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk i plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Nuk plotësoni pikën 2.3 të DST si më poshtë: 2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme, Për punët e ngjashme të realizuara si BOE krahas dokumenteve të mësipërme duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit ku përcaktohet ndarja e zërave të punimeve ndërmjet palëve, ndërsa për punët e ngjashme të realizuara si nënkontraktor duhet të paraqitet edhe kontrata e nënkontraktimit ku përcaktohen zërat e punimeve dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit Pasi mungon: - Kontratë sipërmarrjeje, - Certifikatë e marrjes në dorëzim e përkohshme ose përfundimtare - Akt kolaudimi është i paplotë, pasi mungon pjesa thelbësore përshkrim firmë vulë për Sipërmarrësin, Kolaudatorin. - Miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit si nënkontraktor - Situacionin përfundimtar mungon firma dhe vula e mbikëqyresit dhe investitorit. - Fatuta tatimore me nr. serial 71419598 është e palxueshme • <input type="checkbox"/> Nuk plotësoni 2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: a) Ing. Ndërtimi • <input type="checkbox"/> Nuk plotëson 2.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Maj 2023- Korrik 2023

			<ul style="list-style-type: none"> • <input type="checkbox"/> Murator 3 • <input type="checkbox"/> Hekurthyes 2 • <input type="checkbox"/> Hidroizolues 1 • <input type="checkbox"/> Karpentier 4 • <input type="checkbox"/> Suvatues 1 • <input type="checkbox"/> Pasi nuk i deklaroni në shtojcën 8 të formularit të vetëdeklarimit ndërkohë OE E. shpk merr përsipër 49% të punimeve të preventivit
8	OE L. ShPK	29,581,132 lekë	<p>S’kualifikuar Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk i plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Operatori ekonomik mbështetet në kapacitetet teknike të subjektit “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro company” kjo në kundërshtim me pikën e DST-së 2.16. Mbështetja në kapacitete e subjekteve të tjera: Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.</p> <p style="text-align: center;">Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p> <p>Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:</p> <hr/> <p>Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja</p>
9	BOE L. & B. & B. ShPK	37,515,240 lekë	<p>S’kualifikuar Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se operatorët ekonomik kishin mangësi dhe nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. OE L. ShPK pjesë e këtij BOE nuk plotëson kriterin N.P – 5 /A Punime nëntokësore, ura e vepra arti, ndërkohë merr përsipër punime në preventivin e ofruar sipas ndarjeve të marreveshjes që i përkasin kategorisë NP1, NP5 sipas kriterëve të vendosura nga NJHDT</p>
10	OE S. ShPK	31,310,765 lekë	<p>S’kualifikuar Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk i plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Operatori ekonomik mbështetet në kapacitetet teknike të subjektit “M.” ShPK kjo në kundërshtim me pikën e DST-se 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera: Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.</p> <p>Po Jo X</p> <p>Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja: Gjithashtu oferta juaj ka gabime pasi keni ndryshuar zerin e mëposhtëm duke ulur sasinë nga 384.34 m³ në 374.34 m³ 3 An Beton C 30/37 me aditiv përshpejtues për perden me pilota m³ 384.34</p>

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 11339 prot., datë 24.11.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE “L.” ShPK, me ofertën ekonomike me vlerë 28,784,588 lekë pa TVSh, me diferencë nga fondi limit në vlerën 11,449,698 lekë/28.5% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht¹⁴, nga OE “L.” ShPK shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

5.Procedura e prokurimit me objekt “Rehabilitim i segmenteve të ndryshme rrugore” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim I segmenteve të ndryshme rrugore”.

¹⁴ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF- 62181-03-10-23 Urdhri nr. 171 prot., datë 09.03.2023	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Drejtoria e Urbanistikës	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 171, datë 09.03.2023 1. A. L. 2. L. S. 3. A. P.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 184 prot., datë 10.03.2023 1. A. I. 2. F. M.j 3. K. N.
1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Hapur”			
5. Fondi Limit (pa tvsh) 36,309,280 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: (OE “N.” Shpk) 25,682,329 lekë pa tvsh.		7. Diferenca me fondin limit 10,626,951 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data 03.04.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit.		10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 11 OE b) S’kualifikuar 0 B/OE , c) Kualifikuar 11 B/OE
11. Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka		13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Nr. 4048, datë 27.04.2023	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 30,818,794 leke		16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. xxx
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 10 javë		19. Zgjatja e kontratës me ditë

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Bashkia Gjirokastër me VKB nr. 100, datë 16.12.2022, “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023”, për të cilën është shprehur edhe insitucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër ka miratuar fondet mbi objektin e prokurimit: “Rehabilitim i segmenteve te ndryshme rrugore”. Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Gjirokastër në formatin elektronik më datë 28.09.2023, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154.

Me urdhërin nr 3071 prot datë 09.03.2023 të zyrtarit të autorizuar të autoritetit kontraktor z. N. N. është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. A. L. (Personi përgjegjës), znj. L. S., z. A. P. (Anëtar), për kryerjen e prokurimit me objekt “Rehabilitim i segmenteve te ndryshme rrugore” me fond limit 36,309,280 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e hapur”. Me shkresën nr. 2463 prot., datë 10.03.2023, nga Drejtoria e Urbanistikës, Sektori i Projekteve është përcjellë dosja teknike pranë Njesisë së Prokurimit. Në dosjen teknike janë të përfshira:

- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;
- Relacioni teknik;
- Specifikimet teknike;
- Projekt zbatimi;

Për sa trajtuar më sipër dosja teknike është hartuar nga z. A. P. Inxhinier Ndërtimi me nr. Licen K...../1, z F. M. Inxhinier Ndërtimi, znj. E. X. Arkitekt dhe miratuar nga z. F. G. Kryetar i Bashkisë. Nga verifikimi konstatohet se z F. M. Inxhinier Ndërtimi, znj. E. X. Arkitekt nuk janë të pajisur me liçencën përkatëse në fushën e projektimit¹⁵. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5, ku përcaktohet që:

¹⁵ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

Neni 3: Në kuptim të këtij ligji, nëse nuk përcaktohet ndryshe punime ndërtimi quhen të gjitha punimet e ndërtimit për ndërtesat, objektet qytetare, veprat industriale, të infrastrukturës dhe për objektet e tjera.

Neni 5: “Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse”.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, **nuk** rezultojnë të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një **oponencë teknike**, në lidhje me procedurën e sipërcituar, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik.

Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezultojnë të jetë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik”.

Nga ana tjetër, miratimi i projektit të zbatimit, nga ana e Bashkisë Gjirokastër, nuk i referohet një oponence teknike dhe, në mungesë të kësaj të fundit, është në kundërshtim me pikën 3 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, sipas të cilës: “Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike...”.

Për sa më sipër, referuar pikës 4 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010, kërkesa për oponencë teknike bëhet nga investitori, çka nënkupton edhe përgjegjësinë e këtij të fundit në rast mosveprimi.

Në kuptim të ligjit nr. 107/2014, referuar nenit 52 të tij, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike, përbën kundërvajtje administrative.

Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, **ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Z. F. G.**

Pika 3 e VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 thekson se: “Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike...”

Hartimi i kriterëve të DT:

Me urdhërin nr 3071 prot datë 09.03.2023 të zyrtarit të autorizuar të autoritetit kontraktor z. N. N. është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. A. L. (Personi përgjegjës), znj. L. S., z. A. P. (Anëtar), është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

2. Për pikën 2.7 (pika 1), AK ka kërkuar që, Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- 1 (nje) Punonjes i pajisur me Certifikatë trajnimi për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” i dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

Sipas grupit të auditimit:

*I. Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, gërma “b” dhe pika 4 gërma “b” thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, **shfuqizohet. Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezultojnë të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk***

ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”. Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar.

Për pikën 2.11, AK ka kërkuar që, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisje të mbrojtjes në punë të puntorëve ndër të tjera...:

Nr.	Mjete/pajisje teknike:	Sasia	Gjendja
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5-7 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve:		
1	Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila	3 copë	Në pronësi ose me qera
2	Komplet i ndihmës së shpejtë	2 copë	Në pronësi ose me qera

Sipas grupit të auditimit:

Sa më sipër, konstatohen kërkesa kualifikuese të pa argumentuara në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës.

Në dosjen e prokurimit, nuk disponohet asnjë dokument mbi përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe **ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.**

Për pikën 2.13 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontrate bashkëpunimi impiantet si me poshte vijon ; **I (një) Impiant prodhimi Betoni.** Për impiantin e prodhimit të inerteve/ betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/ betonit, është me qera ose kontrate bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qerave/bashkëpunimit

Sipas grupit të auditimit:

Kërkesa për I (një) fabrikë betoni (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, në mënyrë të pajustificuar e të paargumentuar.

Vendosja e Impiant Fabrikë Betoni për prodhimin e elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatorët ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Njje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomik tregtar i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marrë pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dorë nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhënë me qira linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtar do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesi është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtar që do të marrë pjesë në tender.

Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit në rast se është në pronësi të firmës, duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e këtyre dokumentave përben kusht për skualifikim. Pra,

vendosen **kërkesa mbi kërkesa të kërkesave**, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit.

Sa më sipër, në 3 (tre) raste dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK (*specialisti i fushë/NjPs*), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, **neni 78, pika 2** “*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” ku citohet se: “*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*”

- **Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.** Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është “*Kriteri për shpalljen e ofertës fituese*”. Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, “*Për prokurimin publik*”, sipas të cilit: “*4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese...*”.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. A. L., znj. L. S. dhe z. A. P..

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 11 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. s’ka, të datës 13.04.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin e B/OE nga ku rezulton se janë kualifikuar 11 B/OE si më poshtë:

1.C. shpk me NIPT J.....K me vlere te ofertes 26.307.024 (njëzet e gjashtë mmilion e treqind e shtatë mijë e njëzetë e katër) leke pa tvsh

2.OE R. shpk me NIPT me vlere te ofertes 26.965.349 (njëzetë e gjashtë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzetë e nëntë) leke pa tvsh

3.OE E. shpk me NIPT K.....P me vlere te ofertes 27169799 (njëzetë e shtatë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) leke pa tvsh

4.OE A. shpk me NIPT K.....Q me vlere te ofertes 27.412.678 (njëzetë e shtetë milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë) leke pa tvsh

5.OE I. shpk me NIPT J.....Ë me vlere te ofertes 28.333.367,72 (njëzetë e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje shtatëdhjetë e dy) leke pa tvsh

6.OE A. shpk me NIPT M.....L me vlere te ofertes 28.333.367,72 (njëzetë e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje shtatëdhjetë e dy) leke pa tvsh

7.OE M. shpk me NIPT J.....K me vlere te ofertes 28.850.455 (njëzetë e tetë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind epesëdhjetë e pesë) leke pa tvsh

8.OE D. shpk me NIPT K.....B me vlere te ofertes 29.982.939.5 (njëzetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë presje pesë) leke pa tvsh

9.OE L. shpk me NIPT K....I me vlere te ofertes 34.490.271 (tridhjetë e katër milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) leke pa tvsh

10.OE N. shpk me NIPT J U me vlere te ofertes 25.682.329 (njëzetë e pesë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzetë e nëntë) leke pa tvsh

11. OE N. shpk me NIPT K.....T me vlere te ofertes 27.451.776 (njëzetë e shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) leke pa tvsh

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës Nr. 3650 prot., datë 13.04.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës

dhe formularit të njoftimit të fituesit, janë kualifikuar të 11 operatorë pjesëmarrës. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK Nr.4084 prot., datë 27.04.2024 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “N.” shpk për të cilën është lidhur kontrata datë **Nr. 4048, datë 27.04.2023 me vlerë 25,682,329 lekë pa TVSH** dhe vlera **30,818,794 lekë me TVSH**, dhe me afat **120** ditë nga data e lidhjes së kontratës.

c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve. (Nuk ka patur ankimime)

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e BOE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se nuk janë paraqitur ankesa nga BOE, duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht kriterin e pikës 2.11 të DST si vijon:

1. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.11 të DST** pasi ka deklaruar mjeteve të transportit/ndërtimit sipas rastit, të deklaruar në shtojcën 8 nga OE “N.” SHPK, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e zotëron nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë të tyre e ka në pronësi, konstatohet se për mjetet e mara me qira janë per përdorim vetiak konkretisht:

1.1 Më datë 05.03.2021, ndërmjet personit fizik S. P. me nr personal G.....T dhe OE “N.” Shpk përfaqësuar nga Administratori i Shoqërisë znj. S. N. është lidhur kontrata e qirasë për marrjen me qira të mjetit Eskavator me goma me targë ADMT.. numër shasie Kontrata e sipërpërmendur është nënshkruar sipas vërtetimit noterial me nr. 3111 Rep., nr. 1185 Kol., datë 05.03.2021. Për mjetin Eskavator me goma me targë ADMT.. dokumentacioni shoqërues për këtë mjet nuk është i plotë konkretisht, pasi mundon çertifikata për transport mallrash për llogari të të tretëve duke marrë në konsideratë faktin që kjo është kontratë qiraje dhe OE i shpallur fitues nuk e disponon vet si mjet.

1.2. Me datë 10.01.2023 dhe datë 14.09.2023, ndërmjet Shoqërisë “B.” Shpk përfaqësuar nga Administratori z. B. I. dhe shoqërisë “N.” Shpk përfaqësuar nga Administratori i Shoqërisë znj. S. N. është lidhur kontrata e qirasë për marrjen me qira të mjetit Autobetoniere me targë AA...FY numër shasie ËDB9..... Dokumentacioni shoqërues për këtë mjet nuk është i plotë konkretisht, çertifikata për transport mallrash është për llogari të vet dhe jo për të tretë duke marrë në konsideratë faktin që kjo është kontratë qiraje dhe OE i shpallur fitues nuk e disponon vet si mjet. Lidhur me sa më sipër, për certifikatat e transportit sqarojmë se: Në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

Për sa trajtuar më sipër OE “N.” Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje znj. A. L., z. F. M. dhe z. K. N.

6.Procedura me Objekt “Modernizimi i ndriçimit rrugor publik në njësitë administrative faza e parë”.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Modernizimi i ndriçimit rrugor publik në njësitë administrative ”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF- 62559-03-15-2023 Urdhri nr. 185 prot., datë 13.03.2023	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Drejtoria e Urbanistikës	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 185, datë 13.03.2023 1. A. L. 2. L. S. 3. T. B.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 195 prot., datë 15.03.2023 1. A. I. 2. A. K.

1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “e hapur ”			3. K. N.
5. Fondi Limit (pa tvsh) 15,288,000.00 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: (OE “R.” Shpk) 12,900,000.00 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit 2,388,000.00 lekë pa tvsh	
8. Data e hapjes së tenderit: Data 05.04.23	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit.	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) S’kualifikuar 1 B/OE, c) Kualifikuar 1 B/OE	
11. Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka	
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Nr. 4213, datë 02.05.2023	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 15,480,000.00 leke	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. 15,480,000 lekë	

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Preventivi

Burimi i financimit:

Fonde të vena në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Hartimi i kriterëve të DT:

Me urdhrin nr. 185, me nr. 2477 prot., datë 13.03.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm z. N. N. (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastër me nr. 219 datë 19.04.2021) është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. A. L. (Personi përgjegjës), znj. L. S., z. T. B.. Me procesverbalin e datës 15.03.2023, komisioni i sipërpërmendur ka hartuar kriteret e pranimit/kualifikimit për objektin “Modernizimi i ndriçimit rrugor publik në njësitë administrative”. Në aplikimin e kriterëve nga AK, janë konstatuar kriterë **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, të cilat në mënyrë direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim, *konkretisht*:

Kërkesat e pikës- 2.8 të DT e cila kërkon që Operatori ekonomik të jetë i pajisur me ISO 9001-2015

a) **ISO 9001-2015 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Referuar objektit të procedurës së prokurimit kjo kërkesë nuk është e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi, objekt prokurimi është “Blerje malli” dhe jo “Punë publike”. Kërkesat e pikës- 2.8 të DT e cila kërkon që Operatori ekonomik të jetë i pajisur me ISO 9001-2015 është në kundërshtim me **kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 78 “*Hartimi*

dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Për sa trajtuar më sipër, në procedurën e prokurimit me objekt: “Modernizimi i ndriçimit rrugor publik në njësitë administrative”, konstatuar se, kriteret e aplikuar në DT nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe ngarkon me përgjegjësi Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. A. L. (Personi përgjegjës), znj. L. S., z. T. B. (Anëtar),

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhër nr. 696, nr. 7967 prot., datë 12.09.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Gjirokastrë (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr. 219, nr. 3980 prot., datë 19.04.2021), është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. A. L. (Kryetar), z. K. N. dhe z. A. K., (Anëtar). Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 3764 prot., të datës 18.04.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin e B/OE nga ku rezulton se janë kualifikuar 1 B/OE dhe janë skualifikuar 1 B/OE si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	OE R. SHPK	12,900,000	Kualifikuar
2	OE A. SHPK	13,800,000	Kualifikuar

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK me ane të shkresës Nr. 3776 prot., datë 18.04.2023 ka shpallur fituese ofertën e operatorit ekonomik “R.” shpk për të cilën është lidhur kontrata datë nr. 4213 prot, datë 02.05.2023 me vlerë 12,900,000 lekë pa tvsh, me afat 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve. (Nuk ka patur ankime)

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e BOE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se nuk janë paraqitur ankesa nga BOE, duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK. Për sa trajtuar më sipër OE “R.” Shpk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2.

7.Procedura e prokurimit me objekt “Karburant” Loti I Naftë benzenë”. me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Karburant” Loti I Naftë benzine dhe Loti II Lëndë djegëse për Kaldajën”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF- 56928-01-25-2023 Urdhri nr 38 dt 17.01.23	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 37, datë 16.01.2023 1.A. R.j 2.A. A.	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 38, datë 17.01.2023 1.A. L. 2.L. H. 3.A. R.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 752 prot., datë 25.01.2023. 1. A. I. 2. A. K. 3. K. N.
5. Fondi Limit (pa tvsh) 27029915.2 lekë	6. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: (BOE A. & C. & G) 27.011.532,83 marzh fitimi 15.2 lekë pa tvsh.		7. Diferenca me fondin limit 18.383 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data 15.02.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit.		10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 1 OE b) S’kualifikuar 0 B/OE , c) Kualifikuar 1 B/OE
11. Ankime	12. Përgjigje Ankesës nga AK		13. Përgjigje Ankesës nga

AK-s'ka/ka; ka APP-s'ka/ka; KKP-s'ka/ka	S'ka	APP apo KKP : S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr 2727 prot dt 17.03.2023	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 32.413.839,4	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. xxx
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 31.12.2023	19. Zgjatja e kontratës me - ditë

7.1. Procedura e prokurimit me objekt: “Karburant” Loti II Lende djegese per kaldaje”.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Karburant” Loti II Lende djegese per kaldaje”.		
2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit. Urdhri nr. 37, datë 16.01.2023 1.A. R.j 2.A. A.	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 38, datë 17.01.2023 1. A. L. 2. L. S. 3. A. R.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 752 prot., datë 25.01.2023. 1. A. I. 2. A. K. 3. K. N.
6. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: (R.) 3.768.174,25 marzh fitimi 18.05	7. Diferenca me fondin limit 10.378,83 lekë pa tvsh	
9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit.	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 1 OE b) S’kualifikuar 0 B/OE , c) Kualifikuar 1B/OE	
12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka	
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
15. Vlera e kontratës (me TVSH) 4.521.809 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.	
18. Afati i kontratës në ditë 31.12.2023	19. Zgjatja e kontratës me - ditë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Karburant” Loti I Naftë, Benzenë - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, janë siguruar fonde në vlerën 30,808,468 lekë nga të Ardhurat e Veta të Bashkisë Gjyrokastër miratuar me VKB nr. 100, datë 16.12.2023, “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023”, për të cilën është shprehur edhe insitucioni i Prefektit të Qarkut Gjyrokastër mbi verifikimin e ligjshmërisë

Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Gjyrokastër në formatin elektronik më datë 27.08.2024, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154.

Urdhri nr. 382 prot, datë 11.01.2023, të z. F. G. Kryetar i Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. A. A., z. O. Z. dhe z. K. T., për konometrimin e normativave të harxhimit të karburantit për vitin 2023.

Në total nga grupet e punës është hartuar Procesverbali –Teknik për caktimin e normative të harxhimit të Karburantit për 16 mjete.

Me urdherin nr 449 prot datë 16.01.2023 të zyrtarit të autorizuar të autoritetit kontraktor z. N. N. është ngritur janë caktuar personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit për realizimin e procedurës me objekt “Karburant” e përbërë nga znj. A. R. dhe z. A. A.

Sipas procesverbalit të datës 13.01.2023, të mbajtur për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “llogaritjes së çmimit në bazë të çmimit të bursës lëvruar sipas kushtit CIF të Shqipërisë, elementëve fiskalë dhe normës së fitimit të shprehur në vlerë absolute, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, ka bërë përlogaritjen e çmimit me datën e përgatitjes së urdhrin të prokurimit duke parë buletinin e fundit të datës 17.01.2023 nr. 32 referuar bursës datë 13.01.2023

referuar kursit të këmbimit datë 16.03.2022 ka dalë në përfundimin që cmimi i karburantit është i më poshtë:

- Gazoil 0.1% 198,779 lekë pa tvsh/litër;
- Benzinë 10 ppm 175,515 lekë pa tvsh/litër;
- Gazoil 10 ppm 196,372 lekë pa tvsh/litër;

Është bërë përlllogaritja dhe përcaktimi i vlerave sipas llojit të karburantit kjo në bazë të harxhimit të mjeteve të drejtorivë përkatëse dhe kaldajave kjo e evidentuar në preventiv. Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision me urdhrin nr. 37 datë 16.01.2023 “Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike”, i përbërë prej, A. A. inxhinier mekanik dhe A. R. Inxhinier mjedisi. Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. s’ka, datë s’ka nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Sa më sipër rezulton se përlllogaritja e bërë nga grupi i punës dhe përcaktimi e vlerave sipas llojit të karburantit kjo në bazë të harxhimit të mjeteve të drejtorivë përkatëse dhe kaldajave kjo e evidentuar në preventiv nuk është në përputhje me Aktin Normativ nr. 5 datë 12.03.2022 “për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.12.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” të ndryshuar ku është përcaktuar “Metodologjia e përlllogaritjes së cmimit për gazolin, benzinën dhe gazin e lëngshëm të naftës, I cili caktohet nga ana e bordit të ngritur për këtë qëllim, një cmim tavan për shitjen e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi z A. A. inxhinier mekanik dhe znj. A. R. Inxhinier mjedisi.

Loti I

Hartimi i kriterëve të DT:

Me shkresën nr. 467 prot., datë 17.01.2023, nga NjP e përbërë nga znj. A. L. kryetare, znj. L. S. dhe znj A. R. antare të njësisë është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit më datë 25.01.2025.

Më datë 01.02.2023, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Gjirokastrë, rezulton se:

-Për procedurën me REF-56934-01-25-2023 me fond limit 27,029,915 lekë, me objekt “Naft Benzinë”

- Për procedurën me REF-56928-01-25-2023 me fond limit 3,778,553 lekë, me objekt “Lëndë djegëse për kaldajë”

Më shkresën nr. 1018 datë 01.02.2023 nga z. N. N. në cilësinë e zyrtarit të autorizuar të Titullarit të AK ka publikuar në Sistemin e APP-së njoftimin për ndryshimin e DT. Nga NjP është mbajtur procesverbali për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, ku është hartuar një shtojcë në DT si më poshtë:

Ishte	Bëhet :
Specifikimt teknike te lëndës djegëse Diezel duhet të jenë sipas standartit shqiptar SSH EN 590 2018 dhe për lëndën djegëse Benzinë duhet të jetë sipas standartit t SSH EN 228 2018	Specifikimt teknike te lëndës djegëse Diezel duhet të jenë sipas standartit shqiptar SSH EN 590 2018 ose SSH EN 590:2022 dhe për lëndën djegëse Benzinë duhet të jetë sipas standartit t SSH EN 228 2018
Operatori duhet të disponojë certifikatë ISO BS PAS 99:2012 ” Për sistemin e menaxhimit të integruar ” ose ekuivalente	hiqet
Operatori/et Ekonomik duhet detyrimisht te jetë i pajisur me Licencë me kod VIII.1.A me kategori II/A dhe III/A	Operatori/et Ekonomik duhet detyrimisht te jetë i pajisur me Licencë me kod VIII.1.A me kategori II/A dhe III/A. Licencë për tregëtim me pakicë të karburanteve , gazit të lëngshëm të naftës për automjetet , vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë të lëshuar nga Njësitë e

Vetqevrisjes Vendore ose licencë për tregëtim me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj nga QKL të lëshuar nga ministria përkatëse.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje nuk ndryshon kjo në bazë të Ligjit nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 75 pika 2 paragrafi II **Në lidhje me “Argumentimin dhe hartimin e kriterëve”.**

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej;

- A. L. Jurist / Person përgjegjës;
- F. C. Ekonomist;
- A. R. Inxhinieri mjedisi; të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 24.03.2022.

Referuar kërkesave të vendosura për kualifikim konkretisht në kriteret e veçanta, është kërkuar nga autoriteti kontraktor që OE pjesëmarrës do të kenë si kusht s’kualifikimi mos plotësimin e kriterëve ku ndër të tjera kërkohet që;

Operatori ekonomik duhet të disponojë, jo më pak se 2(dy) ”stacione të shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante” të pajisur me licencën përkatëse, në të cilin të tregtohet normalisht karburantet e llojeve, Diesel Gazoilit (10 ppm ULSD) dhe BENZINE (PREMIUM UNL 10 ppm) në një distancë jo më të largët se 12 (dymbëdhjetë) kilometra, nga qyteti i Gjirokastrës, te vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose kontrate noteriale qeraje, me afat te pakten deri me 31.12.2022 ose te jenë te pasqyruara ne ekstraktin e QKB).

*Operatori ekonomik duhet të disponojë, jo më pak se 2(dy) “Stacione të shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të karburanteve për automjete, **gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante**” të pajisur me licencën përkatëse, në të cilin të tregtohet normalisht karburantet e llojeve, Diesel Gazoilit (10 ppm ULSD) dhe BENZINE (PREMIUM UNL 10 ppm) në një distancë jo më të largët se 12(dymbëdhjetë) kilometra, nga qyteti i Gjirokastrës, te vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose kontrate noteriale qeraje, me afat te pakten deri me 31.12.2022 ose te jenë te pasqyruara ne ekstraktin e QKB). (Ky kriter ishte jo më pak se 3 (tre) stacione dhe është ndryshuar me shtojcën përkatëse në SPE pas Rekomandimit të APP nr. 3151 datë 31.03.2022. Në rrethin e Gjirokastrës referuar të dhënave të licencave për tregëtimin e lëndëve djegëse në fushën e hidrokarbureve të dhëna nga Bashkia Gjirokastrë, rezulton se ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë fushë reth 10 subjekte.*

Kriteri i vendosur ku OE të disponojë jo më pak se 2(dy) stacione shitjeje, është i pa argumentuar teknikisht dhe ligjërishit pasi, referuar pjesëmarrjes në këtë procedurë prokurimi, ku rezulton se ka marrë pjesë vetëm një OE. Gjithashtu në këtë kërkesë citohet që OE të ushtrojë veprimtari të tregëtimit dhe të gazit të lëngshëm e lubrifikantëve, gjë e cila nuk përkon me kërkesat e AK pasi nuk është kërkuar blerje gazi dhe lubrifikantësh. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 83, pika 2/b, në të cilin citohet se; “Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës”

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi hartuesit e kriterëve të kualifikimit A. L., F. C.dhe A. R..

LOTI I NAFTË BENZINË

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 2696, të datës 16.03.2023 si dhe është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 1 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 0 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 16.03.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “BOE “G.” SHA & “A.” sh.p.k “G.” SHPK” për të cilën është lidhur kontrata me nr. 2727 prot datë 17.03.2023 për vlerën

26,967,877 lekë pa TVSH me vlerë absolute 15.2 lekë për litër dhe vlera 32,361,452 lekë me TVSH, dhe me afat deri më 31.12.2023 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Loti II

Hartimi i kritereve të DT:

Me shkresën nr. 467 prot., datë 17.01.2023, nga NjP e përbërë nga znj. A. L. kryetare, znj. L. S. dhe znj A. R. antare të njësisë është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit më datë 25.01.2025.

Më datë 01.02.2023, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Gjirokastrë, rezulton se:

-Për procedurën me REF-56934-01-25-2023 me fond limit 27,029,915 lekë, me objekt “Naft Benzinë”

- Për procedurën me REF-56928-01-25-2023 me fond limit 3,778,553 lekë, me objekt “Lëndë djegëse për kaldajë”

Më shkresën nr. 1022 datë 01.02.2023 nga z. N. N. në cilësinë e zyrtarit të autorizuar të Titullarit të AK ka publikuar në Sistemin e APP-së njoftimin për ndryshimin e DT. Nga NjP është mbajtur procesverbali për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, ku është hartuar një shtojcë në DT si më poshtë:

Ishte	Bëhet :
Operatori ekonomik ofertues duhet të depozitojë Leje Mjedisore sipas legjislacionit mjedisor	Operatori ekonomik ofertues duhet të depozitojë Leje Mjedisore e tipi B sipas legjislacionit mjedisor Për ndikimin në mjedis.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje nuk ndryshon kjo në bazë të Ligjit nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 75 pika 2 paragrafi II

Në lidhje me “Argumentimin dhe hartimin e kritereve”.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej;

- A. L. Jurist / Person përgjegjës;
- F. C. Ekonomist;
- A. R. Inxhinier mjedisi; të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 24.03.2022.

Referuar kërkesave të vendosura për kualifikim konkretisht në kriteret e veçanta, është kërkuar nga autoriteti kontraktor që OE pjesëmarrës do të kenë si kusht s’kualifikimi mos plotësimin e kritereve ku ndër të tjera kërkohet që;

Operatori/et Ekonomik duhet detyrimisht të jetë i pajisur me Licencë me kod VIII.1.A dhe kategoria III/A të leshuar nga *Qendra Kombëtare e Licencimit (OKL)* me afat vlefshmërie për të gjithë periudhën e kësaj procedure.

Ne vlerësimin tone, vendosja e kërkesës, për disponimin nga OE ofertues të Licencës së leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (OKL), nuk perkon me objektin e kontratës që prokurohet nga AK (furnizimi me karburant si konsumator fundor) dhe për me teper kufizon OE pjesëmarrës. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 40, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se “Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”. Referuar dhe rekomandimeve të APP Licenca për tregëtim të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, lëshohet nga OKL vetëm për shoqëritë tregëtare, të themeluara në formën e shoqërive aksionare.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi hartuesit e kritereve të kualifikimit A. L., F. C. dhe A. R..

LOTI II Lëndë djegëse për kaldajën

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 2567, të datës 15.03.2023 si dhe është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 1 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 0 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 15.03.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “OE “R.” SHPK” për të cilën është lidhur kontrata me nr. 2948 prot datë 24.03.2023 për vlerën 3,768,174 lekë pa TVSH me vlerë absolute 18.5 lekë për litër dhe vlera 4,521,809 lekë me TVSH, dhe me afat deri më 31.12.2023 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, Bashkia Gjirokastrë referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej 85 procedura prokurimi me fond limit 293,375,139 lekë pa TVSh, me vlerë kontrate **229,835,628** lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **63,539,511 lekë pa TVSh** ose **21.6 %**. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2024 – 31.12.2024	Nr.	Vl.Fond Limit (pa TVSh)	Vl.Kontrate (pa TVSh) dhe (me TVSh)	
GJITHESEJ	39	275,218,342	214,600,911	257,521,095
-Të hapura	13	195,224,347	147,209,480	176,651,376
-Shërbim konsulence	0			
-Negocim pa shpallje	0			
-E hapur e thjeshtuar	26	79,993,995	67,391,432	80,869,718
Sipas objekteve				
-Objekte në fushën e punëve publike	6	149,816,908	106,520,205	127,824,247
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	33	125,401,434	108,080,706	129,696,848

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **926 OE/BOE**, nga të cilat janë s'kualifikuar **433 OE/BOE**. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej 2 procedura ose 2.3 % e procedurave të zhvilluara në total për periudhën objekt auditimi.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjedhi për auditim:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatuan mangësi në procedurat si më poshtë vijon:

Prokurimet me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2024-31.12.2024

1. Tenderi me objekt: “*Blerje kontenierësh për mbetjet urbane*”, me vlerë kontrate 3,225,400 lekë pa TVSh;
2. Tenderi me objekt: “*Blerje mjeti skrep*”, me vlerë kontrate 4,150,000 lekë pa TVSh;
3. Tenderi me objekt: “*Rehabilitim në segmente të ndryshme rrugore*”, me vlerë kontrate 21,747,214 lekë pa TVSh;
4. Tenderi me objekt: “*Rivitalizim i hapësirave rreth pallatit të sportit Luftëtari*”, me vlerë kontrate 16,732,275 lekë pa TVSh;
5. Tenderi me objekt: “*Sistemim asfaltim rruga Tarininë Zhulat*”, me vlerë kontrate 46,695,844 lekë pa TVSh.
6. Tenderi me objekt: “*Rikonstruksion dhe përmirësimi i efikasitetit energjetic në shpellën “Muhamet Gjollështa”*”

1. Procedura e prokurimit me objekt “*Blerje kontenierësh për mbetjet urbane*” me të dhënave si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ <i>Blerje kontenierësh për mbetjet urbane</i> ”.

1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-98166-03-12-2024_ Urdhri nr. 122, nr. 1867 prot., datë 28.02.2024 1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Hapur e Thjeshtuar”	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 120, nr. 1564 prot., datë 28.02.2024 1.A. A.	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 122 datë 28.02.2024 1.A. L.- Juriste 2.L. S.- Ekonomiste 3.A. A.- Ing Mekanik	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 146, nr.1951 prot., datë 12.03.2024. 1.A. I.- Kryetar 2.K. N.- Anëtar 3.F. M.- Anëtar
5. Fondi Limit pa TVSh 3,998,000 lekë	6. Oferta fituese, vlera fituese pa TVSh: Operatori Fitues: “C.” ShPK me vlerë 3,225,400 lekë	7. Diferenca me fondin limit 772,600 lekë pa TVSh	
8. Data e hapjes së tenderit: Data 25.03.2024	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit.	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 10 OE b) S’kualifikuar 4 B/OE, c) Kualifikuar 6 B/OE	
11. Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka	
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Nr. 4612 prot., datë 30.05.2024	15. Vlera e kontratës me TVSh 3,870,480 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës: 3,870,480 lekë	
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë: 70 ditë	19. Zgjatja e kontratës me - ditë	

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Preventivi

Fondi limit është llogaritur në bazë të urdhrin të Sekretarit të Përgjithshëm, z. N. N. (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë), me nr. 120, nr. 1564 prot., datë 28.02.2024 “Për caktimin e personave përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Kontenierësh për mbetje urbane”, i cili është ngarkuar z. A. A.;

-Nga komisioni i mësipërm, është mbajtur proceverbali nr. s’ka datë 28.02.2024, mbi evidentimin e sasisë, përlllogaritjen e fondit limit, afatin e lëvrimit dhe specifikimet teknike.

-Për përlllogaritjen e fondit limit (çmim për njësi produkti 36,550 lekë/copë koshat metalik 1,100 L dhe 7,000 lekë/copë për koshat metalik 10 L) është bërë mesatarizimi i 3 ofertave nga 3 subjekte.

Nga auditimi i veprimtarisë së komisionit të mësipërm konstatohet se:

-Nuk administrohen kërkesat/informimi drejtuar subjekteve për dhënien e ofertave, me qëllim dokumentimin e mënyrës së përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e mësipërme.

-Ofertat nga 3 subjektet e mësipërme, nuk janë evidentuar se cilët subjekte i është drejtuar komisioni i përlllogaritjes së fondit limit si dhe nuk janë protokolluar.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1, shkronjën “ç” në pikën 2 të nenit 2, pikën 1 të nenit 13, pikën 2 në nenin 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Urdhrin nr. 57, datë 12.06.2014 të MFE “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimet me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, z. A. A..

Hartimi i kritereve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 12.03.2024, nga NJP, i ndryshuar.

AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:

Pika 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohen dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet - Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën “b” të në pikën 4 në nenin 55 në VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kritereve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros **brenda** këtij marzhi”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-20%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 15% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr. 1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3, si dhe pikën 8 në rekomandimin e APP nr. 7998 prot., datë 24.12.2021.

Konkluzion.

Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 në nenin 55 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. -Për sa më sipër mbanë përgjegjësi Nj.P, me përbërje si vijon: znj. A. L., znj. L. S. dhe z. A. A..

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm z. N. N. (person i autorizuar i Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër) me nr. 146, nr. 1951 prot., datë 12.03.2024 është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. A. I. (Kryetar), z. F. M. dhe z. K. N. (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 30.04.2024 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 3594, datë 30.04.2024 për vlerësimin e ofertave, Nëpërmjet SPE, KVO me shkresën nr. 3599 prot., datë 30.04.2024 i është drejtuar OE “C.” ShPK të shpallur fitues për dorëzimin e dokumentacionit provues të formularit shtojca 8.

Me shkresën nr. 3680 prot., datë 03.05.2024 nga OE shpallur fitues është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Gjirokastër. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 3772 prot., datë 08.05.2024 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 10 OE, përkatësisht:

- 1.OE “C.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 3,225,400 lekë pa TVSh.
- 2.OE “Z.” PF, me ofertë ekonomike në shumën prej 3,295,650 lekë pa TVSh.
- 3.OE “B.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 3,577,530 lekë pa TVSh.
- 4.OE “A.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 3,689,100 lekë pa TVSh.
- 5.OE “S” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 3,689,100 lekë pa TVSh.
- 6.OE “L.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 3,842,000 lekë pa TVSh.
- 7.OE “G.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 3,398,900 lekë pa TVSh.
- 8.OE “H.” PF, me ofertë ekonomike në shumën prej 3,709,500 lekë pa TVSh.
- 9.OE “S.” ShKP, me ofertë ekonomike në shumën prej 3,792,000 lekë pa TVSh.
- 10.OE “B.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 3,842,000 lekë pa TVSh.

-Nga OE të mësipërm, janë s'kualifikuar 4 OE/BOE si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	OE C. ShPK	3,225,400 lekë	Kualifikuar
2	OE Z. PF	3,295,650 lekë	Kualifikuar

3	B. ShKP	3,577,530 lekë	Kualifikuar
4	OE A. ShPK	3,689,100 lekë	Kualifikuar
5	OE S ShPK	3,692,000 lekë	Kualifikuar
6	OE L. SHPK	3,842,000 lekë	Kualifikuar
7	OE G. ShPK	3,398,900 lekë	S'kualifikuar Nuk plotësoni kriterin 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, pasi shuma e zërave të ngjashëm me objektin e prokurimit është < 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.
8	OE H. X. PF	3,709,500 lekë	S'kualifikuar NUK PLOTËSONI KRITERIN 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit, PASI KY DOKUMENT MUNGON
9	OE S. ShPK	3,792,000 lekë	S'kualifikuar NUK PLOTËSONI KRITERIN 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, pasi kontrata e ngjashme nr. 3789 prot., datë 22.05.2019 e ngarkuar në SPE nuk është e gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës 25.03.2024
10	OE B. C. ShPK	3,822,500 lekë	S'kualifikuar Preventivi i ofruar ka gabime aritmetikore $\geq 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, $(2\% * 3\,822,500 = 76,450)$ mbështetur në nenin 82 pika 3 e vkm 285/2021 duhet: $(49 * 250 = 12,250)$ është: $(49 * 250 = 122,500)$ 10.diferenca: $122,500 - 12,250 = 110,2$

Nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës me nr. 4125 prot., datë 16.05.2024, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE "C." ShPK, me ofertën ekonomike me vlerë 3,225,400 lekë pa TVSh, me diferencë nga fondi limit në vlerën 772,600 lekë/19% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

-S'kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht¹⁶, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nuk është plotësuar pika 2.2.1, pasi OE nuk ka dorëzuar xhiro vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022 të kërkuar në DST.

Konkluzion.

OE "C." Shpk, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", KVO duhet të kishte vazhduar me OE të rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. A. L., Kryetar, z. K. N. dhe z. F. M., Anëtar.

2. Tenderi me objekt: "Blerje mjeti skrep", me këto të dhëna:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje mjeti skrep".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF- 18922-09-12-24 Urdhri nr. 658, nr. 7734 prot., datë 04.09.2024	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 637, nr. 7709 prot., datë 04.09.2024 1.A. A.	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 658 datë 04.09.2024 1.A. L.- Juriste 2.L. S.- Ekonomiste 3.A. A.- Ing. Mekanik	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 680 prot., datë 12.09.2024. 1.A. I.- Kryetar 2.K. N.- Anëtar 3.F. M. -Anëtar

¹⁶ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e Thjeshtuar”		
5. Fondi Limit pa TVSh 5,000,000 lekë	6. Oferta fituese, vlera fituese pa TVSh: Operatori Fitues: “A.” PF me vlerë 4,150,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit 850 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data 23.09.2024	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit.	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 5 OE b) S’kualifikuar 0 B/OE, c) Kualifikuar 5 B/OE
11. Ankimime AK-s’ka/ka; APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 10969 datë 04.12.2024	15. Vlera e kontratës me TVSh 4,980,000 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës: 4,980,000 lekë
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë: 40 ditë	19. Zgjatja e kontratës me - ditë

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Preventivi

Me urdhrin nr. 294 datë 18.04.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm z. N. N. (person i autorizuar i Kryetarit të Bashkisë), është caktuar grupi i punës për “Për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë nga z. A. A., Kryetar.

Vlera e fondit limit është bërë bazuar testimit të tregut duke marrë tre oferta nga tre operatorë të ndryshëm.

Pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit u llogarit dhe fondit limit i cili rezulton të jetë 5,000,000 lekë pa TVSh.

Nga auditimi i veprimtarisë së komisionit të mësipërm konstatohet se:

-Nuk administrohen kërkesat/informimi drejtuar subjekteve për dhënien e ofertave, me qëllim dokumentimin e mënyrës së përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit për procedurën e mësipërme.

-Ofertat nga 3 subjektet e mësipërme, nuk janë evidentuar se cilët subjekte i është drejtuar komisioni i përllogaritjes së fondit limit si dhe nuk janë protokolluar.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1, shkronjën “ç” në pikën 2 të nenit 2, pikën 1 të nenit 13, pikën 2 në nenin 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Urdhrin nr. 57, datë 12.06.2014 të MFE “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimet me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, z. A. A..

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr. s’ka, datë 12.09.2024, nga NJP.

Nga auditimi i kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të vendosura për mjetin skrep, u konstatua se:

Në pikën 2.1 përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale - Nuk është kërkuar që OE, i cili do të marrë pjesë në procedurën e prokurimit të jetë i pajisur me licencën të kategorisë VII.3.B me titull “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, nënkategoria VII.3.B.1, kjo për të garantuar që OE ushtron aktivitet në përputhje me kuadrin

rregullator, si dhe për të përmbushur deklaratën e garancisë, pra riparimin e defekteve brenda afatit 6- mujor¹⁷.

Sa i përket specifikimeve teknike, konstatohet se:

- Nuk është përcaktuar norma e shkarkimit (norma euro) në ajër të ndotësve të gaztë, si të monoksidit të karbonit (CO), oksideve të azotit të shprehura si ekuivalent i dyoksidit të azotit (NO₂) dhe hidrokarbureve në total (THC), përfshirë lëndë të ngurta pezull (PM).
- Nuk është përcaktuar kutia e ndërrimit të marsheve, manual, automatik apo i kombinuar, si dhe niveli i ndërrimit të marsheve.
- Nuk është përcaktuar nëse do jet me goma apo me zinxhir.
- Nuk është përcaktuar lartësia e shkarkimit.
- Nuk është përcaktuar forca gërmuese e kovës.
- Nuk janë kërkuar foto të skrepit me qëllim verifikimin e tij nga KVO për gërvishtje, plasaritje etj.

Konkluzion.

Sa më sipër, konstatohet se kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike nuk mbrojnë plotësisht interesat e AK, si dhe nuk garantojnë plotësisht cilësinë e mallit të prokuruar.

Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 të nenit 3, shkronjën “a” të pikës 3 në nenin 36, pikën 1 të nenit 37, pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pikën 2 të nenit 40, pikat 1 dhe 2 të nenit 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. A. L., znj. L. S. dhe z. A. A.

Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 680, nr. 7949 prot., datë 12.09.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm z. N. N. (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 219, nr. 3980 prot., datë 19.04.2021) është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. A. L., Kryetar, z. K. N. dhe z. F. M. Anëtar.

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s’ka, datë 05.11.2024 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 10169 prot., datë 05.11.2024 për vlerësimin e ofertave. Nëpërmjet kërkesës në SPE, nr. 10175 prot., datë 05.11.2024, KVO i është drejtuar OE “A.” për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 10420 prot., datë 13.11.2024 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 5 OE, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

- 1.OE “A.” me ofertë ekonomike 4,150,000 lekë pa TVSh.
- 2.OE “A.” ShPK me ofertë ekonomike 4,398,500 lekë pa TVSh.
- 3.OE “C.” ShPK me ofertë ekonomike 4,500,000 lekë pa TVSh.
- 4.OE “T.” ShPK me ofertë ekonomike 4,900,000 lekë pa TVSh.
- 5.OE “Z.” ShPK me ofertë ekonomike 4,476,000 lekë pa TVSh.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë kualifikuar 5 OE/BOE, si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	A. PF	4,150,000 lekë	Kualifikuar
2	A. ShPK	4,398,500 lekë	Kualifikuar
3	C. ShPK	4,500,000 lekë	Kualifikuar
4	T. ShPK	4,900,000 lekë	Kualifikuar
5	Z. ShPK	4,476,000 lekë	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës nr. 10644 prot., datë 21.11.2024, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

¹⁷ Këtu OE për të përmbushur deklaratën e garancisë, mund të paguaj një servis të licencuar për të kryer riparimet e nevojshme në rast se krijohet nevoja, por në këtë rast duhet të që servisi të deklarohet se merr përsipër dhe për llogari të OE, kryerjen e riparimeve brenda afatit 6-mujor.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE “A.”, me ofertën ekonomike me vlerë 4,150,000 lekë pa TVSh, me diferencë nga fondi limit në vlerën 850,000 lekë/17% më pak. Në përfundim, mbi bazën e Raportit Përmbledhës, Titullari i AK, ka shpallur fituese ofertën e OE A. për të cilën është lidhur kontrata me nr. 10969 prot., datë 04.12.2024, me afat 40 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

-OE “A.” Shpk duhej të ishte s’kualifikuar nga KVO pasi nuk ka licencë të kategorisë VII.3.B me titull “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.

-OE C. duhej të ishte s’kualifikuar nga KVO pasi nuk plotëson kriterin 2.1.1 për xhiron vjetore për vitin 2020, 2021, 2022 të kërkuar në DST.

-OE T. duhej të ishte s’kualifikuar nga KVO pasi nuk ka licencë të kategorisë VII.3.B me titull “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.

-OE Z. duhej të ishte s’kualifikuar nga KVO pasi nuk ka licencë të kategorisë VII.3.B me titull “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht¹⁸, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

-OE A., i shpallur fitues, nuk ka paraqitur dhe nuk ka licencë të vlefshme të kategorisë VII.3.B.2 “Licencë për blerje, shitjen e mjeteve me motor dhe rimorkio”.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. A. L., Kryetar, z. K. N. dhe z. F. M., Anëtar.

Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara.

-Me urdhrin nr. 925, nr. 11069 prot., datë 05.12.2024 të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mjetit Skrep, me përbërje si vijon: z. B. G., Kryetar, z. E. D., z. P. Q., Anëtar.

-Për marrjen në dorëzim të mjetit dhe verifikimin e tij, nga komisioni i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbali nr. 221, datë 12.12.2024.

-Kontrata e lidhur ndërmjet palëve nr. 10969 prot., datë 04.12.2024, me afat lëvrimi të mallit 40 ditë nga lidhja e kontratës, pra deri më datë 13.01.2025.

-Fatura tatimore e lëshuar nga OE A., është me nr. 221/2024, datë 12.12.2024 me vlerën 4,980,000 lekë me TVSh;

-Urdhër shpenzimi nr. 1088, datë 30.12.2024.

-Në procesverbal është pasqyruar se mjeti Skrep është sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

3. Tenderi me objekt: “Rehabilitim në segmente të ndryshme rrugore”, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim në segmente të ndryshme rrugore”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-28119-11-05-24 Urdhri nr. 561, nr. 6778 prot., datë 29.07.2024	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Sektori i Projekteve me ing. A. Ç., ing. F. M. dhe ark. E. X.	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 561 datë 29.07.24 A. L.- Juriste L. S.- Ekonomiste F. M.- Ing. Ndërtimi	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 665, nr.7744 prot., datë 04.09.2024. 1.A. I.- Kryetar 2.K. N.- Anëtar 3.E. S.- Anëtar
1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për Propozim”			

¹⁸ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

5. Fondi Limit pa TVSh 28,753,496 lekë	6. Oferta fituese, vlera fituese pa TVSh: Operatori Fitues: “E.” & “I.” ShPK me vlerë 21,747,214 lekë	7. Diferenca me fondin limit 7,006,282 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data 26.11.2024	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit.	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 6 OE b) S’kualifikuar 3 B/OE, c) Kualifikuar 3 B/OE
11. Ankimime AK-s’ka/ka; APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1832 prot., datë 25.02.2025	15. Vlera e kontratës me TVSh 26,096,656 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës: 0 lekë
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë: 6 Muaj	19. Zgjatja e kontratës me - ditë

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Preventivi

Projekti teknik i zbatimit, preventivi dhe i gjithë dokumentacioni teknik i projektit i objektit është hartuar nga Sektori i Projekteve me Ing. A. Ç., ing. F. M. dhe ark. E. X..

Fondi limit është përlloritur në vlerën 28,753,496 lekë pa TVSH. Kodet për zërat e punëve janë marrë referuar VKM-së nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i ndryshuar, dhe në zbatim të VKM-së nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të ndërtimit” ëshërë miratuar preventivi nga sistemi i integruar “SIM” pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Fondi i veçantë i parashikuar në preventiv është parashikuar në preventiv, në zbatim të aneksit VI, të VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Për sa trajtuar më sipër preventivi është hartuar nga Ing. A. Ç., ing. F. M. dhe ark. E. X., konfirmuar nga z. F. G. Kryetar i Bashkisë Gjirokastër.

Sa më sipër, nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, rezulton se disa Inxhinier pjesë e grupit të punës për hartimin e projekt të zbatimit, **nuk janë pajisur me licencën e projektimit**. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, sipas të cilit “Objektet e përkufizuara në nenin 3 ë këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të **pajisur me licencën përkatëse**. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit”. Përsa më sipër, **ngarkohet me përgjegjësi Titullar i Autoriteti Kontraktor Bashkia Gjirokastër F. G.**

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, **nuk** rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një **oponencë teknike**, në lidhje me procedurën e sipërcituar, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik.

Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezulton të jetë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998”, sipas të cilit: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik”.

Në kuptim të ligjit nr. **107/2014** “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, referuar nenit **52**, germa “gj”, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponente teknike, përbën kundërvajtje administrative.

Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponente teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. **8402**, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe VKM-në nr. **9**, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponentës teknike sipas së secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”, **ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. F. G..**

Hartimi i kritereve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 04.11.2024, nga NJP.

Pika 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria e Klasifikimi, Emërtimi i kategorisë

- NP.1 A Punime gërmimi në tokë;
- NP.4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
- N.S.18 A Punime topogjeodezike.

-Në procesverbal nuk argumentohet dhe të pasqyrohet lloji i punimeve që do të kryhet me llojin e licencës dhe kategorinë e saj të kërkuar.

Pika 2.3.8 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit dhe menaxhimit të energjisë. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

-ISO 9001:2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, e vlefshme, ose ekuivalente;

-OHSAS 45001:2018 mbi “Për Sistemin e menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, e vlefshme, ose ekuivalente;

-ISO 14001:2015 mbi “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, e vlefshme, ose ekuivalente;

-BS ISO 39001:2012 mbi “Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor.”, e vlefshme, ose ekuivalente.

-Kërkesa për këtë certifikatë nuk argumentohet nga AK. Sqarojmë se **ISO 14001:2015** specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. Në rastin në fjalë projekti si fillim i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij. Gjithashtu menaxhimi mjedisor (përsëmbull mbrojtja e mjedisit nga zhurmat e mjeteve të cilat do të punojnë në segmentin rrugor) që duhet të sigurojë subjekti gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, është detyrim ligjor¹⁹ që duhet të respektohet nga subjekti nëpërmjet marrjes së masave paraprake, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet disponimit të certifikatës së sipërpërmendur. Pra që të përcaktosh kritere të tilla duhet një bazë ligjore, si dhe të jepen arsye/argumentim konkrete për përcaktimin/nevojën e tyre, që në këtë rast nuk është dhënë, si dhe duhet të jenë përputhje me zërat e punimeve që do të realizojë OE.²⁰ Për më tepër referuar procesverbalit të mbajtur nga NJP, për vendosjen e kërkesës për certifikatat ISO, pasqyrohet argumenti se janë vendosur për cilësinë e mallit. Për këtë argument, sqarojmë se referuar përcaktimit të bërë në shkronjën “c” të pikës 1 dhe shkronjën “dh” në pikën 9 në Kreun III të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, cilësia e mallit vërtetohet nëpërmjet dokumenteve (certifikatë analizat e mallit) që dorëzohen gjatë zbatimit të punimeve, ku plotësohet dosja e kantierit dhe kontrollohen nga përgjegjësi/drejtuesi teknik i kantierit.

¹⁹ Neni 4 në Ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar.

²⁰ Pika 2 në nenin 78 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe njoftimin nr. 3341/1 datë 20.03.2018 të APP për AK.

Pika 2.3.9. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) Punonjës i pajisur me certifikatë trajnimi për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” i dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.
- 1 (një) Punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjithë punonjësit e kërkuar duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024.

-Sa më sipër sqarojmë se në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjësit e mësipërm. Gjithashtu kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM-në nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

Pika 2.3.10. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
2	Kamioncinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
3	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Fadromë me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Autobetoniere	Copë	4	Në pronësi ose me qira
6	Rul ngjeshës	Copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Betonier kantieri	Copë	3	Në pronësi ose me qira
8	Motogenerator	Copë	1	Në pronësi ose me qira
9	GPS aparat topogjeodezik	Copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Depozite uji minimumi 12.000 litra	Copë	2	Në pronësi ose me qira
11	Konteniër – Zyre lëvizëse	Copë	1	Në pronësi ose me qira

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

-Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk argumentohet numri i mjeteve dhe makinerive, por është bërë vetëm argumentimi i domosdoshmërisë (*pra nevojitet kamion vetëshkarkues minimumi 20 ton, (2 copë) dhe kamion me kapacitet mbajtës 5-10 ton, (2 copë) pasi kemi materiale ndërtimi për t’u transportuar, apo eskavator (1 copë) dhe fadromë (1 copë) pasi kemi punime gërmimi*) së llojit të mjeteve në përputhje me zërat e preventivit. Gjithashtu nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të mjeteve të nevojshëm për zbatimin e projektit. Pra nuk është bërë një përcaktim konkret dhe me analizë teknike, cilat do të jenë materialet që do të transportohen me kamionin vetëshkarkues, sa është pesha totale e materialeve, sa peshë mund të transportojë kamioni në një rrugë, sa rrugë në ditë mund të bëjë, dhe në bazë të kësaj përcaktohet sa pesha mund të transportojë kamioni në një ditë pune (8 orë) dhe me pas në 1056 orë pune gjithsej (6 muaj), për të arritur në përcaktimin e numrit të kamionave.

-Në vijim të pikës së mësipërme është kërkuar rul ngjeshës, ndërkohë nuk kërkohet rimorkiatori për transportin e tij, pasi përfshihen në kategorinë e mjeteve të cilat nuk mund të qarkullojnë²¹.

Pika 2.3.12. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga QKL “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve urbane), së bashku me aktin e miratimit nr. 5.

-Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.B specifikohen në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme. Kriteri për

²¹ Pika 2 në nenin 173 në Kodin Rrugor.

disponimin e licencës me kodet e sipërcituara, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomikë të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, do të penalizoheshin vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferimi mbetjesh. Nga ana e AK përcaktohet vendi i hedhjeve të mbetjeve. Subjektet që kryejnë aktivitet, klasifikohen në operator që gjeneron mbetje urbane në njësinë administrative ku zhvillojnë aktivitet. OE që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, hapja e NIPT-it sekondar (për OE që nuk kanë seli në njësinë administrative), nënkupton që subjekti paguan taksat dhe tarifatat vendore (si taksë pastrami, gjelbërimi, tabelë etj., sipas ligjit dhe VKB-së përkatës).

Referuar VKM-së nr. 538, datë 26.05.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, në aneksin 1, Kategoria III, Licencimi i veprimtarive të nënkategorive të nënkategorisë III.2.B, në pikën 9. Çdo operator/familje/individ që gjeneron mbetje urbane është i detyruar të depozitojë në pikat e grumbullimit/kontenier dhe jo t’i trajtojë këto mbetje. Referuar objektit të prokuruar, transporti i materialeve gjatë realizimit të punimeve, mjeteve u nevojitet vetëm: lejen e qarkullimit, certifikatat e pronësisë, siguracionin, kolaudimin, **certifikatë transporti**.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. A. L., znj. L. S., dhe z. F. M..

Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhër nr. 665, nr. 7744 prot., datë 04.09.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Gjirokastrë (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr. 219, nr. 3980 prot., datë 19.04.2021), është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. A. L. (Kryetar), z. K. N. dhe z. E. S., (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 31.12.2024 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 11955 prot., datë 31.12.2024 për vlerësimin e ofertave. Nëpërmjet kërkesës në SPE, nr. 11956 prot., datë 31.12.2024, KVO i është drejtuar OE “N.” ShPK për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 325 prot., datë 13.01.2025 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij, ku janë konstatuar disa mangësi në dorëzimin e dokumentacionit nga OE, dhe është bërë s’kualifikimi i këtij OE.

-Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s’ka, datë 14.01.2025 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 442 prot., datë 15.01.2025 për vlerësimin e ofertave. Nëpërmjet kërkesës në SPE, nr. 443 prot., datë 15.01.2025, KVO i është drejtuar BOE C. & T. Shpk për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 907 prot., datë 29.01.2025 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij, ku janë konstatuar disa mangësi në dorëzimin e dokumentacionit nga OE, dhe është bërë s’kualifikimi i këtij OE.

-Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s’ka, datë 29.01.2025 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 929 prot., datë 29.01.2025 për vlerësimin e ofertave. Nëpërmjet kërkesës në SPE, nr. 930 prot., datë 29.01.2025, KVO i është drejtuar BOE “E. & I.” ShPK për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 1273 prot., datë 06.02.2025 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 6 OE, përkatësisht:

1. BOE “E. & I.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 21,747,214 lekë pa TVSh.
2. OE “L.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 23,773,007 lekë pa TVSh.
3. OE “E.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 28,704,040 lekë pa TVSh.
4. OE “R.” & “D.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 19,471,532 lekë pa TVSh.
5. OE “N.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 19,858,966 lekë pa TVSh.
6. BOE “T.” & “C.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 20,869,345 lekë pa TVSh.

-Nga BOE/ OE të mësipërm, janë s’kualifikuar 3 OE/BOE, si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
----	--------------------	---------------------	---------------------------

1	BOE E. & I. ShPK	21,747,214 lekë	Kualifikuar
2	OE L. ShPK	23,773,007 lekë	Kualifikuar
3	OE E. ShPK	28,704,040 lekë	Kualifikuar
4	BOE R.. ShPK	19,471,532 lekë	<p>S'kualifikuar OE RSM nuk plotëson kriterin 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021-2022-2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Pasi për Vitin 2023 Bilanci financiar është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c" i dhe ii, të ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar</p> <p>OE RSM nuk plotëson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik: <i>Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten:</i> Kontratë sipërmarrjeje: 1. Situacionin përfundimtar; 2. Akt kolaudimi; 3. Fatura tatimore për situacionin përfundimtar 4. Certifikatë e marrjes në dorëzim e përkohshme ose përfundimtare Pasi mungon -Akt Kolaudimi.</p>
5	OE N. ShPK	19,858,966 lekë	<p>S'kualifikuar Në vijim të procedurës, bazuar në nenin 26 të VKM-së 285/2021 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ju dërgua OE i shpallur në vend të parë OE "N." ShPK shkresa me nr.169, prot., datë 09.01.2025 për dokumentet provuese sipas shtojcës 8 të SDT dhe dokumentet shoqëruese të ofertës të tenderit, në rrugë elektronike dhe u kthye pergjigjia me shkresën nr. 169 prot., datë 09.01.2025. Më pas KVO-ja në mbështetje të nenit 2 pika 2 germa "j" të VKM-së nr. 285/2021 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, verifikoi dokumentet në formë shkresore me shkresën nr. 325 prot., datë 13.01.2025, nga ku rezultoi se dokumentacioni është jo i plotë dhe i rregullt dhe sikurse është pasqyruar dhe deklaruar në SPE nga subjekti fitues, mungesat janë si më poshtë: 1.Mungon dokumentacioni provues për Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 ton, AA..G, KOD00115024ËMAT46ZZZ1M319016 REP 3506 KOL 1512 29/02/2024- 28/02/2029 2.Mungon dokumentacioni provues për Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton, AB...KV, KOF01708423ËDB6581471K046031 REP 1330 KOL 604 17/06/2024- 17/06/2029 3. Z. M. M. me profesion Betonues dhe i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Betonues, nuk figuron në listëpagesat për muajin Gusht -Shtator 2024, sipas kërkesave të DST-së. 4.Pergjegjes teknik i Kantierit Adrian Kalamishi nuk figuron në licencën e shoqërisë 5.Për mjetin me targë AA..FY mungojnë taksat vjetore. <i>Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me vota unanime në bazë të kriterit të vlerësimit të përzgjedhur "çmimi me i ulët i ofertave të kualifikuara"</i></p>
6	OE T. & C. ShPK	20,869,345 lekë	<p>S'kualifikuar Në vijim të procedurës, bazuar në nenin 26 të VKM-së nr. 285/2021 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ju dërgua OE i shpallur në vend të parë BOE T. ShPK 49% me NIPT K...L & C. ShPK 51 % me NIPT J.....K me vlerë të ofertës 20,869,345 lekë (njëzet milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSh shkresa me nr. 443, prot., datë 15.01.2025 për dokumentet provuese sipas shtojcës 8 të DST dhe dokumentet shoqëruese të ofertës të tenderit, në rrugë elektronike dhe u kthye pergjigjia me shkresën nr. 577 prot., datë 22.01.2025. Më pas KVO-ja në mbështetje të nenit 2 pika 2 germa "j" të VKM-së nr. 285/2021 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, verifikoi dokumentet në formë shkresore me shkresën nr. 325 prot., datë 13.01.2025, nga ku rezultoi se dokumentacioni është jo i plotë dhe i rregullt dhe sikurse është pasqyruar dhe deklaruar në SPE nga subjekti fitues, mungesat janë si më poshtë: 1.Nuk plotëson kriterin 2.7 Operatori ekonomik duhet të këtë pjesë të stafit: -Shofer 8 -Për punonjësit e mësipërm të paraqiten dëshmi aftësie profesionale, leje drejtimi për shoferët si dhe kontratë pune e vlefshme ose të figurojnë në listëpagesat e muajit Korrik 2024- Shtator 2024 kjo në varësi të mjeteve që disponojnë në pronësi ose me qira. -Pasi në dokumentacionin e dorëzuar rezultojnë 6 shoferë me dokumente të sakta -Personat e mëposhtëm të vetëdeklaruar në Shtojcën 8 kanë mungesa si më poshtë: -E. F. B. mungon kontratë pune, nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë muajit Korrik 2024- Shtator 2024 -E. L. mungon kontratë pune, nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë muajit Korrik 2024- Shtator 2024 -K. K. mungon leja e drejtimit.</p>

		<p>-E. T. mungon leja e drejtimit</p> <p>-Mungon taksat vjetore për vitin 2024 për Fadromë me goma targa AA...JL</p> <p>-Mungon dokumentacioni provues për Kontenier zyre lëvizëse</p> <p>-Mungojnë taksat vjetore për mjetet me targë SR...B; SR...B dhe AA..BG, gjithashtu mjeti me targë SR...B mungon certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit</p> <p>-Mjeti me targë AA..YX dhe AB...DN deklaruar kamionçinë 5-10 ton, rezulton Kamion me vinc, dhe kanë mungesa të taksave vjetore dhe certifikatën e kontrollit teknik AA..YX.</p> <p>-Nuk plotësohet kriteri i DST: Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.</p> <p>-Punonjësi X. T. i vetëdeklaruar hekurkthyes mungon në listëpagesat e shoqërisë muajit Korrik 2024- Shtator 2024.</p> <p>-Nuk plotëson kriterin 2.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Korrik 2024- Shtator 2024 pasi:</p> <p>-P. R. deklaruar në Shtojcën 8 betonist nuk figuron në listëpagesat për muajin Gusht 2024.</p> <p>-Gjithashtu R. M. hekurkthyes nuk figuron në listëpagesat për muajin Gusht 2024.</p> <p><i>Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me vota unanime në bazë të kriterit të vlerësimit të përzgjedhur “çmimi më i ulët i ofertave të kualifikuara”</i></p>
--	--	---

Nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës me nr. 1554 datë 14.02.2025, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues BOE “E.” & “I.” ShPK, me ofertën ekonomike me vlerë 21,747,214 lekë pa TVSh, me diferencë nga fondi limit në vlerën 7,006,282 lekë/24 % më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht²², nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

1. Nuk plotësohet pika 2.3.6, pasi në DT janë kërkuar që OE duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Korrik 2024 – Shtator 2024

<i>Teknik ndërtimi</i>	2
<i>Betonist</i>	6
<i>Hekurkthyes</i>	2
<i>Puntorë të thjeshtë</i>	2

2. Në DST janë kërkuar 2 punonjës teknik ndërtimi, ndërkohë OE “E.” ShPK në shtojcën 8 ka deklaruar vetëm një punonjës me profesion teknik ndërtimi, ndërsa OE “I.” ShPK ka deklaruar 1 punonjës, konkretisht znj. T. A. e cila nuk ka dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik.

3. Nuk plotësohet pika 2.3.7, pasi në DST është kërkuar disponimi i 8 shoferëve dhe 3 manovratorëve, ndërkohë OE “E.” ShPK ka deklaruar 6 shoferë dhe 3 manovratorë nga të cilët nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ka rezultuar se:

- z. A. H., i cili është deklaruar si shofer, i ka mbaruar afati i vlefshmërisë së lejes së drejtimit.

-z. D. B., i cili është deklaruar si manovrator, nuk ka dorëzuar dëshmi aftësie për manovrator.

-z. M. M., i cili është deklaruar si manovrator, nuk ka dorëzuar dëshmi aftësie për manovrator.

-Nga OE “I.” ShPK janë deklaruar 2 shoferë dhe 2 manovratorë, por nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për shoferin z. G. G., nuk disponohet kontrata e punës dhe nuk është e dukshme pjesa e vlefshmërisë së Dëshmisë së Aftësisë.

-Për manovratorin z. A. B., nuk disponohet kontrata e punës.

-Për shoferin z. K. Z., nuk disponohet kontrata e punës.

-Për shoferin z. H. I., nuk disponohet kontrata e punës dhe nuk është e dukshme pjesa e vlefshmërisë së Dëshmisë së Aftësisë si dhe nuk figuron në sigurimet e muajit korrik, gusht dhe shtator.

²² Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

4. Nuk është plotësuar pika **2.3.10**, pasi sipas shtojcës 8, për kamionin vetëshkarkues min 20 ton, deklaruar mjeti me targë AA...HY, nuk është dorëzuar certifikata për transportin e mallrave.

-Kamionçinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton, me targë AA...NA, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr. Rep: 2247 Nr. Kol: 1269 me subjektin “G. G.”, por ky subjekt nuk disponon certifikatë për transportin e mallrave për dhënien me qira të mjeteve dhe për të tretë.

-Kamioncinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton, me targë AA...GB, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr. Rep: 4732 Nr. Kol: 1255 me subjektin “A.” ShPK me administrator z. B. Q., por ky subjekt nuk disponon certifikatë për transportin e mallrave për dhënien me qira të mjeteve dhe për të tretë, si dhe e ka tejkalluar peshën e kërkuar, konkretisht rezulton të jetë 12.6 ton.

- Mjeti Eskavator me goma Orestein & Kopel Diesel, nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon certifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Për këtë mjet është paraqitur faturë zhdoganimi nr. 3511, datë 11.04.2013. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”.

Konkluzion.

BOE “E.” & “I.” ShPK, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. A. L., Kryetar, z. K. N. dhe z. E. S., Anëtar.

4. Tenderi me objekt: “Rivitalizim i hapësirave rreth pallatit të sportit Luftëtari”, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rivitalizim i hapësirave rreth pallatit të sportit Luftëtari”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-26408-10-25-2024 Urdhri nr. 749, nr. 8899 prot., datë 08.10.2024	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Drejtoria e Urbanistikës	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 749 datë 08.10.2024 1.A. L.- Juriste 2.L. S.- Ekonomiste 3.F. M.- Ing. Ndërtimi	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 832, nr. 8873 prot., datë 28.10.2024. 1.A. I.- Kryetar 2.K. N.- Anëtar 3.E. S.- Anëtar
1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”			
5. Fondi Limit pa TVSh 18,409,060 lekë	6. Oferta fituese, vlera fituese pa TVSh: Operatori Fitues: “E.” me vlerë 16,732,275 lekë		7. Diferenca me fondin limit 1,676,785 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data 18.11.2024	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit.		10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 4 OE b) S’kualifikuar 3 B/OE, c) Kualifikuar 1 B/OE
11. Ankimime AK-s’ka/ka; APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka		13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës Nr. 667 prot., datë 22.01.2025	15. Vlera e kontratës me TVSh 20,078,730 lekë		16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës: 0 lekë

17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë: 8 muaj	19. Zgjatja e kontratës me - ditë
-----------------------------	---------------------------------------	-----------------------------------

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Preventivi

Projekti teknik i zbatimit, preventivi dhe i gjithë dokumentacioni teknik i projektit i objektit është hartuar nga Sektori i Projekteve me Ing. A. P., Ing. F. M. dhe Ing. G. M..

Fondi limit është përlllogaritur në vlerën 18,409,060 lekë pa TVSh. Kodet për zërat e punëve janë marrë referuar VKM-së nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i ndryshuar, dhe në zbatim të VKM-së nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të ndërtimit”ëshrë miratuar preventivi nga sistemi i integruar “SIM” pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Fondi i veçantë i parashikuar në preventiv është parashikuar në preventiv, në zbatim të aneksit VI, të VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Për sa trajtuar më sipër preventivi është hartuar nga Ing. A. P. dhe Ing. F. M., konfirmuar nga z. F. G. Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë.

Sa më sipër, nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, rezulton se disa Inxhinier pjesë e grupit të punës për hartimin e projekt të zbatimit, **nuk janë pajisur me licencën e projektimit**. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, sipas të cilit “Objektet e përkufizuara në nenin 3 ë këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të **pajisur me licencën përkatëse**. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkuara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit”. Përsa më sipër, **ngarkohet me përgjegjësi Titullar i Autoriteti Kontraktor Bashkia Gjirokastrë F. G.**

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, **nuk** rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një **oponencë teknike**, në lidhje me procedurën e sipërcituar, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik.

Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezulton të jetë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998”, sipas të cilit: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik”.

Në kuptim të ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, referuar nenit 52, germa “**gj**”, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike, përbën kundërvajtje administrative.

Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas së secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”, **ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. F. G.**

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 28.10.2024, nga NJP.

Pika 2.3.4. AK kërkon që OE të ketë licencat N.P-1/A, N.P-2/A, N.P-4/A dhe N.S-6/A – ndërkohë që licenca e kategorisë N.P-2/A sipas përkufizimit të saj përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina

banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurdhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse. Sipas preventivit të punimeve, nuk rezulton të ketë asnjë punim që i përket kategorisë së licencës së kërkuar.

Pika 2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

➤ Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizëm i licencuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit.

➤ Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit, e dhënë nga një organizëm i licencuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit.

-Sa më sipër sqarojmë për **pikën 2.3.9** në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjësin e mësipërm. Gjithashtu kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM-në nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

Pika 2.3.10. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Kamioncinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Eskavator me goma 05 -2 m3	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Betonier	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Rul me vibrim	Copë	1	Në pronësi ose me qira
6	Autobetoniere	Copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Rul ngjeshës me kompresor për shtresat asfaltike	Copë	1	Në pronësi ose me qira
8	Rul me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
9	Makineri sperkatës boje për vijëzime në rrugë	Copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Autobot primer	Copë	1	Në pronësi ose me qira
11	Tokmak	Copë	1	Në pronësi ose me qira
12	Vibrator betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qira
13	Asfalto shtruese	Copë	1	Në pronësi ose me qira
14	Autobitumatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qira
15	Greider	Copë	1	Në pronësi ose me qira
16	Makineri gërryese e shtresave (bobcat)	Copë	1	Në pronësi ose me qira
17	Matrapik	Copë	1	Në pronësi ose me qira
18	Motogjenerator	Copë	1	Në pronësi ose me qira
19	Rimorkio mbi 20 ton për transportin e mjeteve të rënda	Copë	1	Në pronësi ose me qira
20	Kontener – Zyrë lëvizëse	Copë	1	Në pronësi ose me qira
21	Saldatrice elektrike	Copë	1	Në pronësi ose me qira

-Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk argumentohet numri i mjeteve dhe makinerive, por është bërë vetëm argumentimi i domosdoshmërisë (*pra nevojitet kamioni vetëshkarkues pasi kemi materiale ndërtimi për t'u transportuar, apo eskavator pasi kemi punime gërmimi*) së llojit të mjeteve në përputhje me zërat e preventivit. Gjithashtu nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e

numrit të mjeteve të nevojshëm për zbatimin e projektit. Pra nuk është bërë një përcaktim konkret dhe me analizë teknike, cilat do të jenë materialet që do të transportohen me kamionin vetëshkarkues, sa është pesha totale e materialeve, sa peshë mund të transportojë kamioni në një rrugë, sa rrugë në ditë mund të bëjë, dhe në bazë të kësaj përcaktohet sa pesha mund të transportojë kamioni në një ditë pune (8 orë) dhe me pas në 1408 orë pune gjithsej (8 muaj), për të arritur në përcaktimin e numrit të kamionave.

Janë kërkuar 3 rula, por në asnjë rast nuk argumentohet me analizë teknike.

Pika 2.3.11. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht:

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

OHSAS 45001-2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

BS ISO 39001:2012 Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor.

-Kërkesa për këtë certifikatë nuk argumentohet nga AK. Sqarojmë se ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. Në rastin në fjalë projekti si fillim i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij. Gjithashtu menaxhimi mjedisor (përshëmbull mbrojtja e mjedisit nga zhurmat e mjeteve të cilat do të punojnë në segmentin rrugor) që duhet të sigurojë subjekti gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, është detyrim ligjor²³ që duhet të respektohet nga subjekti nëpërmjet marrjes së masave paraprake, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet disponimit të certifikatës së sipërpërmendur. Pra që të përcaktosh kritere të tilla duhet një bazë ligjore, si dhe të jepen arsye/argumentim konkretë për përcaktimin/nevojën e tyre, që në këtë rast nuk është dhënë, si dhe duhet të jenë përputhje me zërat e punimeve që do të realizojë OE.²⁴ Për më tepër referuar procesverbalit të mbajtur nga NJP, për vendosjen e kërkesës për certifikatat ISO, pasqyrohet argumenti se janë vendosur për cilësinë e mallit. Për këtë argument, sqarojmë se referuar përcaktimit të bërë në shkronjën “c” të pikës 1 dhe shkronjën “dh” në pikën 9 në Kreun III të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, cilësia e mallit vërtetohet nëpërmjet dokumenteve (certifikatë analizat e mallit) që dorëzohen gjatë zbatimit të punimeve, ku plotësohet dosja e kantierit dhe kontrollohen nga përgjegjësi/drejtuuesi teknik i kantierit.

Pika 2.3.12. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga QKL “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve urbane), së bashku me aktin e miratimit nr. 5.

-Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.B specifikohen në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme. Kriteri për disponimin e licencës me kodet e sipërcituara, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomikë të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, do të penalizoheshin vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferimi mbetjesh. Nga ana e AK përcaktohet vendi i hedhjeve të mbetjeve. Subjektet që kryejnë aktivitetet, klasifikohen në operator që gjeneron mbetje urbane në njësinë administrative ku zhvillojnë aktivitetet. OE që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, hapja e NIPT-it sekondar (për OE që nuk kanë seli në njësinë administrative), nënkupton që subjekti paguan taksat dhe tarifata vendore (si taksë pastrami, gjelbërimi, tabele etj., sipas ligjit dhe VKB-së përkatës).

Referuar VKM-së nr. 538, datë 26.05.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, në aneksin 1, Kategoria III, Licencimi i veprimtarive të nënkategorive të nënkategorisë III.2.B, në pikën 9. Çdo operator/familje/individ që gjeneron mbetje urbane është i detyruar të depozitojë në

²³ Neni 4 në Ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar.

²⁴ Pika 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe njoftimin nr.3341/1 datë 20.03.2018 të APP për AK.

pikat e grumbullimit/kontenier dhe jo t'i trajtojë këto mbetje. Referuar objektit të prokuruar, transporti i materialeve gjatë realizimit të punimeve, mjeteve u nevojitet vetëm: lejen e qarkullimit, certifikatat e pronësisë, siguracionin, kolaudimin, **certifikatë transporti**.

Konkluzion.

-Sa më sipër, konstatohet se kriteret e veçanta të kualifikimit nuk janë në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 4, shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 6 të nenit 39, pikën 2 në nenin 78 në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. A. L., z. K. N. dhe z. E. S..

Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhër nr. 832, nr. 9873 prot., datë 28.10.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Gjirokastrë (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr. 219, nr. 3980 prot., datë 19.04.2021), është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. A. L. (Kryetar), z. K. N. dhe z. E. S., (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 17.12.2024 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 11444 prot., datë 17.12.2024 për vlerësimin e ofertave. Nëpërmjet kërkesës në SPE, nr. 11445 prot., datë 17.12.2024, KVO i është drejtuar OE “E.” ShPK për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 11706 prot., datë 24.12.2024 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 4 OE/BOE, përkatësisht:

- 1.OE “E.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 16,732,275 lekë pa TVSh.
- 2.BOE “E.” & “I.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 12,298,816 lekë pa TVSh.
- 3.BOE “T.” & “C.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 16,135,061 lekë pa TVSH.
- 4.BOE “R. & D.” ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 12,352,536 lekë pa TVSh.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë kualifikuar 3 OE/BOE, si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	E. ShPK	16,732,275 lekë	Kualifikuar
2	BOE E. & I. ShPK	12,298,816 lekë	S'kualifikuar Nuk plotësoni kriterin 2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: <u>Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten</u> 1. Kontratë sipërmarrjeje; 2. Situacionin përfundimtar; 3. Akt kolaudimi; 4. Fatura tatimore për situacionin përfundimtar Pasi mungon: Akt kolaudimi
3	BOE T. & C. ShPK	16,135,061 lekë	S'kualifikuar -Ofertuesi duhet të paraqesë: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 368.181,2 (treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një presje dy). Sigurimi i ofertës nga OE është në vlerën 36,818 (tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë)
4	BOE R. & D. ShPK	12,352,536 lekë	S'kualifikuar 2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: <u>Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten:</u> 1. Kontratë sipërmarrjeje; 2. Situacionin përfundimtar; 3. Akt kolaudimi; 4. Fatura tatimore për situacionin përfundimtar 5. Certifikatë e marrjes në dorëzim e përkohshme ose përfundimtare Pasi mungon: Fatura tatimore për situacionin përfundimtar për punën e ngjashme të OE “RMS Company” shpk, kontratë nr. 26013/6 prot., datë 12.10.2018.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 25 prot., datë 06.01.2025, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE "E." ShPK, me ofertën ekonomike me vlerë 16,732,275 lekë pa TVSh, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,676,785 lekë/9% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht²⁵, nga BOE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nuk është përmbushur pika 2.3.5, sa i përket kërkesës për 1 inxhinier elektrik i cili duhet të jetë drejtues teknik. OE shpallur fitues ka dorëzuar dokumentacion për z. A. S. me profesion Ing. Elektroteknik.

-Nuk plotësohet kriteri 2.3.6, pasi janë kërkuar 4 punonjës me profesion pllakashtrues, OE shpallur fitues ka deklaruar punonjës in Sumer Singh, të cilit i mungon kontrata e punës dhe është me profesion betonues dhe jo pllakashtrues.

-Për punonjës in S. Y. i deklaruar si pllakashtrues nuk është i deklaruar në sigurimet e muajit qershor.

-Sa i përket mjeteve të transportit/ndërtimit, të deklaruar në shtojcën 8, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, konstatohet se OE nuk plotëson pikën 2.3.10 për:

-Kamioncinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton me targë AB...AJ, rezulton se kapaciteti i mjetit tejkalon peshën e kërkuar, pra e ka tejkaluar kapacitetin e kërkuar në DST, konkretisht është 17.2 ton.

-Mjeti Eskavator me Goma AKMT., nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon certifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "*Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 58 "*Makinat teknologjike*" dhe neni 113 "*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*".

-Mjeti **Greider**, nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon certifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Për këtë mjet është paraqitur fatura tatimore e blerjes nr. 22, datë 30.11.2015. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "*Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 58 "*Makinat teknologjike*" dhe neni 113 "*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*".

-Autobitumatricja me targë AB..AL e marrë me qira nga subjekti M. G., nuk ka certifikatën e miratimit ADR për konformitetin e tij e lëshuar nga një organ inspektues i autorizuar ministri që mbulon sektorin e transportit, ndërkohë që është detyrim ligjor për mbushësin e mallrave të rrezikshme (bitum) për kontrollin e afatit të inspektimit me qëllim që ai mos të ketë kaluar²⁶;

-Nuk administrohet certifikata e kualifikimit për drejtuesin e autobitumatricës²⁷;

-Për drejtimin e autobitumatricës nga OE nuk është dorëzuar dokumentacioni.

-Mjeti Autobot primer me targë AA...BG i marrë me qira nga subjekti E. K., i ka mbaruar vlefshmëria e certifikatës së transportit për mallra me datë 16.08.2024 ndërkohë data e hapjes së tenderit është më datë 18.11.2024.

Konkluzion.

OE "E." ShPK, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", KVO duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit.

²⁵ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

²⁶ Pika 1 në nenin 48 në Ligjin nr. 118/2012 "*Për transportin e mallrave të rrezikshme*".

²⁷ Neni 35 dhe 38 në Ligjin nr. 118/2012 "*Për transportin e mallrave të rrezikshme*".

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. A. L., Kryetar, z. K. N. dhe z. E. S., Anëtar.

5. Tenderi me objekt: “Sistem asfaltim rruga Taroninë Zhulat”, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistem asfaltim rruga Taroninë Zhulat”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-16943-08-24-24 Urdhri nr. 611, nr. 7179 prot., datë 12.08.2024 1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për Propozim”	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Drejtoria e Urbanistikës	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 611 datë 12.08.2024 A. L.- Juriste L. S.- Ekonomiste A. P.- Ing. Ndërtimi	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 622, nr. 7509 prot., datë 27.08.2024. A. I.- Kryetar K. N.- Anëtar F. M.- Anëtar
5. Fondi Limit pa TVSh 72,579,387 lekë	6. Oferta fituese, vlera fituese pa TVSh: Operatori Fitues: “L.” ShPK me vlerë 46,695,844 lekë	7. Diferenca me fondin limit 25,883,543 lekë pa TVSh	
8. Data e hapjes së tenderit: Data 17.09.2024	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit.	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 12 OE b) S’kualifikuar 4 B/OE, c) Kualifikuar 8 B/OE	
11. Ankimime AK-s’ka/ka; APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka	
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës NR. 10408 prot., datë 13.11.2024	15. Vlera e kontratës me TVSh 56,035,013 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës: 0 lekë	
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë: 16 muaj	19. Zgjatja e kontratës me - ditë	

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Preventivi

Projekti teknik i zbatimit, preventivi dhe i gjithë dokumentacioni teknik i projektit i objektit është hartuar nga Sektori i Projekteve me Ing. A. N., Ing. F. M. dhe Ing. A. Q..

Raporti teknik dhe raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis është hartuar nga studio “Z.” me licencë nr. N.../23, me Ing. Y. M..

Fondi limit është përlogaritur në vlerën 72,579,387 lekë pa TVSh. Kodet për zërat e punëve janë marrë referuar VKM-së nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i ndryshuar, dhe në zbatim të VKM-së nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të ndërtimit”ëshër miratuar preventivi nga sistemi i integruar “SIM” pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Fondi i veçantë i parashikuar në preventiv është parashikuar në preventiv, në zbatim të aneksit VI, të VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Për sa trajtuar më sipër preventivi është hartuar nga Ing. A. N. dhe Ing. F. M., konfirmuar nga z. F. G. Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë.

Sa më sipër, nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, rezulton se disa Inxhinier pjesë e grupit të punës për hartimin e projekt të zbatimit, **nuk janë pajisur me licencën e projektimit**. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, sipas të cilit

“Objektet e përkufizuara në nenin 3 ë këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të **pajisur me licencën përkatëse**. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit”. Përsa më sipër, **ngarkohet me përgjegjësi Titullar i Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër F. G.**

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 27.08.2024, i ndryshuar.

Pika 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P – 1 A Punime gërmimi në tokë.

N.P – 4 B Rugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT:

N.S – 6 A Sinjalistika rrugore jondriçuese.

N.S – 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore.

N.S – 18 A Punime topogjeodezike

-AK kërkon disa lloje licencash që duhet të disponojë OE që do të kryejë punimet e ndërtimit, ku një ndër këto është licenca e llojit NS-7 A “Barriera dhe mbrojtje rrugore”, e cila në mënyrë të thjeshtuar përfshin ristrukturimi i elementeve si guard rail, neë jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa. - Sipas preventivit të punimeve nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë këtë kategori licence, pra nuk është argumentuar kërkesa për këtë lloj licence.

Pika 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Gjeodet

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë *për të paktën tre muajt e fundit*.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë kontratë pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV.

-Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për një periudhë 3 mujore, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës - Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjësit e mësipërm. Pra pse duhet të jenë 3 muaj në listëpagesë dhe si ndikon kjo në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale. Gjithashtu sqarojmë se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 5 vite/3 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3/5 vite)²⁸. Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 1-2 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 3 muajsh që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë

²⁸ Shkronja “a” pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

Pika 2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) Punonjës i pajisur me Certifikatë trajnimi për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” i dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj
- 1 (një) Punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

-Sa më sipër sqarojmë për **pikën 2.3.9** në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjësit e mësipërm. Gjithashtu kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

Pika 2.3.10 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike si më poshtë:

Nr.	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qira
2	Kamioncinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
3	Kamion me vinc	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Eskavator me zinxhir 05 -2 m3	Copë	1	Në pronësi ose me qira
6	Rul me vibrim	Copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Fadroma me zinxhir	Copë	1	Në pronësi ose me qira
8	Fadrome me goma	Copë		Në pronësi ose me qira
9	Autobetoniere	Copë	3	Në pronësi ose me qira
10	Rul ngjeshës me kompresor për shtresat asfaltike	Copë	1	Në pronësi ose me qira
11	Rul me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
12	Makineri sperkatës boje për vizime në rrugë	Copë	1	Në pronësi ose me qira
13	Autobot uji	Copë	1	Në pronësi ose me qira
14	Autovinc deri në 5 t	Copë	1	Në pronësi ose me qira
15	Vibrator betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qira
16	Asfalto shtruese	Copë	1	Në pronësi ose me qira
17	Autobitumatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qira
18	Greider	Copë	1	Në pronësi ose me qira
19	Tranxhe për përpunimin e hekurit të ndërtimit	Copë	1	Në pronësi ose me qira
20	Matrapik	Copë	1	Në pronësi ose me qira
21	Motogenerator	Copë	1	Në pronësi ose me qira
22	GPS aparat topogjeodezik	Copë	1	Në pronësi ose me qira
23	Rimorkio mbi 20 ton për transportin e mjeteve të rënda	Copë	1	Në pronësi ose me qira
24	Kontener – Zyrë lëvizëse	Copë	1	Në pronësi ose me qira
25	Saldatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qira

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

Sa më sipër është kërkuar kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minim 20 ton (4 copë), kamioncinë me kapacitet mbajtës 5 - 10 ton (2 copë), kamion me vinc (1 copë), autobetoniere (3 copë), dhe autovinc deri në 5 ton, numër i paargumentuar me analizë teknike, si dhe për cilin qëllim do të përdoret në zbatimin e kontratës.

Janë kërkuar 2 eskavator, por në asnjë rast nuk argumentohet me analizë teknike. Pra sasia e dheut që do të gërmohet në një ditë pune (8 orë) dhe më pas në 2816 orë pune gjithsej (16 muaj), për të arritur në përcaktimin e numrit të eskavatorëve.

Pika 2.3.11 Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të certifikuar sipas standardeve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe konkretisht:

- ISO 9001-2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), *ose ekuivalent*
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent*
- OHSAS 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme), *ose ekuivalent*.
- BS ISO 39001:2012 mbi (Për Sistemin e menaxhimit të sigurisë), e vlefshme, **ose ekuivalente**.

– Kërkesa për këtë certifikatë nuk argumentohet nga AK. Sqarojmë se ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. Në rastin në fjalë projekti si fillim i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij. Gjithashtu menaxhimi mjedisor (përshëmbull mbrojtja e mjedisit nga zhurmat e mjeteve të cilat do të punojnë në segmentin rrugor) që duhet të sigurojë subjekti gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, është detyrim ligjor²⁹ që duhet të respektohet nga subjekti nëpërmjet marrjes së masave paraprake, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet disponimit të certifikatës së sipërpërmendur. Pra që të përcaktosh kritere të tilla duhet një bazë ligjore, si dhe të jepen arsye/argumentim konkrete për përcaktimin/nevojën e tyre, që në këtë rast nuk është dhënë, si dhe duhet të jenë përputhje me zërat e punimeve që do të realizojë OE.³⁰ Për më tepër referuar procesverbalit të mbajtur nga NJP, për vendosjen e kërkesës për certifikatat ISO, pasqyrohet argumenti se janë vendosur për cilësinë e mallit. Për këtë argument, sqarojmë se referuar përcaktimit të bërë në shkronjën “c” të pikës 1 dhe shkronjën “dh” në pikën 9 në Kreun III të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, cilësia e mallit vërtetohet nëpërmjet dokumenteve (certifikatë analizat e mallit) që dorëzohen gjatë zbatimit të punimeve, ku plotësohet dosja e kantierit dhe kontrollohen nga përgjegjësi/drejtuesi teknik i kantierit.

Pika 2.3.12 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga QKL “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve urbane), së bashku me aktin e miratimit nr. 5.

-Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.B specifikohen në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme. Kriteri për disponimin e licencës me kodet e sipërcituara, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomikë të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, do të penalizoheshin vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferimi mbetjesh. Nga ana e AK përcaktohet vendi i hedhjeve të mbetjeve. Subjektet që kryejnë aktivitetet, klasifikohen në operator që gjeneron mbetje urbane në njësinë administrative ku zhvillojnë aktivitetet. OE që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, hapja e NIPT-it sekondare (për OE që nuk kanë seli në njësinë administrative), nënkupton që subjekti paguan taksat dhe tarifat vendore (si taksë pastrami, gjelbërimi, tabele etj., sipas ligjit dhe VKB-së përkatës).

Referuar VKM-së nr. 538, datë 26.05.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, në aneksin 1, Kategoria III, Licencimi i veprimtarive të nënkategorive të nënkategorisë III.2.B, në pikën 9. Çdo operator/familje/individ që gjeneron mbetje urbane është i detyruar të depozitojë në pikat e grumbullimit/kontenier dhe jo t’i trajtojë këto mbetje. Referuar objektit të prokuruar, transporti i materialeve gjatë realizimit të punimeve, mjeteve u nevojitet vetëm: lejen e qarkullimit, certifikatat e pronësisë, siguracionin, kolaudimin, **certifikatë transporti**.

Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhër nr. 622, nr. 7509 prot., datë 27.08.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Gjirokastrë (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr. 219, nr. 3980 prot., datë 19.04.2021), është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. A. L. (Kryetar), z. K. N. dhe z. F. M.,

²⁹ Neni 4 në Ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar.

³⁰ Pika 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe njoftimin nr.3341/1 datë 20.03.2018 të APP për AK.

(Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 08.10.2024 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 8909 prot., datë 08.10.2024 për vlerësimin e ofertave. Nëpërmjet kërkesës në SPE, nr. 8910 prot., datë 08.10.2024, KVO i është drejtuar OE "L." ShPK për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 9458 prot., datë 21.10.2024 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 12 OE/BOE, përkatësisht:

1. OE "L." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 46,695,844 lekë pa TVSh.
2. OE "L." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 59,765,423 lekë pa TVSh.
3. BOE "S." & "J." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 63,275,810 lekë pa TVSh.
4. BOE "E." & "A." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 47,185,978 lekë pa TVSh.
5. OE "C." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 54,609,074 lekë pa TVSh.
6. BOE "C." & "K." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 46,741,585 lekë pa TVSh.
7. OE "B." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 60,000,105 lekë pa TVSH.
8. BOE "L." & "V." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 54,389,439lekë pa TVSh.
9. BOE "E." & "B." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 46,933,747 lekë pa TVSh.
10. BOE "D." & "R." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 47,984,465lekë pa TVSh.
11. OE "N." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 53,138,747 lekë pa TVSh.
12. BOE "F." & "S." ShPK, me ofertë ekonomike në shumën prej 56,750,445 lekë pa TVSh.

-Nga OE/ BOE të mësipërm, janë s'kualifikuar 4 OE/BOE, si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	OE L. shpk	46,695,844 lekë	Kualifikuar
2	OE L. shpk	59,765,423 lekë	Kualifikuar
3	BOE S. shpk & J. shpk	63,275,810 lekë	Kualifikuar
4	BOE E. shpk & A. shpk	47,185,978 lekë	Kualifikuar
5	OE C.	54,609,074 lekë	Kualifikuar
6	BOE C. & K. shpk	46,741,585 lekë	Kualifikuar
7	OE B. shpk	60,000,105 lekë	Kualifikuar
8	BOE L. & V. shpk	54,389,439 lekë	Kualifikuar
9	BOE E. & B. shpk	46,933,747 lekë	<p>S'kualifikuar</p> <p>Nuk plotësoni kriterin 2.17 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi impiantet si më poshtë vijon : c. 1 (një) Fabrikë Asfaltobetoni Për impiantin e prodhimit të inerteve/ betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj. (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/ betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ky kriter nuk është pjesë e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të shtojcës 8, mbështetur në nenin 26 të VKM-së 285/2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe kriterëve të DST-së të AK. (deklaruar nga OE B. shpk)
10	BOE D. & R. shpk	47,984,465 lekë	<p>S'kualifikuar</p> <p>Nuk plotësoni kriterin: Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes). 2.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht: <i>Pasi OE D. SHPK nuk disponon - BS ISO 39001:2012</i> Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor. Nuk plotësoni kriterin: 1 (një) Punonjës i pajisur me certifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë Nuk plotëson kriterin : 2.17 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi impiantet si më poshtë vijon : c. 1 (një) Fabrikë Asfaltobetoni Për impiantin e prodhimit të inerteve/ betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj. (Akt-</p>

			Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/ betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit <ul style="list-style-type: none"> • Ky kriter nuk është pjesë e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të shtojcës 8, mbështetur në nenin 26 të VKM-së 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe kritereve të DST-së të AK. (deklaruar nga OE R.shpk)
11	OE N. shpk	53,138,747 lekë	S’kualifikuar Nuk plotësoni kriterin 2.17 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi impiantet si më poshtë vijon : <ol style="list-style-type: none"> 1 (një) Impiant prodhimi Inerte 1 (një) Impiant prodhimi Betoni 1 (një) Fabrikë Asfaltbetoni Për impiantin e prodhimit të inerteve/ betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj. (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/ betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit. <ul style="list-style-type: none"> • Ky kriter nuk është pjesë e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të shtojcës 8, mbështetur në nenin 26 të VKM-së 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe kritereve të DST-së të AK.
12	BOE F. & S. shpk	56,750,445 lekë	S’kualifikuar Preventivi i ofruar ka gabime në sasinë e zërit: [9/3210/ Shtresë cakelli mbeturinë kave t=15cm përhapur e ngjeshur me makineri] / sasia 13 611 m ² /, ju keni ofruar për sasinë 1361 m ² /, si pasojë kemi ndryshim të vlerës së ofertës me 5,046,999 lekë vlerë kjo më e madhe se 2% e ofertës ekonomike

Nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës me nr. 10030 prot., datë 31.10.2024, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 12 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 4 OE dhe janë kualifikuar 8 OE/BOE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 22.10.2024, ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “L.” ShPK, për të cilën është lidhur kontrata në datë 13.11.2024 për vlerën 46,695,844 lekë pa TVSh dhe vlera 56,035,013 lekë me TVSh, me afat 16 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht³¹, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nuk është përmbushur pika **2.3.5**, sa i përket kërkesës për 1 inxhinier Gjeodet, pasi z. E. C. i deklaruar nga OE shpallur fitues është me profesion inxhinier Gjeomatik.

-Nuk plotësohet kërkesa për disponimin e 2 punonjësve me profesion teknik ndërtimi, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se punonjësi E. O. nuk disponon kontratë pune.

-Nuk plotësohet kërkesa për disponimin e 4 punonjësve me profesion Betonist, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se punonjësi A. S. nuk disponon kontratë pune, dhe në dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik është me profesion hekurkthyes.

-Nuk është plotësuar pika **2.3.10**, ku janë kërkuar 4 kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 ton, konkretisht:

Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton me targë AB...PN, rezulton se nga verifikimi i dokumentacionit për këtë mjet nuk disponohen foto sipas kritereve të kërkuara në DST.

- Kamioni vetëshkarkues me targë AA..SD, rezulton se nga verifikimi i dokumentacionit ky mjet nuk ka certifikatë për transport mallrash dhe nuk plotëson peshën e kërkuar, pasi është 16.8 ton.

- Nuk plotësohet kërkesa për kamionin vetëshkarkues me targë AA...ZE, të marrë me qira nga subjekti Bashkim Karaboja, rezulton se nga verifikimi i dokumentacionit ky mjet nuk ka certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira.

³¹ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

- Nuk plotësohet kërkesa për kamionin vetëshkarkues me targë AA...ZE, të marrë me qira nga subjekti Bashkim Karaboja, rezulton se nga verifikimi i dokumentacionit ky mjet nuk ka certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira.
- Nuk plotësohet kërkesa për kamion me vinç me targë AB...OR, pasi ky mjet nuk disponon certifikatë për transport mallrash.
- Autobitumatricja me targë AB...E, dorëzuar nga OE "S." ShPK, nuk ka certifikatën e miratimit ADR për konformitetin e tij e lëshuar nga një organ inspektues i autorizuar ministri që mbulon sektorin e transportit, ndërkohë që është detyrim ligjor për mbushësin e mallrave të rrezikshme (bitum) për kontrollin e afatit të inspektimit me qëllim që ai mos të ketë kaluar³², si dhe nuk disponon certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira.
- Nuk administrohet certifikata e kualifikimit për drejtuesin e autobitumatrices³³;
- Për drejtimin e autobitumatrices nga OE nuk është dorëzuar dokumentacioni.

Konkluzion.

OE "L." Shpk, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. A. L., Kryetar, z. K. N. dhe z. F. M., Anëtar.

6. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: Rikonstruksion dhe përmirësimi i efincencës energjitike në shllollën "Muhamet Gjollesha"

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion dhe përmirësim i efincencës energjitike shkolla e mesme Muhamet Gjollesha".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-18974-09-12-24 Urdhri nr 619 dt 27.08.24	2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit T. & D. Shpk Lic. N.../1 HARTOI: ING A. L.	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr 619 dt 27.08.24 A. L. L. S. A. P.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 686 prot., datë 12.09.2024. A. I. K. N. F. M.
1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Hapur"			
5. Fondi Limit (pa tvsh) 21,611,627.35 lekë	6. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: (N.) 14,479,818.15 lekë pa tvsh.		7. Diferenca me fondin limit 7.131.809,2 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data 03.10.24	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit.		10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 7 OE b) S'kualifikuar 3 B/OE, c) Kualifikuar 4 B/OE
11. Ankimime AK-s'ka/ka; ka APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka		13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. Lidhja e kontratës NR 10565 DT 19.11.2024	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 17.375.781,78		16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. 17.375.781
17. Situacioni Përfundimtar	18.Afati i kontratës në ditë 12 muaj		19. Zgjatja e kontratës me ditë

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

³² Pika 1 në nenin 48 në Ligjin nr. 118/2012 "Për transportin e mallrave të rrezikshme".

³³ Neni 35 dhe 38 në Ligjin nr. 118/2012 "Për transportin e mallrave të rrezikshme".

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Bashkia Gjirokastrë me VKB nr. 113, datë 14.12.2023, “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2024”, për të cilën është shprehur edhe insitucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë mbi verifikimin e ligjshmërisë me shkresën nr. 1053/1 prot., datë 26.12.2023 ka miratuar fondet mbi objektin e prokurimit: *Rikonstruksion dhe përmirësimi i efincencës energjitike në shllollën “Muhamet Gjollësia”* Fondet e sipërpërmendura janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Gjirokastrë në formatin elektronik më datë 27.08.2023, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, **nuk** rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një **oponencë teknike**, në lidhje me procedurën e sipërcituar, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik.

Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezulton të jetë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik”.

Nga ana tjetër, miratimi i projektit të zbatimit, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, nuk i referohet një oponence teknike dhe, në mungesë të kësaj të fundit, është në kundërshtim me pikën 3 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, sipas të cilës: “Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike...”.

Për sa më sipër, referuar pikës 4 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010, kërkesa për oponencë teknike bëhet nga investitori, çka nënkupton edhe përgjegjësinë e këtij të fundit në rast mosveprimi.

Në kuptim të ligjit nr. 107/2014, referuar nenit 52 të tij, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike, përbën kundërvajtje administrative.

Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, **ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Z. F. G.**

Pika 3 e VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 thekson se: “Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike...”

Hartimi i kritereve të DT:

Me urdhërin nr 7489 prot datë 27.08.2024 të zyrtarit të autorizuar të autoritetit kontraktor z. N. N. është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. A. L. (Personi përgjegjës), znj. L. S., z. A. P. (Anëtar), për kryerjen e prokurimit me objekt “Rehabilitim I segmenteve te ndryshme rrugore” me fond limit 21,611,627 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e hapur”.

Pika 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Elektrik

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë *për të paktën tre muajt e fundit*.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë kontrate pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV.

-Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për një periudhë 3 mujore, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës - Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjësit e mësipërm. Pra pse duhet të jenë 3 muaj në listëpagesë dhe si ndikon kjo në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale. Gjithashtu sqarojmë se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 5 vite/3 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3/5 vite)³⁴. Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 1-2 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 3 muajsh që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

Pika 2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) Punonjës i pajisur me Certifikatë trajnimi për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” i dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj
- 1 (një) Punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

-Sa më sipër sqarojmë për **pikën 2.3.9** në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha (3 muaj në listëpagesë) e vendosur për punonjësit e mësipërm. Gjithashtu kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.

Pika 2.3.11 Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të certifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe konkretisht:

- ISO 9001-2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), *ose ekuivalent*
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent*
- OHSAS45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme), *ose ekuivalent*.

Kërkesa për këtë certifikatë nuk argumentohet nga AK. Sqarojmë se ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. Në rastin në fjalë projekti si fillim i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij. Gjithashtu menaxhimi mjedisor (përsëmbull mbrojtja e mjedisit nga zhurmat e mjeteve të cilat do të punojnë në segmentin rrugor) që duhet të sigurojë subjekti gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, është detyrim ligjor³⁵ që duhet të respektohet nga subjekti nëpërmjet marrjes së masave paraprake, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet disponimit të certifikatës së sipërpërmendur.

³⁴ Shkronja “a” pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

³⁵ Neni 4 në Ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar.

Pra që të përcaktosh kritere të tilla duhet një bazë ligjore, si dhe të jepen arsye/argumentim konkrete për përcaktimin/nevojën e tyre, që në këtë rast nuk është dhënë, si dhe duhet të jenë përputhje me zërat e punimeve që do të realizojë OE.³⁶ Për më tepër referuar procesverbalit të mbajtur nga NJP, për vendosjen e kërkesës për certifikatat ISO, pasqyrohet argumenti se janë vendosur për cilësinë e mallit. Për këtë argument, sqarohet se referuar përcaktimit të bërë në shkronjën “c” të pikës 1 dhe shkronjën “dh” në pikën 9 në Kreun III të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, cilësia e mallit vërtetohet nëpërmjet dokumenteve (certifikatë analizat e mallit) që dorëzohen gjatë zbatimit të punimeve, ku plotësohet dosja e kantierit dhe kontrollohen nga përgjegjësi/drejtuesi teknik i kantierit.

Pika 2.3.12 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga QKL “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve urbane), së bashku me aktin e miratimit nr. 5.

-Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.B specifikohen në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme. Kriteri për disponimin e liçensës me kodet e sipërcituara, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomikë të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, do të penalizoheshin vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferimi mbetjesh. Nga ana e AK përcaktohet vendi i hedhjeve të mbetjeve. Subjektet që kryejnë aktivitet, klasifikohen në operator që gjeneron mbetje urbane në njësinë administrative ku zhvillojnë aktivitet. OE që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, hapja e NIPT-it sekondar (për OE që nuk kanë seli në njësinë administrative), nënkupton që subjekti paguan taksat dhe tarifat vendore (si taksë pastrami, gjelbërimi, tabelle etj., sipas ligjit dhe VKB-së përkatës).

Referuar VKM-së nr. 538, datë 26.05.2009, “Për liçensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, në aneksin 1, Kategoria III, Liçensimi i vepritarive të nënkategorive të nënkategorisë III.2.B, në pikën 9. Çdo operator/familje/individ që gjeneron mbetje urbane është i detyruar të depozitojë në pikat e grumbullit/kontenier dhe jo t’i trajtojë këto mbetje. Referuar objektit të prokuruar, transporti i materialeve gjatë realizimit të punimeve, mjeteve u nevojitet vetëm: lejen e qarkullimit, certifikatat e pronësisë, siguracionin, kolaudimin, **çertifikatë transporti**.

Për sa trajtuar më sipër, në procedurën e prokurimit me objekt: Rikonstruksion dhe përmirësimi i efincës energjitike në shllollën “Muhamet Gjollësia”, konstatuar se, kriteret e aplikuar në DT nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe ngarkon me përgjegjësi Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. A. L. (Personi përgjegjës), znj. L. S., z. A. P. (Anëtar),

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhër nr. 696, nr. 7967 prot., datë 12.09.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Gjirokastrë (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr. 219, nr. 3980 prot., datë 19.04.2021), është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. A. L. (Kryetar), z. K. N. dhe z. F. M., (Anëtar). Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 10199 prot., të datës 06.11.2024, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin e B/OE nga ku rezulton se janë kualifikuar 4 B/OE dhe janë skualifikuar 3 B/OE si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	" N. " shpk	14,479,818	Kualifikuar
2	BOE T. & C. SHPK	14,831,389	S/Kualifikuar. Nuk plotëson kriterin: 2.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga

³⁶ Pika 2 në nenin 61 në VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, si dhe njoftimin nr.3341/1 datë 20.03.2018 të APP për AK.

			<i>DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, ose ekuivalente konkretisht: d)ISO 14001:2015 Sistemet e menaxhimit te ambientit / ekuivalente dhe e vlefshme e)ISO 9001:2015, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ekuivalente dhe e vlefshme f) OHSAS 45001:2018, mbi “Sistemin e Menaxhimit te Shëndetit dhe sigurise në punë”, ekuivalente dhe e vlefshme</i>
3	BOE S. & J. SHPK	15,281,313	<i>S/Kualifikuar. Nuk plotesn kriterin: 2.12 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga QKL “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve urbane), së bashku me aktin e miratimit nr 5 Pasi per kete kriter mbeshetet ne kapacitetet e OE E., gje e cila nuk lejohet sipas kriterit te DST-se nr. 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera: ku specifikohet qe ky kriter nuk mund te mbeshetet.</i>
4	BOE E. & I. SHPK	15,286,484	<i>Kualifikuar</i>
5	OE A.	17,114,625	<i>Kualifikuar</i>
6	OE “S.” shpk	17,294,920	<i>S/Kualifikuar. Nuk plotesn kriterin: 2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: e)Ing ndërtimi 1 (një) gje e cila nuk lejohet sipas kriterit te DST-se nr. 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera: ku specifikohet qe ky kriter nuk mund te mbeshetet 2.12 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga QKL “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve urbane), së bashku me aktin e miratimit nr 5 Pasi per kete kriter mbeshetet ne kapacitetet e OE E., gje e cila nuk lejohet sipas kriterit te DST-se nr. 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera: ku specifikohet qe ky kriter nuk mund te mbeshetet.</i>
7	BOE O. & E. & A.	17,522,222	<i>Kualifikuar</i>

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK me ane te shkreses Nr. 10199/1 prot., datë 06.11.2024 ka shpallur fituese ofertën e operatorit ekonomik “N.” shpk për të cilën është lidhur kontrata datë nr. 10565 datë 19.11.2024 me vlerë 14,479,818 lekë pa tvsh, me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve. (Nuk ka patur ankime)

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e BOE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se nuk janë paraqitur ankesa nga BOE, duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK. Për sa trajtuar më sipër OE “N.” Shpk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika

4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në mënyrë të përmbledhur realizimi i kontratave për punë publike, për periudhën e auditimit, paraqitet, si më poshtë.

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit, në Bashkinë Gjirokastrë, nga grupi i auditimit të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara dhe të marra në dorëzim për periudhën e auditimit 01.01.2023 – 31.12.2024 për **15 (pesëmbëdhjetë)** investime në shumën **277,724,543.78 lekë me TVSH** (pasqyruar në regjistrin e realizimit të prokurimeve tek anekset). Nga kjo analizë, nga grupi i auditimit u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t'u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës së kontratës, llojit të punimeve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të madh në zbatimin e veprave, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqitura në **Tabelën 1**, si vijon:

Tabela 1: Regjistri i kontratave për punë publike të përfunduara, të kolauduara dhe, të marra në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Gjirokastrë, për periudhën e auditimit 2023 - 2024.

Nr.	Objekti i investimit	Burimi Financimit	Op. Fitues	Vlera e kontratës (TVSH)	Dt. Lidhjes kontrates
Viti 2023					
1	Rikonstruksion Pallati i Sportit Gjirokastrë	Buxheti i shtetit	OE "L. & E." sh.p.k	70,677,778.28	03.05.2023
2	Rikonstruksion i rrugës Zhulat Loti 1	Bashkia Gjirokastrë	OE "E. B." sh.p.k	45,956,077.2	13.02.2023
3	Mirëmbajtje e rrugës Zhulat	Emergjencat	OE "E. B." sh.p.k	10,549,810.8	28.10.2022
Total 2023 në lekë me TVSH				127,183,666.28	
Viti 2024					
1	Rikonstruksion i tregut romë Gjirokastrë "Roma on market" Masa inxhinierike për stabilizimin rrëshqitjes së masës në kodrën e cfakës pranë rrugës Nacionale Loti 2	Bashkimi Evropian	OE "F." sh.p.k	18,475,691	10.11.2023
2		Emergjencat civile	OE "L." sh.p.k	34,541,506	15.12.2023
Total 2024 në lekë me TVSH				53,017,197	
Totali 2023 + 2024 (Lekë me TVSH)				180,200,863.28	

Burimi: Bashkia Gjirokastrë.

Mbështetur sa më sipër, për auditimin e zbatimit të punimeve të kontratave për punë publike, për periudhën e auditimit 01.01.2023 – 31.12.2024, u audituan **5 (pesë)** investime në shumën totale **180,200,863.28 lekë me TVSH ose 64.88 %** të shumës totale të kontratave për punë publike **277,724,543.78 lekë me TVSH.**

Në përfundim të auditimit të zbatimit të kontratave për punë publike, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, dhe shqyrtimit të observacioneve të subjektit të audituar Bashkia Gjirokastrë, **po pasqyrojmë në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara**, si vijon:

I. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës për punë publike për objektin:

"Rikonstruksion i rrugës Zhulat Gjirokastrë Loti I". me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion i rrugës Zhulat Gjirokastrë Loti I".		
14.Lidhja e kontratës nr. 1363 prot., datë 13.02.2023 BOE "E. & I." SHPK	15.Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 45,956,077.20 lekë me TVSh.	16.Likuiduar: -----
17- Situacioni Përfundimtar	18.Afati i kontratës. Fillimi punimeve:	19. Zgjatja e kontratës --

Sit. përfundimtar në vlerën 45,956,077.20 lekë	09.06.2023 Përfundimi punimeve: 15.09.2023	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “Z.” SHPK	Licenca MK...../14	Kontratë me nr. 2762 prot., datë 20.03.2023
21. Kolaudatori i punimeve BOE “Z.” SHPK	Licenca Nr: MK. .../3	Kontratë nr. 11730 prot., datë 11.12.2023
22.Akt Kolaudimi. Akti i Kolaudit është kryer me sipas aktit me nr. 12090 prot., datë 20.12.2023 dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE “E.” SHPK & “I.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve OE “Z.” SHPK dhe kolaudatori i punimeve BOE “Z.” SHPK & “P.” SHPK .	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 01.03.2024 është hartuar certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve nga OE “E.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve OE “Z.” SHPK , kolaudatori i punimeve shoqëria “Z.” SHPK, si dhe nga Komisioni i ngritur nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, si dhe grupi i marrjes në dorëzim.	

rezultoi me problematikat, si vijon:

Përshkrimi i Situatës:

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 1363 prot., datë 13.02.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastër, përfaqësuar nga z. N. N. (Zyrtar i autorizuar i AK) dhe BOE “E.” SHPK (50%) me NIPT K.....P dhe, Lic. Nr. NZ. 4611/5 përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor Z. I. M. dhe OE “I.” SHPK (50%) me NIPT J.....Ë dhe, Lic. Nr. NZ. --- përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor . F. C. me vlerë të kontratës 45,956,077.2 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 4 (katër) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Zëri 1 (3.138) Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3 me themele gjerësi, tok e zak, kategoria III, me shkarkim në tokë], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër , në vlerën **110,000 lekë pa TVSH**, argumentuar si më poshtë.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +		
							Vol.	Vlera	
2. Punime Shtresash								0	
Zëri 1 (3.138)	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3 me themele gjerësi, tok e zak, kategoria III, me shkarkim në tokë	m ²	250	3,153	3,153	2,713	440	110,000	
Totali pa TVSH								110,000	

Nga ana e zbatuesi i punimeve BOE “E. & I.” SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- **Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998** “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane... ”.
- **Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005** “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit... ”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqëria “Z.” SHPK , e përfaqësuar nga Administratori z. A. P., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Librezat e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. P., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet trajtuar në akt-konstatimi Nr.6, datë 16.06.2025, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Gjirokastrë)

II. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës për punë publike për objektin:

“Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastrë”. me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastrë”.		
14.Lidhja e kontratës nr. 4235 prot., datë 03.05.2023 BOE “L. & E.” SHPK	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 70,677,778.28 lekë me TVSh.	16.Likuiduar: ---
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përfundimtar në vlerën 70,671,746.92 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës. Fillimi punimeve: 16.06.2023 Përfundimi punimeve: 16.04.2024	19. Zgjatja e kontratës Janë bërë 3 (tre) amendim kontrate
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “P. & D.” SHPK	-Licenca MK..../19 -Licenca MK..../5	Kontratë me nr. 4236 prot., datë 03.05.2023
21. Kolaudatori i punimeve OE “F.” SHPK	Licenca Nr: MK. .../3	Kontratë nr. 7873 prot., datë 14.08.2024
22.Akt Kolaudimi. Akti i Kolaudimit është kryer me sipas aktit me nr. 9815 prot., datë 28.10.2024 dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE “L.” SHPK & “E.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE “P. & D.” dhe kolaudatori i punimeve BOE punimeve BOE “F.” SHPK & “Z.” SHPK.	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 26.11.2024 është hartuar certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve nga BOE “L.” SHPK & “E.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE “P. & D.” dhe kolaudatori i punimeve BOE punimeve BOE “F.” SHPK & “Z.” SHPK, nga Komisioni i ngritur nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, si dhe AK.	

rezultoi me problematikat, si vijon:

Përshkrimi i Situatës:

Në mënyrë të përmblodhur për këtë investim rezultoi;

1. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 4235 prot., datë 03.05.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastrë, përfaqësuar nga Zz. N. N. (Zyrtar i autorizuar i AK) dhe BOE “L.” SHPK (51.5%) përfaqësuar nga znj. D. M., me NIPT K....H dhe, Lic. Nr. NZ. .../20 dhe “E.” SHPK (48.5 %) përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor z. Ç... S... me NIPT K....I dhe, Lic. Nr. NZ. --. BOE nëpërmjet Deklaratës Noteriale me Nr. Rep 3575 Nr. Kol 2436, datë 08.04.2023 dhe nëpërmjet Prokurës së Posaçme Nr. Rep 3576 Nr. Kol 2437, do të përfaqësohet nga OE “L.” SHPK (51.5%) përfaqësuar nga znj. D. M., me vlerë të kontratës

70,677,778.28 lekë me TVSH dhe afat të realizimit 4 (katër) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Zëri 3 (An-17) Prishje suvatim nga brenda mure; Zëri 3 (2.31) Suva mur tulle h-4m me krah, llaç përzier M25; Zëri 3 (Analizë) FV Kompiuter, përfshirë programin, i kompletuar për punë], **me pasojë dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **173,012 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +	
							Vol.	Vlera
	Punime prishjeje							0
Zëri 3 (An-17)	Prishje suvatim nga brenda mure	m ²	250	4,022.22	3,898.57	3,898.57	126	30,912
	Punime shtresash							0
	Punime në fasadë, tavani, suvatimi dhe veshje							0
Zëri 3 (2.31)	Suva mur tulle h-4m me krah, llaç përzier M25	m ²	850	4,022.22	4,022.22	3,898.57	126	107,100
	Instalimet e sistemit CCTV							0
Zëri 3 (Analizë)	FV Kompiuter, përfshirë programin, i kompletuar për punë	Copë	1	1	1	-	1	35,000
	Totali pa TVSH							173,012

Nga ana e zbatuesi i punimeve BOE “**L. & E.**” SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas: - **Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998** “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005** “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve BOE “**P.**” SHPK & “**D.**” SHPK, e përfaqësuar nga Administratori znj. V., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998** “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3, datë 15.2.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

2. Kontrata për kolaudimin e punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastër” Bashkia Gjirokastër, është lidhur me nr. 7873 prot., datë **14.08.2024** ndërmjet Bashkisë Gjirokastër, përfaqësuar nga zyrtari i Autorizuar i AK z. N. N. dhe BOE “**F.**” SHPK përfaqësuar nga Administratori z. S. B., ndërkohë që punimet e ndërtimit kanë përfunduar me datë **16.04.2023**, pra, rreth **15 (pesëmbëdhjetë)** muaj me vonesë, veprim ky në kundërshtim me **Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998** “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar,

nini 12 ku citon se: “Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t’ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit” si dhe nenin 15.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi zyrtari i autorizuar i Bashkisë Gjirokastër z. N. N..

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z. N. N.**, në cilësinë e zyrtarit të autorizuar të Bashkisë Gjirokastër.
2. **Znj. V. G.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet trajtuar në akt-konstatimi Nr.7, datë 16.06.2025, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Gjirokastër)

III. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës për punë publike për objektin: “**Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfakës pra rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavie Loti 2**”. me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfakës pra rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavie Loti 2”.		
14. Lidhja e kontratës nr. 11950 prot., datë 15.12.2023 OE “L.” SHPK	15. Vlera e kontratës V1 e prev ofertues 34,541,506 lekë me TVSh.	16. Likuiduar: -sit. Nr. 1 në shumën 19,618,696 lekë me TVSH. -sit. Nr. 2 në shumën 10,148,196 lekë me TVSH.
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përfundimtar në vlerën 4,240,499 lekë me TVSH	18. Afati i kontratës. Fillimi punimeve: 05.01.2024 Përfundimi punimeve: 19.08.2024	19. Zgjatja e kontratës Afati 5 muaj -shtyrje me 102 ditë kalendarike.
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE (P.)	Licenca MK...../19	Urdhër me nr. 12161, datë 21.12.2023
21. Kolaudatori i punimeve BOE “G. & X. & M.” SHPK	Licenca Nr: MK.	Urdhër me nr. 9769, datë 25.10.2024
22. Akt Kolaudimi. Akti i Kolaudimit është kryer me sipas aktit me nr. 9867 prot., datë 29.10.2024 dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “L.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “P.” SHPK dhe kolaudatori i punimeve BOE “G. & X. & M.” SHPK .	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 29.10.2024 është hartuar certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “L.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “P.” SHPK dhe kolaudatori i punimeve BOE “Game & X. & M.” SHPK, grupi i marrjes në dorëzim me përbërje Ing. A. P., Ing. B. D., Ark. E. X. dhe përfaqësuesi i autorizuar i AK z. N. N..	

rezultoi me problematikat, si vijon:

Përshkrimi i Situatës:

Në mënyrë të përmblodhur për këtë investim rezultoi;

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 11950 prot., datë 15.12.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastër, përfaqësuar nga z. N. N. (Zyrtar i autorizuar i AK) dhe shoqëria “L.” SHPK me NIPT K....K dhe, Lic. Nr. NZ./5 përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor z. A. L..me vlerë të kontratës 34,541,506 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 5 (pesë)muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Suvatim me llaç çimento të perdes me pilota të Masës Inxhinierike Nr. 1, F.V Akacie 2 vjeçare bashkë me mbushjen me dhe vegjetal], **me pasojë dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **142,200 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +	
							Vol.	Vlera
Punime për realizimin e trarëve lidhës 40x40 cm te Murit 2-1 me Murin 2-2								-
Zëri 1 (31-632)	Suvatim me llaç çimento të perdes me pilota të Masës Inxhinierike Nr. 1	m ²	1,000	86.2	86.2	-	86.2	86,200
Punime gjelbërimi								-
Zëri 1 (An)	F.V Akacie 2 vjeçare bashkë me mbushjen me dhe vegjetal	copë	7,000	48	48	40	8	56,000
Totali pa TVSH								142,200

Nga ana e zbatuesi i punimeve “L.” SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane... ”.

- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit... ”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve BOE “P.” SHPK & “D.” SHPK & “Z.” SHPK, përfaqësuar nga OE “P.” SHPK, e përfaqësuar nga Administratori znj. V., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit ”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit ”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. V., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet trajtuar në akt-konstatimi Nr.8, datë 16.06.2025, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Gjirokastrë)

IV. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës për punë publike për objektin: “**Punime mirëmbajtje rruga e fshatit Zhulat**”. me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Punime mirëmbajtje rruga e fshatit Zhulat”.		
14.Lidhja e kontratës nr. 11757 prot., datë 28.10.2022	15.Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 10,549,810.8 lekë me TVSh.	16.Likuiduar: --

OE "E." SHPK		
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përfundimtar në vlerën 10,549,439 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës. Fillimi punimeve: 08.12.2022 Përfundimi punimeve: 17.02.2023	19. Zgjatja e kontratës Afati 77 ditë
20. Mbikëqyrësi i punimeve Ing. A. P.	Licenca MK.....5/1	Urdhër me nr. 937, datë 05.12.2022
21. Kolaudatori i punimeve Ing. A. C.	Licenca Nr: MK./2	Urdhër me nr. 937, datë 05.12.2022
22.Akt Kolaudimi. Akti i Kolaudimit është kryer me sipas aktit me datë 21.03.2023 dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "E." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve Ing. A. P.dhe kolaudatori i punimeve Ing. A. Ç. .	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 28.06.2023 është hartuar certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve nga OE "E." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve Ing. A. P., kolaudatori i punimeve Ing. A. Ç., si dhe nga Komisioni i ngritur nga Kryetari i Bashkisë Gjyrokastër , si dhe është miratuar nga z. N. N..	

rezultoi me problematikat, si vijon:

Përshkrimi i Situatës:

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 11757 prot., datë 28.10.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjyrokastër, përfaqësuar nga z. N. N. (Zyrtar i autorizuar i AK) dhe shoqëria "E." SHPK me NIPT K.....P dhe, Lic. Nr. NZ./5 përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor z. I. M. me vlerë të kontratës 10,549,810.8 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 77 ditë, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Zëri 4 (3.211 Shtresë cakulli mbeturinë kave t=20cm për bankina), **me pasojë dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Gjyrokastër , në vlerën **60,000 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +		
							Vol.	Vlera	
VII. Punime Shtresash								0	
Zëri 5 (3.211)	Shtresë cakulli mbeturinë kave t=20cm për bankina.	m ²	300	1,000	1,000	800	200	60,000	
Totali pa TVSH								60,000	

Nga ana e zbatuesi i punimeve "E. & I." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998** "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: " ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...".

- **Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005** "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3 ku përcaktohet se: "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...".

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve Ing. A. P., e përfaqësuar nga Administratori z. A. P., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Librezat e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. P., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet trajtuar në akt-konstatimi Nr.9, datë 16.06.2025, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Gjirokastrë)

V. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës për punë publike për objektin: “**Rikonstruksion i tregut lokal Rome Gjirokastrë “Roma on Market”**”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i tregut lokal Rome Gjirokastrë “Roma on Market””.		
14.Lidhja e kontratës nr. 10782 prot., datë 10.11.2023 OE “F.” SHPK	15.Vlera e kontratës V1 e prev ofertues 18,475,691 lekë me TVSh.	16.Likuiduar: -sit. Nr. 1 + sit nr. 2 +sit nr. 3 në shumën 17,927,964 lekë me TVSH.
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përfundimtar në vlerën 18,473,400 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës. Fillimi punimeve: 31.01.2024 Përfundimi punimeve: 02.09.2024 (30.08.2024)	19. Zgjatja e kontratës Afati 7 muaj
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “N. S.” SHPK	Licenca MK.../7	Urdhër me nr. 11941 prot., datë 15.12.2023
21. Kolaudatori i punimeve OE “D” SHPK	Licenca Nr: MK. .../1	Urdhër me nr. 8660, datë 01.10.2024
22.Akt Kolaudimi. Akti i Kolaudimit është kryer me datë 27.10.2024 dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “F.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “N. S.” SHPK dhe kolaudatori i punimeve OE “D” SHPK .	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 18.12.2024 është hartuar certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “F.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “N. S.” SHPK dhe kolaudatori i punimeve OE “D” SHPK, grupi i marrjes në dorëzim me përbërje Ing. A. P., Ing. F. M., Ark. A. Ç. dhe përfaqësuesi i autorizuar i AK . N. N..	

Rrezultoi me problematikat, si vijon:

Përshkrimi i Situatës:

Në mënyrë të përmblodhur për këtë investim rezultoi;

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 10732 prot., datë 10.11.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastrë, përfaqësuar nga z. N. N. (Zyrtar i autorizuar i AK) dhe shoqëria “F.” SHPK me NIPT K.....C dhe, Lic. Nr. NZ./21 përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor z. F. M. me vlerë të kontratës 18,475,691 lekë me TVSH dhe, fat të realizimit të kontratës 7 (shtatë)muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Mur guri

në lartësi deri 3m me llaç përzier M 15; F.V bordura betoni parafabrikat, 20x35 cm], **me pasojë dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë në vlerën **109,232 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +		
							Vol.	Vlera	
Punime murature tulle								0	
Zëri 5 (2.54/1)	Mur guri në lartësi deri 3m me llaç përzier M 15.	m ³	6,000	68.9	55.3	55.3	13.6	81,600	
Punime të ndryshme.								0	
Zëri 2(3.618)	F.V bordura betoni parafabrikat, 20x35 cm	ml	1,200	176	176	176 realizuar me çmim 1,043 lekë dhe me çmim 1,200 lekë	-	27,632	
Totali pa TVSH								109,232	

Nga ana e zbatuesi i punimeve **“F.” SHPK** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998** “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005** “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqëria “N. S.” SHPK, përfaqësuar nga Administratori z. E. N., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998** “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3, datë 15.2.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E. N., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet trajtuar në akt-konstatimi Nr.10, datë 16.06.2025, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Gjirokastrë)

5. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Sipas ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin. Për bashkinë Gjirokastrë, lista e pronave është miratuar me VKM 1684, datë 24.12.2008 “Për

miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Gjirokastrë, të Qarkut Gjirokastrë”, i është miratuar lista inventarit me 240 fletë dhe përfundon me numër rendorë 1713.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njesisë Administrative Gjirokastrë. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 1700 (njëmijë shtatëqind) dhe përbëhet me 242 (dyqindedyzetedy) fletë, vendim ky i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, me shkresë nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe ky vendim me shkresë nr. 3376, datë 14.06.2017 është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

Në total, nga 1699 pasuri që i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Gjirokastrë, pa përfshirë ish-komunat, të cilat nuk rezultojnë me dokumentacion pronësor.

	Bashkia/Njësiti	Nr. Pronave në Inventar	Në pronësi	Në përdorim	Prona të regjistruara në Kadastër
1	Bashkia Gjirokastrë	1699		1699	
2	NJA. Lazarat	172		172	
3	NJA. Cepo	612		612	
4	NJA. Picar	409		409	
5	NJA. Antigone	259		259	
6	NJA. Odrie	102		102	
7	NJA. Lunxheri	102		102	
Totali		3355		3355	

-Për ish-Komunën Lazarat:

Me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Lazarat, të Qarkut Gjirokastrë”, i është miratuar lista inventarit me 31 fletë dhe përfundon me numër rendorë 157.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njesisë Administrative Lazarat, në Bashkinë Gjirokastrë. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 157 (njëqindpesëdhjeteshtatë) dhe përbëhet me 31 (tridhjetenjë) fletë, vendim ky i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, me shkresë nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe ky vendim me shkresë nr. 3376, datë 14.06.2017 është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

-Për ish-Komunën Cepo:

Me VKM nr. 244, datë 31.03.2011 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Cepo, të Qarkut Gjirokastrë”, i është miratuar lista inventarit me 83 fletë dhe përfundon me numër rendorë 612.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njesisë Administrative Cepo, në Bashkinë Gjirokastrë. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 612 (gjashtëqindedydhjetë) dhe përbëhet me 83 (tetëdhjetetë) fletë, vendim ky i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, me shkresë nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe ky vendim me shkresë nr. 3376, datë 14.06.2017 është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

-Për ish-Komunën Picar:

Me VKM nr. 22, datë 12.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Picar të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar 439 prona. Numrat rendorë, 1-4 Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe 1501 m². Numrat rendorë, 5-8 Prona që përdoren

për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe 269 m². Numrat rendorë, 10,20-25,27,28,30,34-38,302- 406 Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), rrugë vendore, në pronësi, shesh me sipërfaqe 79629 m². Numrat rendorë 11-19,26,29,31-33,39 Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 10329 m². Numrat rendorë, 40-50,55-58,60-67,69-70,72-79 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtese 3986 m². Numrat rendorë, 81-85 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës, në pronësi, me sipërfaqe ndërtese 469 m². Numrat rendorë, 86-87 Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive, në pronësi, me sipërfaqe totale 5181 m², nga kjo ndërtesë 113 m² Numrat rendorë, 88-92 Varrezat publike, në pronësi. Numrat rendorë, 263-271 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive arë , vreshta dhe pemëtore), në përdorim, me sipërfaqe 233.6 ha. Numrat rendorë 272-276,281,282,285,286,294, 295,299 (vetëm kanale të treta) Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta), në pronësi, me sipërfaqe 546 ha. Numrat rendorë 408-409 Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi.

-Për ish-Komunën Antigone:

Me VKM nr. 506, datë 13.07.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Antigone të Qarkut të Gjirokastrës”, i janë kaluar 259 prona.

Numri rendor, 20-27, 252 Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe totale 12225 m², nga kjo ndërtesë 1408 m².

Numri rendor, 28-30 Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore , në pronësi, me sipërfaqe totale 5720 m², nga kjo ndërtesë 440 m².

Numri rendor, 31-33 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik në pronësi, me sipërfaqe totale 340 m², nga kjo ndërtesë 300 m².

Numri rendor, 34 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative, në pronësi, me sipërfaqe totale 220 m², nga kjo ndërtesë 216 m².

Numri rendor, 35, 36, 38 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe totale 690 m², nga kjo ndërtesë 270 m².

Numri rendor, 37 Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 480m².

Numri rendor, 39 Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, me sipërfaqe 4250 m².

Numri rendor, 40-43 Varrezat publike, në pronësi, me sipërfaqe 13815m².

Numri rendor, 45-55 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sip. 24.9 ha i është dorëzuar AKKP-së, në përdorim, me sipërfaqe 770.5 ha.

Numri rendor, 56-60, 64, 72, 75 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproductive), në pronësi, me sipërfaqe 370 ha.

Numri rendor, 80-220 Infrastrukturë (rrugë vendore), në pronësi.

Numri rendor, 221-226, 253-259 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi.

Për ish-Komunën Odrie:

Me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Odrie të Qarkut të Gjirokastrës”, i janë kaluar 136 prona.

Numrat rendorë 1,2,4,5,6,8,9,11,12,13,15,16 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive), në përdorim, me sipërfaqe 791 ha.

Numrat rendorë 3,7,10,14,17,75,76,83,84, 89, 92, 95, 96, (vetëm kanalet e treta) Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive dhe kanale

të treta), në pronësi, me sipërfaqe 375 ha. Numrat rendorë 18-23 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtese 563 m².

Numrat rendorë 24-26 Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive, në pronësi, me sipërfaqe ndërtese 696 m².

Numrat rendorë 27-29 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe 329 m².

Numrat rendorë 30 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës, në pronësi, me sipërfaqe 250 m².

Numrat rendorë 31-38 Varrezat publike, në pronësi.

Numrat rendorë 39-44 Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe 1218 m².

Numrat rendorë 45-62 (vetëm trojet) Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim.

Numrat rendorë 45-62 (vetëm sheshet) Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, me sipërfaqe 39958 m²

Numrat rendorë 98-100 Infrastrukturë (rrugë vendore), në pronësi.
Numrat rendorë 101-102 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi.

Për ish-Komunën Lunxhëri:

Me VKM nr. 567, datë 27.06.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Lunxheri të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar 701 prona.

Numrat rendorë 1-5, 701 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën arsimore, në pronësi, me sipërfaqe totale 16953 m², nga kjo ndërtesë 1670 m²

Numrat rendorë ,6-7 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e kulturës, në pronësi, me sipërfaqe totale 6928 m², nga kjo ndërtesë 88 m².

Numrat rendorë , 8 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtesë 32 m².

Numrat rendorë ,10-14 Varrezat publike, në pronësi, me sipërfaqe 13763 m².

Numrat rendorë , 15-19, 21, 29, 30, 38, 62, 63, 66-68, 80-82, 85, 89, 91-101, 113-116, 147, troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 43607 m²

Numrat rendorë , 20, 24, 25, 28, 34-37, 39-46, 48-53, 57-59, 61, 64, 65, 69-79, 83, 84, 86-88, 90, 102-112, 118, 121-146, 149, 150, 154-446 Infrastrukturë (rrugë vendore, sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, sheshe me sipërfaqe 202969 m².

Numrat rendorë, 22, 23, 26, 27, 31-33, 47, 54-56, 60, 117, 148, 151-153 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe totale 15952 m², nga kjo ndërtesë 2704 m²

Numrat rendorë , 447-449 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e mbrojtjes civile, në pronësi, me sipërfaqe totale 1520 m², nga kjo ndërtesë 834 m²

Numrat rendorë 450-451 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi.

Nga pasuritë e mësipërme nuk rezulton të jetë e regjistruar asnjë pasuri në regjistrat publike të pasurive të paluajtshme.

Për Bashkinë Gjirokastrë

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Gjirokastrë nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë. Ushtrimi i funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin bëhet vetëm përmes një specialisti dhe nuk ka një strukturë të posaçme funksionale me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme.

Bashkia Gjirokastër nuk disponon dokument pronësie për asnjë nga pronat e transferuara, çka nënkupton se për to nuk ka kartelë pasurie në regjistrat publike dhe se nuk është aplikuar në ASHK për kalimin nga sistemi i vjetër hipotekor në sistemin e ri të certifikimit, për zona kadastrale ku ka mbaruar procesi i regjistrimit fillestar.

Nga verifikimi i evidencave, rezulton se:

Në bashkinë Gjirokastër nuk është krijuar Sektori i Menaxhimit dhe Administratimit të Aseteve, nuk janë ngritur grupe pune ku të përcaktohet misioni dhe detyra e tyre për administrimin e asetëve si dhe struktura për ndjekjen e tyre.

II.Fondi Pyjor

4.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira dhe likuidimin e kontratave të lidhura

Bashkia Gjirokastër ka në administrim një fond pyjor dhe kulloror prej 22,260 ha, i ndarë në 11 ekonomi pyjore sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar.

Ekonomia pyjore/ kullorore	Sip/total ha	Shkëmbore	pyll	kullote
Bashkia Gjirokastër	1429.28			1429.28
Nj.A Cepo	1959.41			1959.41
Nj.A Antigone	747.34			747.34
Nj.A Lazarat	1471.47			1471.47
Nj.A Picar	4418.39			4418.39
Nj.A Lunxheeri	1282.94			1282.94
Nj.A Odrie	1141.17			1141.17
Ek. Pyjore Mali Gjere	496		496	
EK.pyjore Kardhiqe	4067		4067	
Ek.Pyjore Lunxheri	2354		2354	
EK.Pyjore Picar	3035		3035	
Totali	22,620	218	9,952	12,450

Nga auditimi ka rezultuar se:

- Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore.
- Në kundërshtim me pikën 66 të VKM nr.443/2016 nuk ka regjistruar në regjistrat kadastrale sipërfaqet e fondit pyjor dhe kulloror publik nuk është regjistruara asnjë sipërfaqe pyjore e transferuar.
- Në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kulloror, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, Bashkia Gjirokastër nuk ka ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor brenda juridiksionit të saj administrativ.

Në bashkinë e Gjirokastër janë lidhur 169 kontrata për dhënie në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kulloror, nga të cilat kanë si objekt aktiviteti “Blegtori”. Nga auditimi rezultoi se për vitin 2023 nuk ka asnjë debitorë. Kontratat janë të detajuara në ankeset 1 dhe 2.

➤ *Subjektet që ushtrojnë aktivitet në Fond Pyjor dhe kulloror të cilët janë pajisur me leje nga ministria, por nuk kanë nënshkruar kontrat me Bashkinë Gjirokastër.*

Bashkia Gjirokastrë nuk ka vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare dhe leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi.

Në lidhje me auditimin e të ardhurave nga asetet, grupi i auditimit bëri kërkesë drejtuar Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për vendosjen në dispozicion të kontratave të qirave të fondit pyjor/kullor të cilat ushtrojnë aktivitet në sektorin e burimeve minerare në territorin që administrojnë Bashkia Gjirokastrë.

Duke u bazuar në të dhënat e pasqyruara në Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në Regjistrin e Lejeve Minerare të muajit shkurt të vitit 2023, Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstatohet se për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, në territorin e Bashkisë Gjirokastrë ushtrojnë aktivitet tre subjekte, të cilat nuk paguajnë detyrime për aktivitetin që kryejnë, pasi nuk janë të evidentuara nga Bashkia Gjirokastrë.

Këto subjekte janë:

1. Subjekti "A." pa NIPT, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1907, datë 21.01.2021, për shfrytëzimin e vendburimit Zhulat-Picar për llojin e mineralit litium dhe me sipërfaqen 1 km².
2. Subjekti "B." me NIPT K.....S i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 1168/1, datë 19.03.2008, për shfrytëzimin e vendburimit Lazarat për llojin e mineralit gëlqeror pllakor me sipërfaqen 0.032 km².
3. Shoqëria Koncesionare "P." ShPK.
4. Subjekti "N." shpk me NIPT K.....D i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1931, datë 04.05.2022, për shfrytëzimin e vendburimit Lazarat për llojin e mineralit gëlqeror me sipërfaqen 0.808 km².

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Neni 17, të Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për Fondin kullor", pikat 3, 7, 9,10,11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor".

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e energjetikës

Nga të dhënat e siguruar nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me kontratat e koncesionit sipas regjistrin të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës 2023-2024, në territorin e Bashkisë Gjirokastrë, kanë ushtuar aktivitet në fushën e energjetikës 4 subjekte, për të cilat *Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave* nuk administrojnë dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj), sipas tabelës vijuese. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin kullor", pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor"

Nr.	Qarku	HEC-i	Shoqëria Koncesionare	Nr. I Heceve	Forma e kontrates
19	Gjirokastrë	Langarica	"L. & E." Shpk	1	BOT

47	Gjirokastrë	Picar 1	"P." Shpk	1	BOT
61	Gjirokastrë	Langarica 3: Gostivisht, Langarica 3, Ura e Dashit	"I."shpk	3	BOT
	Gjirokastrë	Ferko 1,2	S. sh.p.k	1	BOT

Burimi: Faqe zyrtare e AKBN

6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Bashkia Gjirokastrë ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor (këtu e në vazhdim PPV) dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (këtu e në vazhdim KKT), nr. 01, datë 08.02.2017, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Auditimi konsiston në këto fusha:

- Dhënia e lejes së zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura;
- Dhënia e lejes së ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik;
- Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë;
- Dhënia e certifikatës së përdorimit.

LEJET E NDËRTIMIT, ZHVILLIMIT DHE PËRDORIMIT PËR PERIUdhËN **01.01.2023 - 31.12.2024**

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Gjirokastrë, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2023 deri në 31.12.2024**, ka pasur **277 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe certifikata përdorimi, etj., përkatësisht: 19 aplikime për leje zhvillimi, 11 aplikime për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m², 2 aplikime për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m², 6 leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. deri në 250 m², 2 leje ndërtimi për shtesë në nd. ekzistues me sip. më të madhe se 250 m², 33 leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni, 16 leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni, 128 aplikime për deklarata paraprake për kryerje punimesh, 1 leje rind., rikonst. dhe ripar. të nd. së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni, 13 aplikim për certifikatë përdorimi, 3 leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, 1 leje për ndryshim funksioni, 1 leje për ndryshimin e subjektit zhvillues, 29 aplikime per njoftim fillim punimesh, 4 leje për shyrjen e afatit të lejes së ndërtimit dhe 8 leje infrastrukture të evidentuara në tabelën e mëposhtme:

Tabelë: Aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2023-31.12.2024

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	19	12	2
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ²	11	6	5
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	2	1	1
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. deri në 250 m ²	6	3	3
Leje ndërtimi për shtesë në nd. ekzistues me sip. më të madhe se 250 m ²	2	2	0
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	33	16	17
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	16	9	7
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	128	53	75
Leje rind., rikonst. dhe ripar. të nd. së dëmtuar pa shtim apo ndrysh. funk.	1	-	1
Çertifikatë përdorimi	13	7	6
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	3	2	1
Leje për ndryshim funksioni	1	1	-
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	1	1	-

Njoftim fillim punimesh	29	21	8
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	4	1	3
Leje infrastrukture	8	7	1

Burimi: Bashkia Gjirokastrë

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Urbanistikës (këtu e në vazhdim DU e Bashkisë Gjirokastrë, si dhe në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit, janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e evidentuara në tabelën e mëposhtme:

Tabelë – Rastet e audituara

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratar	Prevetivi
Leje ndërtimi				
1	_Konstruksioni i tregut lokal Rom, Gjirokastrë-Roma On Market	Bashkia Gjirokastrë	12.01.2024	18,831,196 lekë
Çertifikata përdorimi				
1	Shtesë kati mbi objekt ekzistues, Papafingo	G. A.	13.06.2023	1,458,551 lekë
2	Godinë në funksion të agroturizmit 2 kate + 1 kat bodrum	J. B.	15.11.2023	42,499,138 lekë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në lidhje me auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe të çertifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

➤ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejes të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se tre raste, dokumentacioni teknik, shoqëruar, i nevojshëm, si dhe i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi miratar me Vendim nr. 04, datë 12/01/2024, për objektin “Konstruksioni i tregut lokal Rom, Gjirokastrë-Roma On Market”, me adresë Gjirokastrë, me subjekt zhvillues Bashkia Gjirokastrë, me problematika si më poshtë vijon:

- Policat e sigurimit të përgjegjësive profesionale për: **i.** hartuesin e projektit arkitektonik është jashtë afatit të mbulimit (afati i mbulimit për këtë policë është 12.05.2022 – 11.05.2023); **ii.** hartuesin e projektit konstruktiv (afati i mbulimit për këtë policë është 14.04.2022 – 14.04.2023); **iii.** hartuesin e projektit elektrik (afati i mbulimit për këtë policë është 09.04.2022 – 28.04.2023); **iv.** hartuesin e projektit hidraulik dhe mbrojtjes ndaj zjarrit (afati i mbulimit për këtë policë është 05.11.2021 – 04.10.2022), në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi (05.01.2024). Këto veprime nuk janë në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika g);

- Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç).

2. Çertifikatë përdorimi miratar me Vendim nr. 54, datë 13/06/2023, për objektin “Shtesë kati mbi objekt ekzistues, Papafingo”, me adresë në lagjen “18 Shtatori”, Bashkia Gjirokastrë, me subjekt zhvillues z. G. A., me problematika si më poshtë vijon:

- Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/1, pika 1. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar elektronikisht në sistemin e-lejet konstatohet se mungon një nga aktet e kontrollit: “1. Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, të ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik”;

- Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane, kjo jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);
- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, veprim ky jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika gj).

3. Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. 127, datë 15/11/2023, për objektin “Godinë në funksion të agroturizmit 2k + 1 kat bodrum”, me adresë në Golem, Bashkia Gjirokastrë, me subjekt zhvillues znj. J. B., me problematika si më poshtë vijon:

- Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/1, pika 1. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar elektronikisht në sistemin *e-lejet* konstatohet se mungon një nga aktet e kontrollit: “1. Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, të ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik”;
- Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane, kjo jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);
- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, veprim ky jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika gj).

Për miratimin e lejes të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, si dhe vlerësimit pozitiv të praktikës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi:

- **Z. F. G.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë (për rastet 1, 2 dhe 3);
- **Znj. B. D.**, në cilësinë e drejtorit të DU (për rastin 1, 2 dhe 3);
- **Znj. A. I.** në cilësinë përgjegjës sektori të projekteve të DU (për rastet 1, 2 dhe 3);
- **Z. E. L.**, në cilësinë e përgjegjës sektori shërbimet urbane të DU (për rastin 2 dhe 3);
- **Z. F. M.**, në cilësinë e përgjegjës sektori projektimit të DU (për rastin 1).

7 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.

- 7.1.** Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.
- 7.2.** Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.
- 7.3.** Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërin e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 3, kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga:

- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Njësisë Vendore përkatëse;
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.³⁷

Për vitin 2023-2024 IMTV, Bashkia Gjirokastrë ka funksionuar e plotë sipas strukturës së miratuar me Urdhrin nr. 730, datë 14.12.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastrë”, si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i arsimit/dega	Data emërimit në detyrë	Aktualisht në punë apo larguar, data
	E. S.	K/Inspektor	Matematikë/Fizikë	10.09.2021	Në punë
	A. M.	Inspektor	Arkitekt/Urbanist	21.04.2020	Në punë
	K. N.	Inspektor	Kontabilitet/Financë	25.03.2022	Në punë
	G. Z.	Inspektor	Biologji/Kimi	10.12.2024	Në punë

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale IMTV Bashkia Gjirokastrë, sipas evidencave të vëna në dispozicion për periudhën objekt auditimi rezulton se janë mbajtur procesverbalet e konstatimit të shkeljeve në punimet e ndërtimit të hartuara nga IMTV, vendimet e marra nga kryeinspektori për pezullimin e punimeve të ndërtimit, vendimet e gjobave dhe vendimet e prishjeve për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi. Në formë table paraqiten vendimeve të marra nga IMTV për vitin 2023-2024 si vijon:

Nr.	Lloji i aktit	2024
1	PV/Akte kontrolli	8
2	PV/Akte konstatimi	10
3	Vendime gjobe	10
4	Vendime pezullimi	10
5	Vendime prishje	10
6	PV ekzekutimi të prishjeve	1
7	Kallëzime penale	-
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	10
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	-
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	1
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	4

Burimi: Bashkia Gjirokastrë

Nga auditimi rezultoi se IMTV, Bashkia Gjirokastrë për periudhën 01.01.2023 deri me 31.12.2023 dhe 01.01.2024 deri në 31.12.2024 ka miratuar planin vjetor të punës si dhe ka miratuar planet mujore për periudhën objekt sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Gjirokastrë për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si vijon:

Nr	Subjekti	Vendimi		Arsyeja/Shka ku i gjobës	Vlera e gjobës	Situata aktuale e gjobës			
		Nr	Data			Likui duar	Proces gjyqësor	Pa likuiduar	Kamatë vonesa
1	E. H	14	15.01.2024	Ndërtim pa leje	500,000		po		

³⁷ Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4.

2	Z. M.	15	22.01.2024	Ndërtim pa leje	500,000		po		
3	V. L.	16	29.01.2024	Ndërtim pa dokumentacion	50,000		jo		
4	A. dhe P. K.	17	05.02.2024	Ndërtim pa leje	500,000		po		
5	S. R.	18	29.02.2024	Dalje jashtë projektit	500,000		po		
6	A. P.	19	11.04.2024	Ndërtim pa leje	500,000		po		
7	H. C.	20	07.05.2024	Ndërtim pa leje	500,000		po		
8	D. A.	21	06.06.2024	Ndërtim pa leje	500,000		po		
9	R. S.	22	14.10.2024	Ndërtim pa leje	1,000,000		po		
10	A. dhe P. K.	23	13.11.2024	Ndërtim pa leje	1,000,000		po		

Nga auditimi i dokumentacionit që administrojnë IMTV-ja në Bashkinë Gjirokastrë u konstatua se për vitin 2024 janë vendosur 10 masa “Dënim me gjobë”. Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2024 është 6,550,000 lekë. Nuk është paguar në mënyrë vullnetare asnjë nga gjobat e vendosura. Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me hapat ligjore që janë marrë nga IMTV Gjirokastrë për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave rezultoi se, ka filluar procesi për të arkëtuar gjobat që nuk janë paguar në mënyrë vullnetare nga kundërvajtësit brenda afateve ligjore. Të gjithë kundërvajtësit janë njoftuar për detyrimin që kanë si rezultat i shkeljes që është konstatuar nga IMTV. - Janë në proces gjyqësorë 9 vendime në vlerë 6,500,000 lekë. Edhe pse nga ana e IMTV janë bërë përpjekje për të rritur nivelin e arkëtimit të gjobave, rezultoi se masat e marra kanë qenë të vonuara dhe ende nuk kanë dhënë rezultat e duhura, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, neni 9 “Vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarimor, sipas këtij ligji”, neni 22, pika 1, “Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligji”, neni 3, pika 5 “Kur gjopa dhe detyrimet e tjera të parashikuara në vendimin për kundërvajtjen administrative nuk paguhen ose nuk nxirren dot nga paga, ato nxirren duke vënë sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit për kundërvajtje administrative, qoftë edhe sikur ajo të ndodhet në dorën e personave të tjerë”. Gjithashtu, rezultoi se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë.

Referuar ligjit nr. 127/2024, “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024 nga inspektoratet vendore të mbrojtjes së territorit, inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit, autoriteti kombëtar i ushqimit, inspektorati shtetëror shëndetësor, si dhe policia e shtetit e policia bashkiake”, ku neni 1 përcakton:

Shfuqizohen të gjitha masat administrative të pa ekzekutuara deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, të vendosur nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit...

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2024 deri më 31.12.2024 gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, IMT Bashkia Gjirokastrë, ka marrë 10 vendime për prishje objektesh pa leje. Referuar tabelës më poshtë rezultoi se nuk është ekzekutuar vullnetarisht asnjë vendim si dhe nuk është ndërmarr asnjë procedurë, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

Nr.	Emri Subjektit	Lloj objektit	Vendimi
-----	----------------	---------------	---------

	(Shoqëria)		Nr.	Datë
1	E. H.	Platformë betoni dhe muraturë tulle	58	15.01.2024
2	Z. M.	Mur me blloqe betoni	59	22.01.2024
3	V. L.	Tendë me konstruksion metalik	60	29.01.2024
4	A. dhe P. K.	Skeleri si dhe armaaturë druri pa hekur dhe pa beton	61	05.02.2024
5	S. R.	Çati e çuar mbi nivelin e miratuar në objekt	62	29.02.2024
6	A. P.	Soletë me konstruksion metalik dhe beton	63	11.04.2024
7	H. C.	Mur me blloqe betoni	64	07.05.2024
8	D. A.	Gropë septike	65	06.06.2024
9	R. S.	Mbyllje fasade	66	14.10.2024
10	A. dhe P. K.	Ndërtim solete anësore dhe kolona betoni për vazhdim kati	01	13.11.2024

Burimi: IMT Bashkia Gjirokastrë

7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

7.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me vendimin nr. 163., datë 09.08.2024 i ka dërguar Bashkinë Gjirokastrë, “Raportin përfundimtar”, për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar zbatimin e masave të mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

I. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j, Bashkia Gjirokastrë duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Gjirokastrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, ka hartuar programin e punës me shkresën me nr. 7552 prot., datë 28.08.2024 në bazë të Urdhërit nr. 625, datë 28.08.2024 me objekt “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar vendimit nr. 163., datë 09.08.2024, është dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Gjirokastrë **nuk ka kthyer përgjigje** në KLSH mbi veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve dhe strukturat përgjegjëse.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit janë rekomanduar gjithsej:

a.9 masa organizative, pranuar nga subjekti;

b.2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 183,969,063 lekë, pranuar nga subjekti;

c.1 masa disiplinore, pranuar nga subjekti;

Në mënyrë të detajuar Zbatimi i rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gjirokastrë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim, nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, nuk janë përcaktuar rregulla të shkruara për llojet e raporteve që duhet të përgatiten nga menaxherët kryesor, me qëllim njohjen e titullarit nëpërmjet raporteve shkresore me situatën e të ardhurave, debitorët e probleme të tjera të menaxhimit të veprimtarisë së institucionit, nuk është hartuar regjistri i riskut, si dhe nuk janë hartuar aktivitetet e kontrollit për zvogëlimin e riskut të parashikuar, lista e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori.

Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohen me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 8, pika 8, germa “b”, neni 15, pikat 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 21, pika 2, neni 27, pikat 1-2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, pika 2.2.4, nënpikat 1-5, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli II, pikat 2.2.6., 2.5.2., Kapitulli III, pikat 3.1. dhe pika 3.2., hapi 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 18-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë të merren masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, me urdhrin nr. 2582, datë 03.04.2025 është miratuar Regjistri i Riskut, në Bashkinë Gjirokastrë.*

Rekomandimi është zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Gjirokastrë, u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit për zërin shpenzime nga vlera 1,435,644 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 1,156,416 mijë lekë ose 80.5, për shkak të mosrealizimit të shkaqeve që kanë shkaktuar të njëjtat situata në vitet e mëparshme, për mosrealizim të të ardhurave dhe për planifikim të investimeve pa hartuar më parë projektet përkatëse.

Nga auditimi, u konstatua se në hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit nuk është specifikuar ndarja dhe mënyra e financimit, se sa përqind e vlerës do të mbulohet me fondet e veta, sa nga buxheti i shtetit dhe sa me fonde të tjera.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 50-51 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 3, pika 2; pika 101 dhe 102 të UMFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; neni 47 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenet 79 -80 -81 dhe pikat 8 dhe 184 të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, si dhe

pikën 15 në UMFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe UMF nr. 5, datë 27.12.2014 ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.5.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse dhe të ardhurave fiskale.

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Rekomandimi është i pazbatuar.

2.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike në Bashkinë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, në mënyrë që të realizohen të gjitha procedurat e prokurimit për punë publike në shërbim të komunitetit, të marrin masa që në asnjë rast të mos parashikohen prokurime për punë publike pa pasur paraprakisht të disponueshëm projektin përkatës, me të gjitha detajet sipas përcaktimeve në legjislacionin e fushës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Rekomandimi është i pazbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Gjirokastër informacionin tatimor e përpunon në programin EXCEL. Mungesa e një sistemi IT bashkëkohor për të ardhurat vendore, sjell vështirësi në administrimin e informacionit tatimor nga ana e DAV, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, regjistrimin e gjobave dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit etj.;

Bashkia Gjirokastër nuk ka pasur bashkëpunim me ASHK, Drejtoria Vendore Gjirokastër për të marrë informacion mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastër me vlerën e përlllogaritur. Deri në datën 31.12.2023 rakordimet me ASHK Vendore Gjirokastër për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme dhe me DRSHTRR për mjetet e regjistruara nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MFE;

Bashkia Gjirokastër nuk ka regjistruar në paketën fiskale të saj si burim të ardhurash, “rentën minerare” dhe në mungesë të informacionit, DAPPLL nuk ka bërë as akt rakordimet me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në moszbatim të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 7 datë 014.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar; (referuar edhe “Miratimi i vlerave referuese” nga Ministria e Financave nr. 16365 prot., datë 17.10.2012 dhe Vendimi i Komisionit AD-HOC për rentën minerare).

Nga auditimi u konstatua se në Rregulloren e brendshme të institucionit, nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë, mbajtjen e aktrakordimeve me ta dhe krijimin e një databaze me të dhënat përkatëse nga agjentët;

Nga analiza e planifikimit të të ardhurave dhe e realizimit të tyre për vitin 2023, rezultoi si më poshtë:

- TNI për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 4,000 mijë lekë dhe është mundur të vilet 4,464 mijë lekë ose 112% e vlerës së planifikimit, me një rënie prej 246 mijë lekë më pak se në vitin 2022;

- Taksa e rentës minerare, nuk është parashikuar për dy vite radhazi 2022 dhe 2023, dhe rezulton se nuk është vjelë për asnjë vit. DAPPLL nuk e ka ndjekur arkëtimin e saj nga subjektet duke mos bërë rakordimet me Drejtorinë e Doganës dhe Drejtorinë e Tatimeve.

- Taksa e kalimit të pronësisë për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 724 mijë lekë dhe realizuar në shumën 477 mijë lekë ose në masën 66%. Duhet theksuar se për vitin paraardhës 2022 vlera e arkëtimeve nga kjo taksë për llogari të Bashkisë Gjirokastër ka qenë më e lartë në shumën 3,489 mijë lekë;

- Leje shfrytëzim karburanti është parashikuar në shumën 2,000 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 650 mijë lekë ose në masën 33%, por rezulton se krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rënie në shumën 350 mijë lekë;

- Qira tregu Agro ushqimor është parashikuar 2,292 mijë lekë dhe janë arkëtuar 1,603 mijë lekë ose në masën 70%, por krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje në shumën 889 mijë lekë;

- Qira tokë bujqësore është parashikuar 757 mijë lekë dhe realizuar në shumën 545 mijë lekë ose në masën 72%, por krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje prej 148 mijë lekë më shumë.

Mos realizimi i të ardhurave ka ardhur si rezultat i mungesës së analizave periodike dhe vjetore mbi mosrealizimin tyre, mosraportimit nga ana e strukturave përgjegjëse të planifikimit vjetor e çdo takse/tarife përkatëse për hartimin e paketës fiskale të vitit pasardhës, mungesës së bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes strukturave përgjegjëse që sigurojnë të ardhura duke mos u administruar në kohë informacioni tatimor nga ana e DAPPLL.

Nga Titullari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk ka asnjë analizë të situatës së tre subjekteve që janë pajisur me leje për tregëtim karburanti dhe hidrokarbure: “Alikondërtim”, “F.” dhe “EidaGjirokastër”, Ura e Lumit, për marrjen e masave me qëllim zgjidhjen shteruese të ngërçit të krijuar nga mospagesat e kryera prej tyre, dhe për subjektin “K.”, Shtepëz, i cili ushtron aktivitetin e vet te territori i braktisur nga subjekti “F.” për të cilin nga auditimi dhe komunikimi me DAPPLL, rezulton informacion jo i plotë dokumentar mbi praktikën e dhënies së lejes për ushtrimin e aktivitetit për periudhën nga 2020 e në vijim, mosveprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, (konstatuar edhe nga grupi i auditimit të mëparshëm, për të cilin është lënë dhe rekomandim).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, të marrë masat për implementimin e programeve kompjuterike si pjesë e rëndësishme infrastrukurore, për mirëadministrimin e informacionit tatimor dhe për të maksimizuar vjeljen e taksave; kjo duke krijuar një regjistër elektronik që të përmbajë gjithë të dhënat e tatimpaguesve, me të gjitha detyrimet të klasifikuara sipas kategorisë së detyrimit, kohës së krijimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, për një menaxhim në kohë reale të informacionit;

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Sipas mbledhjes së Komitetit Drejtues midis bashkive dhe Ministrisë së Financave të realizuar në datën 04 Mars 2025 është diskutuar mbi planin e ministrisë së financave për ngritjen e një sistemi të unifikuar të mirëadministrimit të taksave dhe tarifave vendore.*

Rekomandimi është në proces zbaimi

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, GMS në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve e Licencave të marrin masa për:

- Planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik;

- Të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimorë sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Gjirokastrë nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimorë nuk realizojnë dhe pasqyrojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Gjirokastrë të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura;

- Të bëjnë pjesë të Paketës Fiskale “të ardhurat nga renta minerare”, si e ardhur në buxhetin e bashkisë nga aktiviteti që ushtrohet në territorin e saj për shfrytëzimin e mineraleve.

- Të caktojë në strukturën e DAPPLL një person përgjegjës për të lidhur marrëveshjet me ato institucione të cilat do të jenë në rolin e agjentit tatimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Rekomandimi është i pazbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale, rezultoi se janë pajisur me certifikata pronësie 10 aktive/pasuri, të llojeve kullotë, pyll, truall dhe ndërtesë, për të cilat u konstatua se pavarësisht regjistrimit në AShK, nuk është bërë vlerësimi dhe kontabilizimi i tyre.

Nga auditimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, rezultoi se llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje, kullota dhe plantacione*”, 212 “*Ndërtesa dhe konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, nuk janë të analizuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, ku të specifikohet informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

Gjithashtu, nga Bashkia Gjirokastrë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë Aktiveve Afatgjata Materiale të transferuara në pronësi apo në përdorim ish komunave të konsoliduara aktualisht në Bashkinë Gjirokastrë.

Këto veprime janë në kundërshtim me neni 6, VKM-në nr. 510, datë 14.08.2001, “*Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu VI, pika 1 dhe 2, VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive*”, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, pikat 26-30, pika 35, gërmat “a”, “b” dhe “c”, pika 74 dhe Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”*”, Kreu II, pika 5, 36 dhe Kreu III, pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 38-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masat për vlerësimin dhe regjistrimin në kontabilitet të të gjitha Aktiveve Afatgjata Materiale, përfshirë asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Vlerësimi i

aseteve të bëhet për vlerën reale, sipas zonave kadastrale dhe të regjistrohen si pasuri e saj në ASHK, dega Gjirokastër.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, nëpërmjet shkresave me nr. 10280 port., datë 08.11.2024 dhe nr. 10280/1 prot., datë 19.11.2024 është realizuar komunikimi midis Drejtorisë së Financave dhe Drejtorisë së Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për regjistrimin e aktiveve në kontabilitet.*

Rekomandimi është në proces.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për hartimin e regjistrimit të aktiveve të Bashkisë me të gjitha kërkesat e formatit të miratuar, për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirëmenaxhimin e tyre.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, pas administrimit të regjistrimit të aktiveve të Bashkisë Gjirokastër, nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave me shkresën nr. 10280/1, datë 19.11.2024, Drejtoria e Financës ka hartuar regjistrin e aktiveve me të dhënat përkatëse.*

Rekomandimi është në proces.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkisë Gjirokastër, me VKM nr. 1684, datë 24.12.2008, Njesisë Administrative Cepo, me VKM nr. 244, datë 31.03.2011 dhe Njesisë Administrative Lazarat, me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunave, të Qarkut Gjirokastër”, i janë miratuar listat e inventarit të Pasurive Publike, ndërsa Njesisë Administrative Lunxhëri, me VKM nr. 567, datë 27.06.2013, Njesisë Administrative Picar, me VKM nr. 22, datë 12.01.2011, Njesisë Administrative Antigone, me VKM nr. 506, datë 13.07.2011 dhe Njesisë Administrative Odrie, me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunave të Qarkut të Gjirokastër”, i janë kaluar pronat publike në pronësi dhe përdorim.

Për pronat e transferuara si më sipër, nga Sektori i Lejeve, Licencave dhe Administrimit të Pronave Publike, nuk është bërë regjistrimi në ASHK, nuk janë inventarizuar, nuk janë vlerësuar, nuk janë kontabilizuar dhe nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale të këtyre pronave, sa nga këto prona janë të zëna, sa janë funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë, në kundërshtim me Ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 26 dhe 27 dhe VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 47-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër, të marrë masa që për Njësitë Administrative për të cilat është miratuar me VKM lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim, me qëllim përfundimin e procedurës së transferimit, si dhe për pronat të cilat janë transferuar, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për evidentimin, inventarizimin, vlerësimin dhe regjistrimin e pronave në ASHK. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Gjirokastër dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore, trojeve, etj., me qëllim krijimin e të ardhurave në dobi të komunitetit.

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, pas administrimit të regjistrave të aktiveve nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave me shkresën nr. 10280/1, datë 19.11.2024, Drejtoria e Financës ka hartuar regjistrin e aktiveve me të dhënat përkatëse.*

Rekomandimi është në proces.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

- Kryetari i Bashkisë Gjirokastër ka miratuar Planin e veprimeve “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit”, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 519/7 prot., datë 11.10.2023 dhe regjistruar me nr. 9728 prot., datë 12.10.2023 në Bashkinë Gjirokastër. “Plani i veprimit” është dërguar në KLSH me shkresën nr. 11761/1 prot., datë 21.12.2023 në tejkalim të afatit 20 ditor, gjë që ka ndikuar edhe në angazhimin e strukturave të ngarkuara me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- Në mospërputhje me nenin 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Gjirokastër ka kthyer përgjigje zyrtare në KLSH në tejkalim të afatit 20 ditor (pas 10 javësh) nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon “Planin e Veprimeve”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

- Bashkia Gjirokastër i është përgjigjur kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre. Sipas Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA. Nga auditim rezultoi se ky raportim nuk është bërë.

- Bashkia Gjirokastër nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak lidhur me “Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së”.

a. Masa Organizative janë lënë 28 Rekomandime që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat rikërkohen 17 masa: 13 pjesërisht të zbatuara dhe 4 të pazbatuara;

b. Masa shpërblim dëmi janë lënë 6 rekomandime në vlerën 29,655,464 lekë dhe rikërkohen në vlerën e plotë si të zbatuara pjesërisht 4 masa në vlerën totale 28,233,368 lekë dhe 2 masa të pazbatuara në vlerën 1,422,096 lekë ;

c. Masa me efekte negative të konstatuara në administrimin, menaxhimin pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë 10 masa (6 masa të rikërkua) nga të cilat rikërkohen 2 masa të pazbatuara dhe 2 masa zbatuar pjesërisht;

d. Masa për ulje të borxhit/të ardhura të munguara është lënë 1 masë në vlerën 181,012,983 lekë, e cila është në proces zbatimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 51-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 519/7 prot., datë 11.10.2023 dhe regjistruar në regjistrin e protokollit të bashkisë me nr. 9728 prot., datë 12.10.2023 si dhe Akt Verifikimit nr. 1 të datës 07.06.2024, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të atyre pjesërisht të zbatuara dhe të pazbatuara si vijon:

Menjëherë

A. Masa organizative

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastër, të kontabilizojë vlerën prej 59,718,570 lekë për detyrimet që kanë subjektet për taksa e tarifa vendore, qira tokash, qira objekti

dhe detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit, si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve, në vlerën 93,704,685 lekë.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të pa analizuar.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa që për Njësitë Administrative Gjirokastrë, Cepo dhe Lazarat të cilave nuk ju është kaluar me VKM lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, për përfundimin e procedurës së transferimit dhe për pronat të cilat janë transferuar të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ASHK. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Gjirokastrë dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore, trojeve me qëllim krijimin e të ardhurave në dobi të komunitetit.

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (*Njësia e Prokurimit*), për procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasë dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

11.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

12.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë të merren masa për:

- Të verifikuar të gjitha materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, rievimin e gjendjes ekzistuese të objektit dhe projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.

- Lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

- Të mos miratuar lejet e ndërtimit pa verifikuar që planvendosjen të jetë e plotë me të gjithë të dhënat e nevojshme të pasqyruara në të dhe konformë kushteve teknike të projektimit.

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së zhvillimit dhe çertifikatës së përdorimit, përpara miratimit të tyre.

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë, përpara miratimit të çertifikatës së përdorimit, të marrë masa për të verifikuar aktet e kontroleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

15/7.1. Rekomandimi (rikërkuar): Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimitit 'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të

shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullor të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

15/9.1. Rekomandimi (rikërkuar): Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masat që në të gjitha kontratat e furnizimit të mallrave, të caktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratës me qëllim garantimin e cilësisë së aktiveve të furnizuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e kërkuara. Gjithashtu të raportohet në APP për çdo rast mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.

15/11.1. Rekomandimi (rikërkuar): Komisionet e vlerësimit të ofertave dhe titullari i autoritetit kontraktor, të eliminojnë praktikën e shpalljes fitues të një operatori ekonomik, për më shumë se një procedurë, në rastet kur procedurat zhvillohen njëkohësisht si afat kohor dhe operatori ekonomik nuk plotëson të gjitha kriteret e DST për të dy procedurat njëkohësisht.

15/12.1. Rekomandimi (rikërkuar): Hartuesit e kriterëve të veçanta të DST dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrin masa që hartimi i kriterëve të jetë i argumentuar dhe të ketë lidhje të ngushtë midis tyre dhe objektit të kontratës.

15/18.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë, nëpërmjet strukturave përkatëse të llogaritjes së fondit limit, të marrë masa që në rastet e prokurimeve për karburant, të llogarisë saktë vlerën e fondit limit, për të mos angazhuar fonde buxhetore më tepër nga sa duhen, me qëllim shpërndarjen e fondeve në mënyrë proporcionale me nevojat reale sipas zërave buxhetor të shpenzimeve.

15/19.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë nëpërmjet strukturave përkatëse të hartimit të kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, të marrë masa që gjatë hartimit të tyre të bëhen argumentimet e duhura teknike dhe ligjore, me qëllim që çdo kriter i kërkuar të ketë lidhje të ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës.

15/21.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë nëpërmjet strukturave përkatëse të hartimit të specifikimeve teknike, të marrë masa për eliminimin e rasteve të cilat përmbajnë në specifikimet teknike të tenderit, përcaktime të markës, origjinës, si dhe përcaktime të tjera maksimale apo minimale, të cilat nuk janë të nevojshme dhe sjellin orientimin e ofertuesve drejt markave specifike prodhuese apo drejt distributorëve specifik të mallrave, kufizim të pjesëmarrjes së OE etj.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes Territorit, të marrin masa për pezullimin e lejen së miratuar për zhvillimin e punimeve dhe në bashkëpunim me ASHK-në Gjirokastrë, të zhvillojë verifikimin e përputhshmërisë të kufirit të pronësisë, në bazë të gjendjes aktuale në terren, sipas pozicionit gjeografik të saktë, duke mos cënuar aksesin e pasurive kufizuese dhe infrastrukturës rrugore.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se, është hartuar programi i punës me shkresën me nr. 7552 prot., datë 28.08.2024 dhe është ngritur Urdhëri nr. 625, datë 28.08.2024 me objekt "Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në raportin përfundimtar të auditimit të ushtruar në Bashkinë Gjirokastrë. Referuar masave organizative të sipërcituara do të konsiderohen të zbatuara pasi reflektimi i tyre është bërë në auditimin aktual, për të cilat janë mbajtur dhe akt konstatimet të cilat janë protokolluar në bashkinë Gjirokastrë më datë 16.06.2025.

Rekomandimi është zbatuar

B. Masa shpërblim dëmi

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për kontabilizim dhe

arkëtimin e vlerës prej **43,300 lekë** në ngarkim të **JV “N.” & “K.” ShPK**, si diferencë punimesh të pakryera në referencë të zërave të punimeve të preventivit.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa, të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të zbatuara në vlerën **7,831,423 me TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve në situacionin pjesor nr. 5, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore. Gjithashtu nëse deri në fazën e mbylljes së punimeve këto zëra nuk realizohen të kërkohet arkëtimi i vlerës së punimeve të likuiduara por të përealizuara.

Për 2 masa shpërblim dëmi me vlerë 1,422,101 lekë si vijon:

15/1.1. Rekomandimi (rikërkuar): Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Zhvillim Territorit, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që janë jo me fondet e Bashkisë Gjirokastrë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,125,649 lekë**, respektivisht:

-Vlera **1,121,650 lekë**, për investimin në objektin “Rikonstruksioni i Rrjetit të Furnizimit me Ujë dhe Sistemit të Kanalizimeve në Qytetin e Gjirokastrës” me vlerë preventivi prej 1,121,650,665 lekë.

-Vlera **3,999 lekë**, për investimit në objektin “Rikonstruksioni i Shkollës së Bashkuar” me vlerë preventivi 3,999,401 lekë.

15/2.1. Rekomandimi (rikërkuar): Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Gjirokastrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **296,447 lekë pa TVSh** nga OE “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 520 prot datë 18.01.2021, me objekt “Rikonstruksion i fushës së vjetër”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera.

Gjithashtu të fillojë procedura e dhënies së masave disiplinore sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Për 2 Masa për shpërblim dëmi në vlerën totale 20,358,645 lekë si vijon:

15/1.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **17,195,325 lekë pa TVSh** nga BOE “B.” ShPK & “A.” ShPK & “M.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4803 prot., datë 22.06.2020, me objekt: “Ujësullësi Lazarat”. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

15/2.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,163,320 lekë pa TVSh** nga BOE “N.” ShPK & “S.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11585 prot datë 15.10.2021 me objekt: “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në Kodrën e Çafkës pranë rrugës nacionale Gjirokastrë-Kakavi”.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se, Njëpërmjet shkresave nr 4046, datë 26.04.2023, nr. 4046/1, datë 26.04.2023, nr 4046/2, datë 26.04.2023 janë lajmëruar subjektet për shlyerjen e detyrimeve (bashkënjgitur shkresat). Njëpërmjet shkresës nr 4692, datë 19.05.2023 jemi njoftuar nga Sektori Juridik se ndaj Drejtorisë së Financës kanë filluar procedurat e kërkesë padisë nga subjekti «E.» pranë Gjykatës Administrative Gjirokastrë. Drejtoria e Financës njëpërmjet shkresës nr 4692/1 datë 22.05.2023, ka vendosur në dispozicion të Sektorit Juridik dokumentacionin mbështetës me qëllim kjo e fundit përfaqësimin e institucionit pranë Gjykatës Administrative Gjirokastrë.

Sektori i Raportimit Financiar pranë Drejtorisë së Financës ka realizuar kontabilizimin e subjekteve konkretisht BO «B.» shpk dhe «A.» shpk në vlerën 17,195,325 lekë pa TVSH, BOE «N.» shpk & «S.» shpk në vlerën 3,163,320 lekë pa TVSH, «E.» Shpk në vlerën 749,128 lekë.

Rekomandimi është Zbatuar pjesërisht

C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes Territorit, të marrin masa për pezullimin e lejeve të miratuara për zhvillimin e punimeve dhe në bashkëpunim me ASHK-në Gjirokastrë, të zhvillojnë verifikimin e përputhshmërisë të kufirit të pronësisë, në bazë të gjendjes aktuale në terren, sipas pozicionit gjeografik të saktë, duke mos cënuar aksesin e pasurive kufizuese dhe infrastrukturës rrugore.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, Sektori i Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike të marrë masa që të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim listat me vlerat e qirave të papaguara dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin nga 24 fermerë të vlerës **1,072,105 lekë**.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve njerëzore të marrë masa për ristrukturimin e Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit me personel të kualifikuar arsimorë sipas deponitave ligjore.

3.2. Rekomandimi: IMTV Gjirokastrë të marrë masa për:

- Kryerjen e kontrolleve në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga Kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike.

- Të kryejë kontrolle mbi zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi për të kontrolluar nëse objekti po ndërtohet në përputhje me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik.

- Marrjen e masave për arkëtimin e penalitetit në masën 2% për çdo ditë vonese në shumën 900,000 lekë ndajë 2 subjekteve të cilat nuk kanë likuiduar në afat, respektivisht: “E. H.” në shumën **300,000 lekë** dhe subjektin “M., G.” në shumën **600,000 lekë**.

- Për të gjitha rastet e shkeljeve të lejes së ndërtimit të kërkohet heqjen e licencës profesionale, personale ose të shoqërisë.

- Të raportojë në IKMT në mënyrë periodike mbi aktivitetin e tij, përkatësisht mbi gjobat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshëm.

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, është hartuar programi i punës me shkresën me nr. 7552 prot., datë 28.08.2024 dhe është ngritur Urdhëri nr. 625, datë 28.08.2024 me objekt “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në raportin përfundimtar të auditimit të ushtruar në Bashkinë Gjirokastrë. Referuar masave organizative të sipërcituara do të konsiderohen të zbatuara pasi reflektimi i tyre është bërë në auditimin aktual, për të cilat janë mbajtur dhe akt konstatimet të cilat janë protokolluar në bashkinë Gjirokastrë më datë 16.06.2025.*

Rekomandimi është në proces zbatimi

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i subjekteve të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, u konstatua se: 15 subjekte kanë kryer pagesë të plotë të detyrimit deri në datën 31.12.2022 në vlerën totale 14,400,000 lekë; 2 subjekte, “E. Gjirokastrë” dhe K., e zhvillojnë aktivitetin e tyre në 2 vendndodhje të ndryshme (kanë 2 pika shitje karburanti) dhe kanë bërë pagesë të pjesshme të detyrimit deri në datën 31.12.2023, në vlerën totale 550,000 lekë për një prej pikave, nëpërmjet Akt Marrëveshjeve të lidhura me Bashkinë Gjirokastrë; “K.”, Shtepëz në vitin 2020 ka nisur aktivitetin e tij në territorin dhe mjetet e instaluar teknike të aktivitetit që

ka patur subjekti “F.”;

- për subjektet “F.”, Shtepëz dhe “E.”, Ura e lumit, nga ana e DAPPLL nuk ka informacion mbi detyrimin referuar lejes së përfituar, pasi i përkasin periudhës 2015-2020 dhe 2018-2023 në të cilën përfshihen edhe ndryshimet ligjore mbi procedurat e pajisjes me leje subjekteve që tregëtojnë karburante dhe hidrokarbure dhe të lëvizjes së shpeshtë të personelit brenda strukturës së Drejtorisë gjatë kësaj periudhe;

- subjekti “A.” nuk ka paguar dhe nuk e njeh detyrimin prej 1,000,000 lekë;

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga DAPPLL rezulton se vetëm për 3 subjekte “E.”, “K.” Shtepëz dhe “A.” detyrimi në vlerën totale është 3,450,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë; ndërsa për 2 subjektet “E.” dhe “F.” nuk ka informacion mbi detyrimin e tyre ndaj Bashkisë Gjirokastrë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve e Liçencave, të analizojnë situatën specifike të subjekteve “E.”, “K.” dhe “A.” dhe të marrin masa për arkëtimin e vlerës 3,450,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë.

Për subjektet “F.”, Shtepëz dhe “E.”, Ura e lumit, të saktësojnë vlerën e detyrimit dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të njohur dhe paguar prej tyre vlerën e plotë të detyrimit për llogari të Bashkisë Gjirokastrë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, gjatë vitit 2024 në Bashkinë Gjirokastrë ushtrojnë aktivitet 4 pika karburanti të cilave ju ka mbaruar afati i licencimit, më hollësisht trajtuar në akt konstatimet nr. 4 protokolluar në Bashkinë Gjirokastrë më datë 16.06.2025.*

Rekomandimi është në proces zbatimi

D.MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve nga taksat dhe tarifatat vendore që kanë ndaj Bashkisë Gjirokastrë, u konstatua se deri në datën 31.12.2022, borxhi tatimor ka qenë 182,468,723 lekë për 17,584 debitorë. Vlera debitorë e krijuar gjatë vitit 2023 ka qenë 60,042,603 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive deri në datën 31.12.2023, janë 180,519,063 lekë për 19,811 debitorë, nga e cila janë kontabilizuar vetëm 15,931,835 lekë dhe vlera **166,587,228 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë.

Grupi i auditimit ka vlerësuar se detyrimi (progresiv) deri në datën 31.12.2023 për disa nga taksat dhe tarifatat vendore kryesore përbëhet si më poshtë:

- Detyrime nga abonentët familjarë, në vlerën 91,715,152 lekë për 11794 debitorë;
- Detyrime nga kategoria biznes, në vlerën 66,440,562 lekë për 965 debitorë;
- Detyrime nga taksa e tokës bujqësore, në vlerën 19,362,272 lekë për 6922 debitorë;
- Detyrime nga TNI, në vlerën 1,903,345 lekë për 85 debitorë;
- Detyrime mbi dhënien me qira të tokave bujqësore, në vlerën 1,097,732 lekë për 45 debitorë;
- Debitorë problematikë (92), në shumën progresive 23,104,873 lekë.

(vlera e debitorëve problematikë është përfshirë në secilën vlerë debitorë për taksa të ndryshme)

Në Bashkinë Gjirokastrë nuk janë zhvilluar takime të GMS, ku të trajtohen problematikat për

pa/mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3. dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Leje e Liçencave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e shumës progresive 180,519,063 lekë për 19,811 debitorë, veçanërisht ndaj nëntëdhjetë e dy (92) debitorëve problematikë për arkëtimin e shumës progresive 23,104,873 lekë.

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Leje e Liçencave të hartojë një plan masash periodik dhe vjetor për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuar me VKB si për familjarët dhe për biznesin, me qëllim parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj;

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se, gjatë vitit 2024 vlera debitorë është trajtuar më gjerësisht në akt konstatimet nr. 4 protokolluar në Bashkinë Gjirokastrë më datë 16.06.2025.*

Rekomandimi është në proces zbatimi

E. MASA DISIPLINORE

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja rekomandohet dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit dhe **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë**, fillimi ose jo i procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu IV, neni 11, shkronja “e” dhe “ç” dhe neni 37, bazuar në kontratën individuale të punës.

Nga verifikim rezultoi se ky rekomandim nuk është zbatuar.

- Konkluzione dhe rekomandime:

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Gjirokastrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me vendimin nr. 163., datë 09.08.2024, për masat të cilat janë cilësuar në proces zbatimi rikërkohet vazhdimi i procedurave dhe për masat e pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht KLSH rikerkon zbatimin e plotë të rekomandimeve, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse dhe të ardhurave fiskale.

2.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike në Bashkinë Gjirokastrë, në

bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, në mënyrë që të realizohen të gjitha procedurat e prokurimit për punë publike në shërbim të komunitetit, të marrin masa që në asnjë rast të mos parashikohen prokurime për punë publike pa pasur paraprakisht të disponueshëm projektin përkatës, me të gjitha detajet sipas përcaktimeve në legjislacionin e fushës.

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, GMS në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve e Licencave të marrin masa për:

- Planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik;

- Të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimorë sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Gjirokastër nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimorë nuk realizojnë dhe pasqyrojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Gjirokastër të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura;

- Të bëjnë pjesë të Paketës Fiskale “të ardhurat nga renta minerare”, si e ardhur në buxhetin e bashkisë nga aktiviteti që ushtrohet në territorin e saj për shfrytëzimin e mineraleve.

- Të caktojë në strukturën e DAPPLL një person përgjegjës për të lidhur marrëveshjet me ato institucione të cilat do të jenë në rolin e agjentit tatimor.

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 519/7 prot., datë 11.10.2023 dhe regjistruar në regjistrin e protokollit të bashkisë me nr. 9728 prot., datë 12.10.2023 si dhe Akt Verifikimit nr. 1 të datës 07.06.2024, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të atyre pjesërisht të zbatuara dhe të pazbatuara si vijon:

B. Për masat shpërblim dëmi të lëna në auditimet e mëparshme:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për kontabilizim dhe arkëtimin e vlerës prej **43,300 lekë** në ngarkim të **JV “N.” & “K.” ShPK**, si diferencë punimesh të pakryera në referencë të zërave të punimeve të preventivit.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa, të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të të zbatuara në vlerën **7,831,423 me TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve në situacionin pjesor nr. 5, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore. Gjithashtu nëse deri në fazën e mbylljes së punimeve këto zëra nuk realizohen të kërkohet arkëtimi i vlerës së punimeve të likuiduara por të perealizuara.

Për 2 masa shpërblim dëmi me vlerë 1,422,101 lekë si vijon:

15/1.1. Rekomandimi (rikërkuar): Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që janë jo me fondet e Bashkisë Gjirokastër, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,125,649 lekë**, respektivisht:

-Vlera **1,121,650 lekë**, për investimin në objektin “Rikonstruksioni i Rrjetit të Furnizimit me Ujë dhe Sistemit të Kanalizimeve në Qytetin e Gjirokastrës” me vlerë preventivi prej 1,121,650,665 lekë.

-Vlera **3,999,401 lekë**, për investimit në objektin “Rikonstruksioni i Shkollës së Bashkuar” me vlerë preventivi 3,999,401 lekë.

15/2.1. Rekomandimi (rikërkuar): Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Gjirokastër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **296,447 lekë pa TVSH** nga OE “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 520 prot datë 18.01.2021, me objekt “Rikonstruksion i fushës së vjetër”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera.

Gjithashtu të fillojë procedura e dhënies së masave disiplinore sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Për 2 Masa për shpërblim dëmi në vlerën totale 20,358,645 lekë si vijon:

15/1.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **17,195,325 lekë pa TVSh** nga BOE “B.” ShPK & “A.” ShPK & “M.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4803 prot., datë 22.06.2020, me objekt: “Ujësjetillësi Lazarat”. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

15/2.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,163,320 lekë pa TVSh** nga BOE “N.” ShPK & “S.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11585 prot datë 15.10.2021 me objekt: “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në Kodrën e Çafkës pranë rrugës nacionale Gjirokastrë-Kakavi”.

IV GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e nivelit të implementimit të komponentëve të MFK në Bashkinë Gjirokastrë, rezulton se strukturat përgjegjëse nuk kanë marrë masa për evidentimin e mangësive në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë; nuk është hartuar dhe miratuar “Gjurma e unifikuar e auditimit”. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa ‘b’; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 20. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 1, faqe 11-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, nëpërmjet Strukturave përgjegjëse, të marrin masa për të ngritur një sistem efektiv mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Strukturat drejtuese të ndjekin nivelin e implementimit të parimeve respektive sipas komponentëve të MFK për plotësimin e mangësive të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Auditit të Brendshëm për vitin 2023 dhe 2024, rezulton se kjo njësi ka funksionuar me **3** punonjës, nga të cilët përgjegjësi i njësisë dhe 1 specialist të pa certifikuar dhe një specialist në proces certifikimi. Po kështu, rezulton se nuk janë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnimet për kualifikimin profesional, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm”, neni 19 “Çertifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 1, faqe 11-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, nëpërmjet Njësisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa për vijueshmërinë e trainimeve vjetore për kualifikimin profesional, si dhe të kryejë procesin e certifikimit të audituesve të pacertifikuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksave dhe tarifave vendore rezulton se për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave është në vlerën 268,100 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 250,246 mijë lekë ose në masën 93% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në

vlerën 17,854 mijë lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave konstatohet se:

- Për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta si:

taksa mbi tokën bujqësore në masën 70%, taksa e fjetjes në hotel masën 64%, tarifa e reklamës në masën 75%, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në masën 69%, leje transporti në masën 46%, leje taksi në masën 21%, leje për tregti hidrokarburesh masën 52%, tarifa për vërtetime në masën 35%, vendim shesh ndërtimi në masën 57%, kërkesë leje ndërtimi në masën 40%, certifikatë përdorimi në masën 15%, Qira trualli në masën 37%, Qira toke bujqësore në masën 42%, Gjoha në masën 68%.

- Për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin në masa të konsiderueshme si:

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin në masën 209%, Tatim nga shitja e pasurive të paluajtshme në masën 126%, Certifikate transporti në masën 247%, Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura në masën 129%, Tarifë zënie hapësire publike në masën 655%, Tatimi mbi të ardhurat personale në masën 152%, Tarifë gjelbërimi në masën 153%, Tarifë për qira objektësh në masën 271%, Tarifa nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri në masën 187%, Tarifë regjistrimi në masën 134%, Tarifë për ujë për vaditje në masën 176%.

Ky fakt tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është bërë mbi baza reale dhe realizimi i viteve të mëparshme nuk është marrë në konsideratë në planifikim. Gjithashtu për një pjesë të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 5/a, dhe 6. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2, faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP) të marrë masa që në planifikimin e të ardhurave të marrë në konsideratë realizimin faktik të vitit paraardhës dhe të kryejë procedurat për përfshirjen e gjithë kapaciteteve tatimore në planifikim

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Gjirokastër rezulton se llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 50,998,526 lekë. Nga analiza e kësaj llogari konstatohet se nuk është bërë përditësimi dhe rakordimi midis Drejtorisë së Financave dhe Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP) pranë bashkisë, ku gjendja debitore e pa kontabilizuar është në vlerën 146,065,114 lekë, si dhe nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkitimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP), të marrin masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore gjendje 31.12.2024, në vlerën 146,065,114 lekë.

-Drejtorja e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitore.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Gjirokastër, rezulton se llogaria 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 42,957,758 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5% të ngurtësuar në Degën e Thesarit Gjirokastër. Drejtoria e financës nuk ka marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin sipas

aneksit nr. 8 pika 3 raportit të auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.3. “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarie të të tretëve (klasa 4)” i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për të njoftuar të gjitha subjektet për paraqitjen e dokumentacionit për likuidim, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Deri më datë 31.12.2025

6. Gjetje nga auditimi: Në 4 (katër) raste, nga auditimi në SPE dhe dosjet fizike për procedurat e prokurimit me objekt:

- “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara Loti 2”,
- “Rehabilitim në segmente të ndryshme rrugore”,
- “Rivitalizim i hapësirave rreth pallatit të sportit Luftëtari”,
- “Sistem asfaltim rruga Taroninë Zhulat”, rezultoi se, projektet e zbatimit, janë hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës (sektori i projekteve), Bashkia Gjirokastër, nga disa Inxhinier pjesë e grupit të punës, **të pa pajisur me licencën e projektimit**. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 53-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa, që të gjithë projektet e zbatimit të hartohen nga Inxhinierë të pajisur me licencën përkatëse për projektim, ose në mungesë të inxhinierëve të licencuar, projektet e zbatimit t’i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik, duke siguruar hartimin me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në 5 (pesë) raste, nga auditimi i procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave për punë publike, u konstatua se, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Gjirokastër, nuk është kryer oponenta teknike për projektet e zbatimit me objekte:

- “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara Loti 2”,
- “Rehabilitim në segmente të ndryshme rrugore”,
- “Rivitalizim i hapësirave rreth pallatit të sportit Luftëtari”,
- “Rikonstruksion dhe përmirësimi i efikasitetit energjetic në shpellën “Muhamet Gjollesha”,
- “Sistem asfaltim rruga Taroninë Zhulat”.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 6, VKM nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve”, neni 41, pika 1, germa (c), si dhe Vendimin Nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponentës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 53-129 të Projekt Raportit të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa që të pajisë me Oponentë Teknike çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e tyre me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 13 procedurave të prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Gjirokastrë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024, me fond limit 387,392,128 lekë pa TVSh dhe vlerë kontratë 287,127,069 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në argumentimin e kriterëve dhe në vendosjen e kriterëve jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet si më poshtë:

- Tenderi me objekt: *“Rikonstruksion i pallatit të sportit Gjirokastrë”*, me vlerë kontrate 59,308,815 pa TVSh;

- Tenderi me objekt: *“Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”*, me vlerë kontrate 11,012,845 lekë pa TVSh.

- Tenderi me objekt: *“Konstruksion i tregut lokal Rom Gjirokastrë, Roma on Market”*, me vlerë kontrate 15,396,409 lekë pa TVSh.

- Tenderi me objekt: *“Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfaqës pranë rrugës nacionale Gjirokastrë Kakavie Loti 2”*, me vlerë kontrate 28,784,588 lekë pa TVSh.

- Tenderi me objekt: *“Rehabilitim i segmenteve të ndryshme rrugore”*. me vlerë kontrate 36,309,280 pa TVSH;

- Tenderi me objekt: *Karburant” Loti I Naftë benzenë dhe Loti II Lëndë djegëse për Kaldajën”* me vlerë kontrate 30,808,468 pa TVSH;

- Tenderi me objekt: *“Blerje mjete skrep”*, me vlerë kontrate 4,150,000 lekë pa TVSh;

- Tenderi me objekt: *“Rehabilitim në segmente të ndryshme rrugore”*, me vlerë kontrate 21,747,214 lekë pa TVSh;

- Tenderi me objekt: *“Rivitalizim i hapësirave rreth pallatit të sportit Luftëtari”*, me vlerë kontrate 16,732,275 lekë pa TVSh;

- Tenderi me objekt: *“Sistemim asfaltim rruga Tarininë Zhulat”*, me vlerë kontrate 46,695,844 lekë pa TVSh.

- Tenderi me objekt: *“Rikonstruksion dhe përmirësimi i efikasitetit energjetic në shpellën “Muhamet Gjollësia”* me vlerë kontrate 14,479,818 lekë pa TVSh.

- Në 6 procedura nga 13 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 163,199,764 lekë pa TVSh, ose 42% e fondit të procedurave të audituara u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Gjirokastrë, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, nenin 26 pikat 1, nenin 6; nenin 36, nenin 39, pika 5; nenin 45 pika 1; nenin 67, nenin 78, pika 4, nenin 82, paragrafi i fundit dhe nenin 85 *“Lidhja e kontratës”*, pika 2, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 53-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, të marrë të gjithë masat që nga njësitë e prokurimit të argumentohet vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe se këto kriterë të jenë në përputhje dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë publike në 1 (një) rast për investimin me objekt: *“Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastrë”* Bashkia Gjirokastrë, është lidhur kontrata për kryerjen e shërbimit të kolaudimit me nr. 7873 prot., datë 14.08.2024 ndërmjet Bashkisë Gjirokastrë, përfaqësuar nga zyrtari i Autorizuar i AK dhe OE *“F.”* SHPK, ndërkohë që punimet e ndërtimit për kontratën për punë publike kanë përfunduar më datë 16.04.2023, pra, rreth 15 (pesëmbëdhjetë) muaj me vonesë.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, nenet 12 dhe 15. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4/4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa që për çdo kontratë për punë publike, të emërojë kolaudatorin apo grupin e kolaudimit brenda 30 ditëve nga njoftimi i përfundimit të punimeve të ndërtimit, me qëllim kolaudimin e investimit në përputhje me projektin e zbatimit, me dokumentet e planifikimit të kontrollit dhe të zhvillimit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike dhe standardet shqiptare në fuqi ose standardet evropiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, dhe në përputhje me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, për pronat që i janë transferuar me VKM në pronësi dhe në përdorim Bashkisë Gjirokastrë, me VKM nr. 1684, datë 24.12.2008, Njesisë Administrative Cepo, me VKM nr. 244, datë 31.03.2011 dhe Njesisë Administrative Lazarat, me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunave, të Qarkut Gjirokastrë”, i janë miratuar listat inventarit, ndërsa Njesisë Administrative Lunxheri, me VKM nr. 567, datë 27.06.2013, Njesisë Administrative Picar, me VKM nr. 22, datë 12.01.2011, Njesisë Administrative Antigone, me VKM nr. 506, datë 13.07.2011 dhe Njesisë Administrative Odrie, me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunave të Qarkut të Gjirokastrë”, të kaluara në pronësi dhe përdorim. Për pronat e transferuara në pronësi Sektori i Lejeve, Licencave dhe Administrimit të Pronave Publike, nuk ka bërë regjistrimin e tyre në ASHK, nuk janë inventarizuar, nuk disponohet informacion në lidhje me gjendje reale të këtyre pronave, se sa prej tyre janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë, në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 5, faqe 132-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë të marrë masa të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë Gjirokastrë të kaluar me VKM, mbi gjendjen fizike, si dhe për hartimin e regjistrimit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar, me qëllim uljen e riskut të shpërdorimeve materiale të pasurive dhe mirë menaxhimin e tyre.

Gjithashtu, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, në përfundim të procesit të regjistrimit fizik të aktiveve të merrë masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e siguruar nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me kontratat e koncesionit sipas regjistrimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës 2023-2024, në territorin e Bashkisë Gjirokastrë, ushtrojnë aktivitet 3 (tre) subjekte kariere, për shfrytëzim “Mineral” dhe 4 (katër) subjekte në fushën e energjetikës, të cilat nuk paguajnë detyrime për aktivitetin që kryejnë, si dhe nuk administrohen dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj), respektivisht:

Subjektet që ushtrojnë veprimtari kariere në shfrytëzimin e “Mineraleve të ndryshme”

1. Subjekti “A.” pa NIPT, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1907, datë 21.01.2021, për shfrytëzimin e vendburimit Zhulat-Picar për llojin e mineralit litium dhe me sipërfaqen 1 km².

2. Subjekti “B.” me NIPT K.....S i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1168/1, datë 19.03.2008, për shfrytëzimin e vendburimit Lazarat për llojin e mineralit gëlqeror pllakor me sipërfaqen 0.032 km².

3. Subjekti "N." shpk me NIPT K.....D, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1931, datë 04.05.2022, për shfrytëzimin e vendburimit Lazarat për llojin e mineralit gëlqeror me sipërfaqen 0.808 km².

Subjektet që ushtrojnë veprimtari kariere në fushën e energjetikës "HEC"

- Hec L., administruar nga shoqëria koncesionare "L. & E." Shpk
- Hec Picar 1, administruar nga shoqëria koncesionare "P." Shpk
- Hec Langarica 3, Gostivisht, Ura e Dashit, administruar nga shoqëria koncesionare "I."shpk
- Hec Ferko 1,2, administruar nga shoqëria koncesionare "S." ShPK

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Neni 17, të Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për Fondin kullor", pikat 3, 7, 9,10,11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor". (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 5, faqe 132-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, të marrin masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullor të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se në 3 raste, dokumentacioni teknik dhe shoqëruet i projektit, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Miratimi i lejes së ndërtimit me Vendim nr. 04, datë 12/01/2024, për objektin "Konstrukcioni i tregut lokal Rom, Gjirokastër-Roma On Market", me adresë Gjirokastër, me subjekt zhvillues Bashkia Gjirokastër, mungon projekti arkitektonik në formatin DËG si dhe policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për: **i.** hartuesin e projektit arkitektonik (afati i mbulimit për këtë policë është 12.05.2022 – 11.05.2023); **ii.** hartuesin e projektit konstruktiv (afati i mbulimit për këtë policë është 14.04.2022 – 14.04.2023); **iii.** hartuesin e projektit elektrik (afati i mbulimit për këtë policë është 09.04.2022 – 28.04.2023); **iv.** hartuesin e projektit hidraulik dhe mbrojtjes ndaj zjarrit (afati i mbulimit për këtë policë është 05.11.2021 – 04.10.2022), në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi (05.01.2024) në Kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika g);

2. Miratimi i Certifikatës së përdorimit miratuar me Vendim nr. 54, datë 13/06/2023, për objektin "Shtesë kati mbi objekt ekzistues, Papafingo", me adresë në lagjen "18 Shtatori", Bashkia Gjirokastër, me subjekt zhvillues z. G. A., dhe Certifikatës së përdorimit miratuar me Vendim nr. 127, datë 15/11/2023, për objektin "Godinë në funksion të agroturizmit 2k + 1 kat bodrum", me adresë në Golem, Bashkia Gjirokastër, me subjekt zhvillues znj. J. B., rezulton se:

- Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht, pasi mungon një nga aktet e kontrollit: "1. Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, të ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik";
- Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane;
- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenet 27/1

dhe 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika gj). (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 143-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës, Bashkia Gjirokastrë, të marrë të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi:

- të verifikojë afatin e mbulimit të policave për të gjithë hartuesit e projekteve ndërtimore, në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje;
- të kërkojë plotësimin dhe saktësin e dokumentacionit të nevojshëm me aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit, të nënshkruar elektronikisht;
- të kërkojë plotësimin e dokumentacionit me aktin përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane;
- të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit me projektin përkatës për mirëmbajtjen e objektit, së bashku me afatet periodike.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Gjirokastrë, rezulton se për 5 raste, është mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, ndajë kundërvajtësve për të cilat vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar nga IMTV. *Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pika a dhe nenin 51 të ligjit 107/2017 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 143-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, të vijojë me vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi, ndaj personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndajë shkelësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

Bashkia Gjirokastrë ka respektuar afatin 20 ditor për përgatitjen e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve, dërguar me shkresën nr. 7552 prot., datë 28.08.2024, nuk ka kthyer përgjigje brenda gjashtë muajve, si dhe nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm. Nga auditimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, rezulton si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 9 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 9 masa. Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1 masë, në proces zbatimi 4 masa, zbatuar pjesërisht 1 masë dhe pa zbatuar 3 masa nga të cilat rekomandimi 2.1, 2.2 dhe 3.2 nuk rikërkohen pasi janë pjesë e gjetjeve të sipërcituara.

b. për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, është rekomanduar 1 masë në vlerën 3,450,000 lekë e cila është në proces arkëtimi.

c. Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, me efekt mungesë të ardhurash, janë rekomanduar 2 masa në vlerën **183,969,063** lekë të cilat janë në proces arkëtimi.

d. Është rekomanduar 1 masë disiplinore, ecila nuk është zbatuar. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 7, faqe 149-163, të Projekt raportit të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

a. Për 1 masë organizative

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 519/7 prot., datë 11.10.2023 dhe regjistruar në regjistrin e protokollit të bashkisë me nr. 9728 prot., datë 12.10.2023 si dhe Akt Verifikimit nr. 1 të datës 07.06.2024, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të atyre pjesërisht të zbatuara dhe të pazbatuara si vijon:

B. Për masat shpërblim dëmi të lëna në auditimet e mëparshme:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për kontabilizim dhe arkëtimin e vlerës prej **43,300 lekë** në ngarkim të **JV “N.” & “K.” ShPK**, si diferencë punimesh të pakryera në referencë të zërave të punimeve të preventivit.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të zbatuara në vlerën **7,831,423 me TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve në situacionin pjesor nr. 5, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore. Gjithashtu nëse deri në fazën e mbylljes së punimeve këto zëra nuk realizohen të kërkohet arkëtimi i vlerës së punimeve të likuiduara por të parealizuara.

Për 2 masa shpërblim dëmi me vlerë 1,422,101 lekë si vijon:

15/1.1. Rekomandimi (rikërkuar): Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që janë jo me fondet e Bashkisë Gjirokastër, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,125,649 lekë**, respektivisht:

-Vlera **1,121,650 lekë**, për investimin në objektin “Rikonstruksioni i Rrjetit të Furnizimit me Ujë dhe Sistemit të Kanalizimeve në Qytetin e Gjirokastrës” me vlerë preventivi prej **1,121,650,665 lekë**.

-Vlera **3,999,401 lekë**, për investimit në objektin “Rikonstruksioni i Shkollës së Bashkuar” me vlerë preventivi **3,999,401 lekë**.

15/2.1. Rekomandimi (rikërkuar): Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Gjirokastër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **296,447 lekë pa TVSh** nga OE “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 520 prot datë 18.01.2021, me objekt “Rikonstruksion i fushës së vjetër”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera. Gjithashtu të fillojë procedura e dhënies së masave disiplinore sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Për 2 Masa për shpërblim dëmi në vlerën totale 20,358,645 lekë si vijon:

15/1.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastër të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **17,195,325 lekë pa TVSh** nga BOE “B.” ShPK & “A.” ShPK & “M.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4803 prot., datë 22.06.2020, me objekt: “Ujësjellësi Lazarat”. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

15/2.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastër të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,163,320 lekë pa TVSh** nga BOE “N.” ShPK & “S.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11585 prot datë 15.10.2021 me objekt: “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në Kodrën e Çafkës pranë rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavi”.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja “b” dhe “c”, si dhe dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44,

datë 30/4/2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Gjirokastër), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit në vlerën totale **594,444 lekë pa TVSh**. Për këtë vlerë, Nëpunësi zbatues të ndjekë procedurat dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim arkëtimin e kësaj vlere, më konkretisht si mëposhtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit, të kontratës për punë publike me nr. 1363 prot., datë 13.02.2023, lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastër dhe BOE “E.” SHPK (50%) dhe OE “I.” SHPK (50%) me vlerë të kontratës 45,956,077.2 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 4 (katër) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Zëri 1 (3.138) Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3 me themele gjerësi, tok e zak, kategoria III, me shkarkim në tokë], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, në vlerën 110,000 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **110,000 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga BOE “E.” SHPK & “I.” SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1363 prot., datë 13.02.2023 me objekt “Rikonstruksion i rrugës Zhulat Gjirokastër Loti I”.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 4235 prot., datë 03.05.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastër dhe BOE “L.” SHPK (51.5%), dhe “E.” SHPK (48.5 %) me vlerë të kontratës 70,677,778.28 lekë me TVSH dhe afat të realizimit 4 (katër) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Zëri 3 (An-17) Prishje suvatim nga brenda mure; Zëri 3 (2.31) Suva mur tulle h-4m me krah, llaç përzier M25; Zëri 3 (Analizë) FV Kompiuter, përfshirë programin, i kompletuar për punë], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **173,012 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **173,012 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga BOE “L.” SHPK & “E.” SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 4235 prot., datë 03.05.2023 me objekt “Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastër”.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 11950 prot., datë 15.12.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastër, dhe shoqëria “L.” SHPK me vlerë të kontratës 34,541,506 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 5 (pesë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Suvatim me llaç çimento të perdes me pilota të Masës Inxhinierike Nr. 1; F.V Akacie 2 vjeçare bashkë me

mbushjen me dhe vegjetal], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë , në vlerën 142,200 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **142,200 lekë** pa TVSH përfituar padrejtësisht nga shoqëria “L.” SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 11950 prot., datë 15.12.2023 me objekt “Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastrë”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 11757 prot., datë 28.10.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastrë, dhe shoqëria “E.” SHPK me NIPT K.....P dhe, Lic. Nr. NZ. .../5, me vlerë të kontratës 10,549,810.8 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 77 ditë, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [*Zëri 4 (3.211 Shtresë cakulli mbeturinë kave t=20 cm për bankina*)], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë , në vlerën **60,000 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **60,000 lekë** pa TVSH përfituar padrejtësisht nga shoqëria “E.” SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 11757 prot., datë 28.10.2022 me objekt “Punime mirëmbajtje rruga e fshatit Zhulat”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 10732 prot., datë 10.11.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastrë dhe shoqëria “F.” SHPK me vlerë të kontratës 18,475,691 lekë me TVSH dhe, fat të realizimit të kontratës 7 (shtatë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [*Mur guri në lartësi deri 3m me llaç përzier M 15; F.V bordura betoni parafabrikat, 20x35 cm*], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë , në vlerën **109,232 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

5.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **109,232 lekë** pa TVSH përfituar padrejtësisht nga shoqëria “F.” SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 10732 prot., datë 10.11.2023 me objekt “Rikonstruksion i tregut lokal Rome Gjirokastrë “Roma on Market”.

Menjëherë

C.II. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të të dhënave të dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Agjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP) në Bashkinë Gjirokastër, rezulton se gjendja debitorë në fund të vitit 2023 është 180,824,397 lekë, dhe fund të vitit 2024 në shumën 161,996,949 lekë, e cila përbëhet nga, -detyrimet debitorë nga 845 subjekte të biznesit të madh e të vogël në shumën 16,960,106 lekë, detyrimet debitorë nga 11794 familje në shumën 44,833,026 lekë si dhe detyrime debitorë nga 3472 familje fermere për taksën e tokës në shumën 18,940,565 lekë.

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Gjirokastër për vjeljen e detyrimeve janë mjaftuar vetëm me nxjerrjen e njoftim-vlerësim detyrimin dhe nuk është aplikuar asnjë masë tjetër shtrënguese, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB nr. 104, datë 04.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2024”. Gjithashtu nga vlera e debitorëve progresiv është kontabilizuar vetëm vlera prej 15,931,835 lekë dhe diferenca prej 146,065,114 lekë nuk është kontabilizuar në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të Formati 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” të pasqyrave financiare, me pasojë të ardhura të munguara. Nga DAPPLL nuk është dërguar asnjë informacion me shkresë Drejtorisë së Financës për debitorët e rezultuar nga kontabilizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me UMFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, paragrafi “Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve” faqe 28-30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,6 faqe 32-41, të Raportit Perfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Agjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP), të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 161,996,949 lekë nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë, si dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e debitorëve në mbyllje të vitit 2025.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Gjirokastër në fushën e tregëtimit të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij, u konstatua se, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregëtimit të lëndëve djegëse me pakicë 4 subjekte të pajisura me autorizim me afat me 5 vjet., nga të cilat kanë kryer pagesa pjesore 3 subjekte dhe 1 subjekt nuk e ka shlyer tarifën, duke rezultuar me detyrime të pashlyera në vlerë totale 2,700,000 lekë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë. Kjo vlerë nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë e debitorëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, Ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, nenet 4,15 dhe 20/2” dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3, pika 15.1 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,6 faqe 32-41, të Raportit Perfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Agjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP), të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve në ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, të papaguara nga 4 subjektet në vlerën 2,700,000 lekë përkatësisht:

- vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “A.” shpk.
- vlera 500,000 lekë nga subjekti “K.” shpk.
- vlera 700,000 lekë nga subjekti “E.” shpk.
- vlera 500,000 lekë nga subjekti “A. OIL” shpk

Brenda datës 31.12.2025

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale, rezulton se në fund të vitit 2023 janë debitorë 85 individë në vlerën 1,903,345 lekë, gjatë vitit 2024 janë krijuar debitorë 19 individë në vlerën 881,817 lekë dhe në fund të vitit 2024 rezultojnë debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet 103 individë në vlerë progresive 2,785,163 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë, si pasojë e mos dërgimit pranë zyrës së financës për kontabilizim. Drejtorja e Urbanistikës nuk ka marrë të gjithë masat e nevojshme për arkëtimin e (TNI) nga legalizimet, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5, me VKB nr.104, datë 04.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Gjirokastrës, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin ushtrimor”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,6 faqe 32-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Drejtorja e Urbanistikës në Bashkinë Gjirokastrë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP) të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 103 debitorë në vlerën 2,785,163 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 15 geramat (b,c,ç); nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, në Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 37, si dhe në kontratën individuale të punës dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT